

**ANILA TABAKU**

**Libër mësuësi**  
për tekstin shkollor

**HISTORI**

**6**

Shtëpia botuese Albas

Botues:  
Latif Ajrullai  
Rita Petro

Redaktore:  
Sevi Lami

Arti grafik  
Eva Kukaleshi  
Emanuela Lumani

© Autori, 2015

Të gjitha të drejtat janë të rezervuara. Nuk lejohet shumëfishimi me çdo mjet apo formë pa lejen me shkrim të autorit.

Shtypur në shtypshkronjën:



Shtëpia botuese Albas

Në Tiranë: Rr. "Budi", pallati "Classic Construction", nr. 2

Tel: 00355 42 379 184; e-mail: info@albas.al

Në Tetovë: Rr. "Ilinden", nr. 105

Tel: 00389 44 344 047; e-mail: albas\_te@yahoo.com

Në Prishtinë: Rr. "Muharrem Fejza", p.n.

Tel: 00377 45 999 770

e-mail: albas\_pr@yahoo.com

### **TEMATIKA I: QYTETËRIMET BOTËRORE NË ANTIKITET.**

#### **LUGINAT LUMORE - DJEPI I QYTETËRIMEVE TË HERSHME (MIJËVJEÇARI IV-II PR.K.)**

1. *Vepimtari*. Llogaritja e kohës
2. Lindja e qytetërimeve në luginat lumore
3. Qytetërimi në Mesopotami
4. Qytetërimi në Egjipt
5. Kultura dhe besimi në Mesopotami dhe në Egjipt
6. *Situatë e sugjeruar*. Parailirët dhe ilirët
7. *Situatë e sugjeruar*. Lindja dhe lulëzimi i qytetërimeve në Indi dhe në Kinën e lashtë

### **TEMATIKA II: QYTETËRIMET NË BRIGJET E DETEVE TË MESDHEUT**

#### **(SHEK. VII PR.K. – SHEK. V PS.K.)**

1. Qytetërimet në brigjet e deteve të Mesdheut
2. Qytetërimi grek
3. Qytetërimi romak
4. Ndërprerja e qytetërimit antik në Europë. Fillimi i qytetërimit mesjetar (shek. I-V) 31
5. *Situatë e sugjeruar*. Banorët e hershëm të Ballkanit dhe ilirët
6. *Situatë e sugjeruar*. Maqedonia
7. *Situatë e sugjeruar*. Perandorët romakë me origjinë ilire
8. *Situatë e sugjeruar*. Romanizimi dhe ilirët

### **TEMATIKA III: QYTETËRIMET MESJETARE NË SHEK. V-X**

1. Qytetërimi bizantin
2. Organizmi shtetëror, ekonomik, kulturor dhe fetar në Bizant
3. Qytetërimi arab
4. *Situatë e sugjeruar*. Pozita e vendit tonë gjatë periudhës së lulëzimit të qytetërimit bizantin
5. *Situatë e sugjeruar*. Ndikimi i qytetërimit arab në Europë

### **TEMATIKA IV: ZHVILLIMI I QYTETËRIMEVE MESJETARE NË SHEK. X-XII**

1. Ndryshimet në qytetërimet mesjetare europiane
2. Zhvillimi i qyteteve në mesjetë
3. Lindja e rajoneve tregtare dhe e bankave
4. Marrëdhëniet midis qytetërimit perëndimor dhe atij lindor
5. *Situatë e sugjeruar*. Karakteristikat kryesore të qyteteve mesjetare në territoret arbërore
- 6-7. *Situatë e sugjeruar*. Kalatë mesjetare shqiptare

### **TEMATIKA V: TIPARET E SISTEMEVE POLITIKE EUROPIANE NË SHEK. XII-XV**

1. Fillesat e shtet-kombeve
2. Mbretëria e Anglisë dhe Monarkia Franceze
3. *Situatë e sugjeruar*. Ndryshimet ndërmjet sistemeve politike europiane: Anglia dhe Franca
4. Perandoria Osmane
- 5-6-7. *Situatë e sugjeruar*. Unë jam shqiptar, pasardhës i arbërve
8. Kultura dhe besimi në qytetërimet mesjetare

**PLANIFIKIMI I LËNDËS PËR TREMUJORIN E PARË  
(Shtator - Dhjetor)**

**Fusha: HISTORI  
Lënda: HISTORI**

**Shkalla: III**

**Klasa: VI  
Viti shkollor: 2015-2016**

**REZULTATET E TË NXËNIT SIPAS KOMPETENCAVE KYÇ**

Orët mësimore të zhvilluara gjatë kësaj periudhe tremujore do të kontribuojnë në ndërtimin dhe zhvillimin e këtyre kompetencave kyç:

**KOMPETENCA E KOMUNIKIMIT DHE E TË SHPREHURIT**

Nxënësi:

1. zhvillon kompetencën e komunikimit për të ndërtuar kompetencat historike për të shqyrtuar, për të analizuar, për të parashtruar pyetje, për të argumentuar, për të diskutuar dhe për të komunikuar informacionin historik, konceptet dhe idetë;
2. përdor funksionet gjuhësore të teksteve historike, duke përfshirë fjalorin historik, fjali të ndërtuara saktë për përshkrimin e ngjarjeve, fjali komplekse për shpjegimin e marrëdhënieve shkak-pasojë, përdorimin e gjerë të emrave, ndajfoljeve dhe mbiemrave për të përshkruar vendet, njerëzit dhe ngjarjet.

**KOMPETENCA E TË MENDUARIT**

Nxënësi:

1. zhvillon kompetencën e të menduarit për realizimin e kërkimit historik;
2. zhvillon mendimin kritik për të përzgjedhur burimet, për të interpretuar të shkuarën nëpërmjet informacionit, për të dhënë argumente bazuar në burime dhe për të saktësuar saktësinë e burimeve;
3. zhvillon mendimin krijues për të ndërtuar interpretime të reja, të cilat shpjegojnë aspekte të së shkuarës, që janë të diskutueshme;
4. analizon të dhënat numerike për të kuptuar të shkuarën, për shembull për të kuptuar shkakun dhe pasojën, vazhdimësinë dhe ndryshimin;
5. ndërton dhe interpreton grafikë, diagrame, tabela statistikore për paraqitjen e të dhënave historike;
6. përdor numrat negativë dhe pozitivë për llogaritjen e kohës.

**KOMPETENCA E TË NXËNIT**

Nxënësi:

1. zhvillon kompetencën e të nxënësve për të shfrytëzuar të dhënat për të demonstruar të kuptuarit e koncepteve historike dhe shoqërore, duke i prezantuar nëpërmjet formave të ndryshme të të shprehurit;
2. përzgjedh të dhëna nga burime të ndryshme, i klasifikon ato burime sipas rëndësisë që kanë për temën;
3. parashtron pyetje kërkimore dhe përgjigjet duke u bazuar në argumente dhe burime;
4. zbaton në mënyrë të pavarur udhëzimet për një temë, veprim, aktivitet ose detyrë që i kërkohet;
5. ndërlihdh temën e re ose një çështje të dhënë me njohuritë dhe përvojat paraprake, duke i paraqitur në formë të ndryshme të të shprehurit sipas një radhitjeje logjike;
6. vlerëson pikëpamjet e ndryshme, si dhe menaxhon emocionet, ndjenjat, kohën, shfrytëzimin e burimeve dhe mjeteve gjatë kryerjes së një detyre në histori.

**KOMPETENCA PËR JETËN, SIPËRMARRJEN DHE MJEDISIN**

Nxënësi:

1. zhvillon kompetencën për jetën, sipërmarrjen dhe mjedisin për të identifikuar dhe vlerësuar burimet e nevojshme për interpretimin e ngjarjes historike;
2. harton hapat që duhet të ndjekë për realizimin e një kërkimi historik për një ngjarje të dhënë;
3. zhvillon një kërkim individual ose në grup për kryerjen e një veprimtarie në histori;
4. diskuton individualisht ose në grup për rëndësinë që ka e shkuara në kuptimin e së tashmes dhe perspektivat e së ardhmes;
5. bashkëvepron në mënyrë aktive me moshatarët dhe të tjerët (pavarësisht statusit të tyre social, etnik etj.) për realizimin e një veprimtarie të përbashkët.

**KOMPETENCA QYTETARE**

Nxënësi:

1. zhvillon kompetencën personale për të kuptuar veten dhe të tjerët, ndryshimet dhe ngjashmëritë, për të menaxhuar marrëdhëniet ndërmjet njëri-tjetrit, vlerësuar pikëpamjet e të tjerëve, qofshin këto edhe të ndryshme nga të tija;
2. kupton nëpërmjet kërkimit historik përvojën e njeriut, marrëdhëniet shkak-pasojë, trashëgiminë kulturore, rëndësinë historike, ndryshimet dhe vazhdimësinë që ka pësuar shoqëria përgjatë kohërave;
3. përdor aftësitë e komunikimit, punës në grup etj., për të prezantuar dhe argumentuar idetë e tij.

**KOMPETENCA DIGJITALE**

Nxënësi:

1. zhvillon kompetencën qytetare për të shqyrtuar në mënyrë kritike sjelljet, motivet dhe veprimet e njerëzve në të shkuarën, që mund të jenë rezultat i ndryshimit të qëndrimeve shoqërore dhe standardeve të ndryshme;
2. shqyrton burimet historike për të kuptuar ngjarjet dhe zhvillimet që kanë ndikuar në shoqëri dhe grupe të ndryshme kulturore në kohëra të ndryshme, si dhe shpjegon natyrën, shkaqet dhe pasojat e konflikteve dhe ndërvarësinë kulturore;
3. kupton se si qytetërimet dhe shoqëritë janë formuar nga grupe njerëzish me kultura të ndryshme, identifikon dallimet dhe ngjashmëritë ndërmjet kulturave të ndryshme dhe kultivon respekt ndaj kulturave të ndryshme nga e tij;
4. shqyrton burimet historike për të kuptuar çështjet shoqërore dhe se si parime të ndryshme kanë ndikuar në çështjet njerëzore.

## REZULTATET E TË NXËNIT PËR KOMPETENCAT HISTORIKE

### Kërkimi historik

Nxënësi:

- identifikon dhe shqyrton, individualisht dhe si pjesë e një grupi, pyetje specifike historike ose çështje, duke bërë testimin e hipotezave;
- reflekton në mënyrë kritike për pyetje ose çështje historike.

### Përdorimi i burimeve

Nxënësi:

- shpjegon tipat e burimeve historike, si një domosdoshmëri në punën e historianit;
- kërkon, duke vlerësuar burimet alternative, për ndërtimin e ngjarjes historike;
- identifikon, zgjedh dhe përdor një sërë burimesh historike, duke përfshirë burimet tekstuale, vizuale, objektet dhe mjedisin historik;
- vlerëson burimet e përdorura për të arritur përfundime të arsyetuara dhe logjike;
- vlerëson historinë gojore, me anë të së cilës dëshmitë gojore për ngjarjet e fundit historike mund ta bëjnë historinë më të gjallë në sytë e nxënësve, si dhe mund t'u lënë vend pikëpamjeve e perspektivave të atyre që nuk kanë marrë pjesë në "historinë e shkruar".

### Interpretimi historik

Nxënësi:

- kupton pse historianët dhe të tjerët i kanë interpretuar ngjarjet, njerëzit dhe situatat në mënyra të ndryshme nëpërmjet një sërë mediesh;
- shpjegon se si dhe pse ngjarjet historike janë interpretuar në mënyra të ndryshme;
- shqyrton një sërë interpretimesh të së kaluarës për të vlerësuar vlefshmërinë e tyre.

### Të shkruarit për qëllime personale dhe funksionale

Nxënësi:

- përdor formën ose modelin e përshtatshëm gjatë të shkruarit dhe zbaton rregullat gramatikore, leksikore dhe drejtshkrimore, për të shprehur mendimet, qëllimet, ndjenjat për tema të caktuara;
- mbështet mesazhin kryesor ose kyç të një teksti me detaje përshkruese, me fakte ose shembuj të ndryshëm.

### Shkaku dhe pasoja

Nxënësi:

- analizon ngjarjet historike në lidhjet e tyre shkak-pasojë;
- shpjegon pasojat e përfundimit të ngjarjeve, situatave dhe ndryshimet historike.

### Shpjegimi dhe komunikimi

Nxënësi:

- paraqet shpjegime rreth së kaluarës që janë koherente, të strukturuar dhe të arsyetuara, duke përdorur kronologjinë dhe fjalorin e duhur historik;
- komunikon njohuritë historike në mënyra të ndryshme, duke përdorur kronologjinë dhe fjalorin e duhur historik.

**REZULTATET E TË NXËNIT PËR KONCEPTET HISTORIKE****Kuptimi kronologjik**

Nxënësi:

- përdor saktë datat dhe fjalorin për periudha të ndryshme historike, duke përfshirë periudhën parahistorike, antike, mesjetare, moderne;
- kupton organizimin kronologjik të historisë dhe të vendosë njerëzit dhe ngjarjet në periudhën e saktë historike, duke kuptuar dhe duke shpjeguar marrëdhëniet historike;
- ndërton linjën e kohës, duke vendosur në të periudhat historike dhe ngjarjet e rëndësishme historike;
- kryen veprime për llogaritjen e kohës;
- krijon një tabelë kronologjike të periudhave historike, duke e pasuruar atë në vazhdimësi me informacionin e ri.

**Ndryshimi dhe vazhdimësia**

Nxënësi:

- shpjegon ndryshimin dhe vazhdimësinë e ngjarjeve historike brenda dhe përtej periudhave historike;
- analizon shkallën dhe ritmin e ndryshimit, nëse ndryshimi arriti në progres dhe nëse po, për kë;
- analizon arsyet dhe rezultatet e ngjarjeve, situatave dhe të ndryshimeve historike;
- kupton dhe ndërgjegjësohet për veçoritë e prirjeve historike sipas periudhave, të cilat sollën progresin e shoqërisë në shkallë kombëtare, europiane dhe botërore.

**Shumëllojshmëria kulturore, etnike dhe fetare**

Nxënësi:

- kupton se njerëzit dhe shoqëritë e përfshira në të njëjtën ngjarje historike mund të kenë përvoja dhe pikëpamje të ndryshme për të njëjtën ngjarje historike.

**Rëndësia**

Nxënësi:

- vlerëson rëndësinë e ngjarjeve, të njerëzve dhe të zhvillimeve në kontekstin e tyre historik dhe në ditët e sotme.

**Tematika 1. Qytetërimet botërore në antikitet. Luginat lumore, djepti i qytetërimeve të hershme (mijëvjeçari IV - II pr. K.)**

**Përshkrimi i tematikës:** Përmes kësaj tematike, nxënësit demonstronjë njohuri, aftësi/shkathësi, qëndrime dhe vlera mbi lindjen e qytetërimeve në luginat lumore dhe tiparet e qytetërimeve të hershme në Mesopotami dhe Egjipt. Kjo tematikë sugjerohet të zhvillohet në 7 orë mësimore. Për tematikën e dhënë më poshtë janë parashikuar dhe veprimtari/projekte, të cilat jepen në rubrikën “Situata të sugjeruara”. Këto orë veprimtarish/projektesh mësuasi dhe autori i tekstit i integron brenda orëve të tematikës. Tematika së bashku me veprimtaritë/projektet realizojnë kompetencat të ndërsa dhe kompetencat kyç për të nxënësit gjatë gjithë jetës.

Nr.	Temat mësimore	Shkathtësitë për realizimin e kompetencave të lëndës	Situata e të nxënësit	Burimet dhe materialet didaktike
1	Llogaritja e kohës (situatë e sugjeruar)	<ul style="list-style-type: none"> <li>Ndërton dhe lexon grafikun e kohës;</li> <li>dallon dy periudhat e mëdha historike: para K. dhe pas K.</li> <li>ndan periudhat historike në mijëvjeçarë, shekuj dhe vite;</li> <li>bën llogaritjen e kohës, duke marrë si bazë vitin 1.</li> </ul>	Mësuesi/ja jep situata dhe diskuton me nxënësit rreth llogaritjes së kohës: si llogariten periudhat para dhe pas vitit 1.	Teksti mësimor; e-libri; shkalla e kohës; termometër
2	Lindja e qytetërimeve në luginat lumore	<ul style="list-style-type: none"> <li>Tregon në hartë vendndodhjen e qytetërimeve që lindën në brigjet e lumenjve (Mesopotami, Egjipt);</li> <li>përcakton kohën e lindjes së qytetërimeve në Mesopotami dhe Egjipt;</li> <li>vlerëson rolin e mjedisit gjeografik në lindjen dhe zhvillimin e qytetërimit (Mesopotami, Egjipt);</li> <li>krahason dy qytetërimet dhe përcakton të përbashkëtat dhe dallimet ndërmjet tyre.</li> </ul>	Mësuesi/ja diskuton me nxënësit rreth faktorëve të lindjes së qytetërimeve në luginat lumore.	Teksti mësimor; e-libri; harta; enciklopedi; materiale nga interneti
3	Qytetërimi në Mesopotami	<ul style="list-style-type: none"> <li>Përshkruan veçoritë e ndërtimit shoqëror në Mesopotami;</li> <li>përshkruan veçoritë e zhvillimit ekonomik në Mesopotami;</li> <li>tregon tiparet e organizimit shtetëror në Mesopotami;</li> <li>tregon rolin e ligjeve të Hamurabit në zhvillimet ekonomike, shoqërore e politike në Mesopotami.</li> </ul>	Mësuesi/ja ndërlidh temën e re me njohuritë paraprake që kanë nxënësit duke i shprehur ato sipas një radhitjeje logjike dhe duke i pasuruar me informacion të ri.	Teksti mësimor; e-libri; harta; enciklopedi; materiale nga interneti
4	Qytetërimi egjiptian	<ul style="list-style-type: none"> <li>Përshkruan veçoritë e ndërtimit shoqëror në Egjipt;</li> <li>përshkruan veçoritë e zhvillimit ekonomik në Egjipt;</li> <li>tregon tiparet e organizimit shtetëror në Egjipt.</li> </ul>	Mësuesi/ja ndërlidh temën e re me njohuritë paraprake që kanë nxënësit duke i shprehur ato sipas një radhitjeje logjike.	Teksti mësimor; e-libri; harta; enciklopedi; materiale nga interneti



5	Kultura dhe besimi në Mesopotami dhe Egjipt	<ul style="list-style-type: none"> <li>● Analizon kulturën materiale e shpirtërore të qytetërimeve në Mesopotami dhe Egjipt;</li> <li>● dallon karakteristikat e përbashkëta dhe të veçantat ndërmjet dy kulturave;</li> <li>● vlerëson rolin e arritjeve të këtyre qytetërimeve në jetën e sotme;</li> <li>● njih dhe vlerëson disa nga figurat historike që i përkasin kësaj tematike, si Sargoni, Hamurabi, Menes, Ramsesi II etj.</li> </ul>	Mësuesi/ja zgjedh të dhëna nga burime të ndryshme për të demonstruar të kuptuarin e koncepteve në lidhje me temën.	Teksti mësuesor; e-libri; harta; imazhe e foto të zotave të ndryshëm; enciklopedi; materiale nga interneti
6	Paralliret dhe ilirët (Situatë e sugjeruar)	<ul style="list-style-type: none"> <li>● Përcakton popullsinë paralele si pararendëse e kulturës së bronzit;</li> <li>● tregon në hartë vendbanimet e kulturës së bronzit;</li> <li>● përshkruan kulturën materiale dhe shpirtërore të popullsisë paralele.</li> </ul>	Mësuesi/ja zgjedh të dhëna nga burime të ndryshme për të demonstruar të kuptuarin e koncepteve në lidhje me temën nëpërmjet mjeteve pamore, si video-projektor, albume, fotografi etj.	Teksti mësuesor; e-libri; harta; imazhe e foto të ndryshme të vendbanimeve, mjeteve dhe sendeve të ndryshme që i përkasin periudhës së bronzit; enciklopedi; materiale nga interneti.
7	Lindja dhe lulëzimi i qytetërimeve në Indi dhe në Kinën e lashtë (Situatë e sugjeruar)	<ul style="list-style-type: none"> <li>● Tregon në hartë shtrirjen e qytetërimit indian dhe kinez;</li> <li>● përshkruan veçoritë e qytetërimit indian;</li> <li>● përcakton veçoritë e qytetërimit kinez;</li> <li>● vlerëson kontributin e qytetërimeve të lindjes në zhvillimin e qytetërimit botëror.</li> </ul>	Mësuesi/ja zgjedh të dhëna nga burime të ndryshme për të demonstruar të kuptuarin e koncepteve në lidhje me temën nëpërmjet mjeteve pamore, si video-projektor, albume, fotografi etj.	Teksti mësuesor; e-libri; harta; imazhe e foto të ndryshme të vendbanimeve, mjeteve dhe sendeve të ndryshme që i përkasin periudhës së qytetërimit të hershëm kinez e indian; enciklopedi; materiale nga interneti.

## Tematika 2. Qytetërimet në brigjet e deteve të Mesdheut (shekulli VII pr. K. - shekulli V ps. K.)

**Përshkrimi i tematikës:** Përmes kësaj tematike, nxënësit demonstronë njohuri, aftësi/shkathësi, qëndrime dhe vlera mbi lindjen dhe përhapjen e qytetërimeve në brigjet e deteve të Mesdheut. Tematika trajton qytetërimin grek, shtetin, shoqërinë dhe jetën e përditshme në qytetërimin antik grek, artin, kulturën shkencën dhe besimin në këtë qytetërim. Tematika trajton, gjithashtu, qytetërimin romak, shtetin, shoqërinë dhe jetën e përditshme në këtë qytetërim, artin, kulturën dhe shkencën në qytetërimin romak, si dhe përhapjen e tyre. Njëpërmjet kësaj tematike, nxënësit mësojnë për ndërprerjen e qytetërimeve antike në Europë dhe fillimin e qytetërimeve mesjetare (shekujt I - V ps. K.), si dhe për popujt që migruan në territorin e Perandorisë Romake. Kjo tematikë sugjerohet të zhvillohet në 8 orë mësimore. Për tematikën e dhënë më poshtë janë parashikuar dhe veprimtari/projekte, të cilat jepen në rubrikën "Situata të sugjeruara". Këto orë veprimtari/projektesh, mësuesi dhe autori i tekstit i integrojnë brenda orëve të tematikës. Tematika së bashku me veprimtari/projektet realizojnë kompetencat lëndore dhe kompetencat kyçe për të nxënësit gjatë gjithë jetës.

8	Lindja dhe përhapja e qytetërimeve në brigjet e deteve të Mesdheut	<ul style="list-style-type: none"> <li>Tregon në hartë vendosjen dhe shtrirjen e popujve në brigjet e deteve të Mesdheut;</li> <li>identifikon faktorët e zhvillimit të qytetërimeve në brigjet e deteve të Mesdheut.</li> </ul>	Mësuesi/ja u kërkon nxënësve të sjellin në mendje karakteristikat e qytetërimit Mesopotami dhe egjiptian për të bërë lidhjen me qytetërimet e popujve të detit nëpërmjet teknikës "Stuhi mendimesh".	Teksti mësimor; e-libri; harta; enciklopedi; materiale nga interneti.
9	Qytetërimi grek	<ul style="list-style-type: none"> <li>Tregon tiparet e organizimit shoqëror në qytetërimin grek;</li> <li>përshkruan evolucionin politik të qytet-shteteve greke të Athinës dhe të Spartës;</li> <li>vlërëson rolin e demokracisë antike në zhvillimin e qytetërimit grek dhe qytetërimeve të mëvonshme;</li> <li>përshkruan tiparet e artit, kulturës, besimit, shkencës dhe të arsimit në qytetërimin grek.</li> </ul>	Mësuesi/ja u kërkon nxënësve të sjellin në mendje karakteristikat e qytetërimit mesopotam dhe egjiptian për të bërë lidhjen me qytetërimin grek nëpërmjet teknikës "Stuhi mendimesh".	Teksti mësimor; e-libri; harta; imazhe e foto të ndryshme të vendbanimeve, mjeteve dhe sendeve të ndryshme që i përkasin periudhës së qytetërimit të hershëm grek; Enciklopedi; materiale nga interneti.
10	Qytetërimi romak	<ul style="list-style-type: none"> <li>Përcakton kohën e lindjes së qytetërimit romak;</li> <li>përshkruan tiparet e organizimit shoqëror të qytetërimit romak;</li> <li>tregon aspekte të jetës së përditshme të jetës romake;</li> <li>përshkruan evolucionin politik të Romës;</li> <li>dallon krijimin e së <i>Drejtes Romake</i>, si një prej legjislativioneve më të rëndësishme të jurisprudencës botërore.</li> </ul>	Mësuesi/ja bën lidhjen e qytetërimit grek me atë romak nëpërmjet teknikës "Stuhi mendimesh" dhe ndikimet te njëri-tjetri.	Teksti mësimor; e-libri; harta; imazhe e foto të ndryshme të vendbanimeve, mjeteve dhe sendeve të ndryshme që i përkasin periudhës së qytetërimit romak; enciklopedi; materiale nga interneti.

11	Nëdërprerja e qytetërimit antik në Europë dhe fillimi i qytetërimeve mesjetare (shekujt I -V ps. K.)	<ul style="list-style-type: none"> <li>● Përshkruan kushtet e lindjes së krishterimit, duke evidentuar rrethanat historike të kalimit nga besimi pagan në atë të krishterë;</li> <li>● liston faktorët historikë që ndikuan në përhapjen e krishterimit;</li> <li>● përshkruan faktorët historikë që shkaktuan lëvizjen e popujve;</li> <li>● tregon në hartë "çyndjen e popujve" në Europë;</li> <li>● tregon pasojat që sollën migrimet e popujve në Europë;</li> <li>● dallon rolin e migrimeve të popujve si faktor kyç në lindjen e qytetërimit mesjetar;</li> <li>● njih dhe vlerëson disa nga figurat historike që i përkasin qytetërimeve grek e romak, si Minosi, Homerit, Soloni, Klisteni, Perikliu, Jul Cezari, Oktaviani, Spartaku, Romuli, Atila, Teodoriku, Aleksandri i Madh etj.</li> </ul>	Mësuesi/ja ndërlidh njohuritë e mëparshme me ato të reja nëpërmjet teknikës "Stuhi mendimesh".	Teksti mësuesor; e-libri; harta e Europës; foto të kishave të vjetra në vende të ndryshme të Europës; enciklopedi; materiale nga interneti etj.
12	Banorët e hershëm të Ballkanit dhe ilirët (Situatë e sugjeruar)	<ul style="list-style-type: none"> <li>● Tregon në hartë shtrirjen e qytetërimeve të hershme në Ballkan, duke evidentuar qytetërimin ilir;</li> <li>● vlerëson etnosin ilir;</li> <li>● tregon fiset ilire dhe organizimin shtetëror të tyre;</li> <li>● përshkruan karakteristikat e jetës së përditshme në Iliri, si: veshja, ushqimi, mobilimi i shtëpive, martesat, zakonet, artin dhe besimin e tyre etj.;</li> <li>● përshkruan marrëdhëniet ekonomike, politike dhe kulturore ndërmjet qytetërimit ilir, grek dhe atij romak.</li> </ul>	Mësuesi/ja zgjedh të dhëna nga burime të ndryshme për të demonstruar të kuptuarin e koncepteve në lidhje me temën nëpërmjet mjeteve pamore, si video-projektor, albume, fotografi etj.	Teksti mësuesor; e-libri; harta të Ballkanit; materiale me pamje nga jeta dhe të mjeteve të punës e armëve në periudhën ilire; enciklopedi
12/1	Maqedonia (Situatë e sugjeruar)	<ul style="list-style-type: none"> <li>● Tregon në hartë shtrirjen e qytetërimit maqedonas;</li> <li>● tregon për organizimin shtetëror të Maqedonisë;</li> <li>● përshkruan karakteristikat e organizimit ushtarak të Maqedonisë;</li> <li>● përshkruan jetën dhe pushtimet e Aleksandrit të Madh të Maqedonisë.</li> </ul>	Mësuesi/ja zgjedh të dhëna nga burime të ndryshme për të demonstruar të kuptuarin e koncepteve në lidhje me temën nëpërmjet mjeteve pamore, si video-projektor, albume, fotografi etj.	Teksti mësuesor; e-libri; harta të Ballkanit; materiale me pamje nga jeta dhe të mjeteve të punës e armëve të Maqedonisë në periudhën e Aleksandrit të Madh.
13		Përsëritje ose Test për tremujorin e parë		

**Shënim.** Në tekstin mësuesor dhe në plan janë paraqitur të gjitha situatat e sugjeruara nga programi. Mësuesi/ja është i/e lirë të përzgjedhë ato situata që i duken më të mundshme për t'u realizuar. Nga orët e sugjeruara janë marrë edhe orët për testimet. Mësuesi/ja mund të planifikojë edhe orë përsëritjeje, nëse e sheh të arsyeshme.

PLANIFIKIMI 3-MUJOR  
(JANAR –MARS)

FUSHA: HISTORI  
LËNDA: HISTORI

SHKALLA III  
KLASA VI

VITI SHKOLLOR 2015-2016

Nr.	Temat mësimore	Shkathësitë për realizimin e kompetencave të lëndës	Situata e të nxënët	Burimet
14	Perandorët romakë me origjinë ilire (Situatë e sugjeruar)	<ul style="list-style-type: none"> <li>Zbulon të dhëna për perandorët romakë me origjinë ilire;</li> <li>përshkruan jetën dhe kontributin e perandorëve romakë me origjinë ilire</li> </ul>	Mësuesi/ja diskuton me nxënësit rreth njohurive që ata kanë për Perandorinë Romake.	Teksti mësimor; e-libri; Harta e Ballkanit Materiale me pamje nga jeta dhe të mjeteve të punës e armëve të fiseve ilire Enciklopedi Materiale nga interneti
15	Romanizimi dhe ilirët (situatë e sugjeruar)	<ul style="list-style-type: none"> <li>Përcakton në hartë territoret ku u shtri ndikimi romak në Shqipëri;</li> <li>shpjegon faktorët e zhvillimit të romanizimit dhe shkaqet e kufizimit të tij;</li> <li>bën lidhjen e identitetit të sotëm të shqiptarëve me periudhën ilire.</li> </ul>	Mësuesi/ja diskuton me nxënësit rreth njohurive që ata kanë për Perandorinë Romake, pushtimin dhe sundimin e saj në Iliri.	Teksti mësimor; e-libri; Harta e Ballkanit Materiale me pamje nga jeta dhe të mjeteve të punës e armëve të fiseve ilire Enciklopedi Materiale nga interneti

**Tematika 3. Qytetërimet mesjetare në shekujt V – X**

**Përshkrimi i tematikës:** Përmes kësaj tematike nxënësit demonstrojnë njohuri, aftësi/shkathësi, qëndrime dhe vlera mbi krijimin e Perandorisë Bizantine si vazhdim i qytetërimeve greko-romake, ardhjen e sllavëve në Ballkan e Bizant, tiparet e qytetërimit bizantin, si: organizimin shtetëror, ekonomik, kulturor dhe fetar, si dhe tiparet e qytetërimit arab, përfshirë dhe organizimin shoqëror, ekonomik dhe kulturor. Gjithashtu, ata mësojnë rreth kushteve historike të lindjes së besimit islam, përhapjes dhe veçorive të tij. Kjo tematikë sugjerohet të zhvillohet në 5 orë mësimore. Për tematikën e dhënë më poshtë janë parashikuar dhe veprimtari/projekte, të cilat jepen në rubrikën “Situata të sugjeruara”. Këto orë veprimtarish/projektesh mësuësi dhe autori i tekstit i integron brenda orëve të tematikës. Tematika së bashku me veprimtaritë/projektet realizojnë kompetencat lëndore dhe kompetencat kyç për të nxënësit gjatë gjithë jetës.

Nr.	Temat mësimore	Shkathhtësitë për realizimin e kompetencave të lëndës	Situata e të nxënët	Burimet
16	Qytetërimi bizantin	<ul style="list-style-type: none"> <li>● Përcakton në hartë vëndndodhjen e Perandorisë Bizantine;</li> <li>● dallon shkaqet e krijimit të Perandorisë Bizantine;</li> <li>● përcakton faktorët historikë që ndikuan në jetëgjatësinë e saj;</li> <li>● përshkruan tiparet e qytetërimit bizantin;</li> <li>● përcakton në hartë lëvizjet e sllavëve në Ballkan e Bizant;</li> <li>● tregon pasojat e dyndjeve të sllave në Ballkan.</li> </ul>	Mësuesja diskuton me nxënësit rreth ndarjes së Perandorisë Romake dhe krijimit të Perandorisë Bizantine; si dhe njohuritë e tyre për Kostandinopojën (Stambolli i sotëm).	Teksti mësimor; e-libri; Harta e Europës dhe Ballkanit Enciklopedi Materiale nga interneti
17	Organizimi shtetëror ekonomik, kulturor dhe fetar në Bizant	<ul style="list-style-type: none"> <li>● Përshkruan tiparet e organizimit shtetëror, shoqëror dhe ekonomik në qytetërimin bizantin;</li> <li>● vlerëson arritjet e këtij qytetërimi në art, kulturë dhe arsim;</li> <li>● shpjegon karakterin dhe rolin e Kodit të Justinianit në zhvillimet ekonomike, shoqërore e politike në qytetërimin bizantin dhe atij evropian;</li> <li>● analizon shkaqet e ndarjes së kishës së krishterë.</li> </ul>	Mësuesja diskuton me nxënësit rreth organizimit shoqëror dhe politik në Perandorinë Bizantine.	Teksti mësimor; e-libri; Harta e Euro-Azisë Materiale nga interneti me pamje nga Kisha e Shën Sofisë dhe kishave të tjera të kohës së Bizantit Enciklopedi
18	Qytetërimi arab	<ul style="list-style-type: none"> <li>● Tregon në hartë shtrirjen e kalifatit arab;</li> <li>● përshkruan veçoritë e qytetërimit arab;</li> <li>● vlerëson arritjet e qytetërimit arab në art, kulturë dhe shkencë;</li> <li>● përshkruan kushtet historike të lindjes dhe përhapjes së besimit islam;</li> <li>● njih dhe vlerëson disa nga figurat historike që i përkasin kësaj tematike, si Justiniani, Muhamedi, Omar Khajani, Avicena etj.</li> </ul>	Mësuesi/ja trajton me nxënësit tiparet e qytetërimit arab dhe besimin fetar islam për të bërë lidhje me temën e re.	Teksti mësimor; e-libri; Harta e Euro-Azisë Materiale nga objekte kulti të besimit islam Enciklopedi
19	Pozita e vendit tonë gjatë periudhës së lulëzimit të qytetërimit bizantin (Situatë e sugjeruar)	<ul style="list-style-type: none"> <li>● Tregon elemente të kulturës bizantine të gjetura në territoret arbërore.</li> <li>● mbledh të dhëna për Principatën e Arbrit, si pararendëse e principatave të shek. XV.</li> <li>● analizon ndikimin e qytetërimit bizantin në këtë principatë.</li> </ul>	Mësuesi/ja diskuton me nxënësit rreth njohurive që ata kanë për Perandorinë Bizantine dhe qytetërimin bizantin në rajonin e Ballkanit.	Teksti mësimor; e-libri; Harta e Shqipërisë Materiale nga principatat shqiptare të periudhës bizantine, simbole dhe shtrirja e principatave Enciklopedi

Nr.	Temat mësimore	Shkathësitë për realizimin e kompetencave të lëndës	Situata e të nxënit	Burimet
20	Ndikimi i qytetërimit arab në Europë	<ul style="list-style-type: none"> <li>Evidenton ndikimin e qytetërimit arab në Europë</li> <li>evidenton shtrirjen e qytetërimit arab në tri kontinente.</li> </ul>	Mësuesi/ja bashkëbisedon me nxënësit për qytetërimin arab dhe shtrirjen e tij në tri kontinente.	Teksti mësimor; e-libri; Harta e Euro-Azisë Materiale me pamje ngjarjeve dhe vendeve ku evidentohet ndikimi i qytetërimit arab, foto të Avicenës, Omar Khajamit dhe figurave të tjera të rëndësishme të qytetërimit arab Enciklopedi
<p><b>Tematika 4. Zhvillimi i qytetërimeve mesjetare në shekujt X – XII</b></p> <p>Përshkrimi i tematikës: Përmes kësaj tematike, nxënësit demonstrojnë njohuri, aftësi/shkathësi, qëndrime dhe vlera mbi feudalizmin si një sistem i ri, tiparet themelore të këtij sistemi: aristokracinë, vasalitetin, bujkrobërinë. Tematika trajton lindjen e qyteteve, zhvillimin e tregtisë, ndryshimin në strukturën shoqërore dhe në mënyrën e jetesës, si dhe marrëdhëniet midis dy qytetërimeve: perëndimor dhe lindor; kryqëzatat, marrëdhëniet tregtare. Kjo tematikë sugjerohet të zhvillohet në 7 orë mësimore. Për tematikën e dhënë më poshtë janë parashikuar dhe veprimtari/projekte, të cilat jepen në rubrikën “Situata të sugjeruara”. Këto orë veprimtarish/projektesh mësuasi dhe autori i tekstit i integron brenda orëve të tematikës. Tematika së bashku me veprimtaritë/projektet realizojnë kompetencat lëndore dhe kompetencat kyçe për të nxënit gjatë gjithë jetës.</p>				
21	Ndryshimet në qytetërimet mesjetare europiane	<ul style="list-style-type: none"> <li>Shpjegon tiparet themelore të sistemit feudal;</li> <li>dallon ndryshimet e këtij sistemi në jetën ekonomike dhe shoqërore;</li> <li>përshkruan detyrimet e shtresave shoqërore ndaj njëra-tjetrës.</li> </ul>	Mësuesi/ja bashkëbisedon fillimisht me nxënësit për rëniën e Perandorisë Romake në Europë dhe pasojat e saj.	Teksti mësimor; e-libri; Harta e Europës mesjetare Imazhe e foto të ndryshme që i përkasin Europës mesjetare Enciklopedi Materiale nga interneti
22	Zhvillimi i qyteteve në mesjetë	<ul style="list-style-type: none"> <li>Tregon faktorët që çuan në lindjen e qyteteve mesjetare;</li> <li>përshkruan një qytet mesjetar;</li> <li>vlerëson rolin e tregtisë në zhvillimin e qytetit mesjetar;</li> <li>përshkruan lindjen dhe zhvillimin e qyteteve;</li> <li>tregon arsyet e luftës së qyteteve kundër feudalëve;</li> <li>arsyeton rreth elementeve të vetadministrimit të qyteteve në mesjetë.</li> </ul>	Mësuesi/ja diskuton me nxënësit për organizimin e qyteteve mesjetare dhe bën dallimin me qytetet sot.	Teksti mësimor; e-libri; Harta e Europës mesjetare Imazhe e foto të ndryshme që i përkasin qyteteve të Europës mesjetare Enciklopedi Materiale nga interneti



Nr.	Temat mësimore	Shkathësitë për realizimin e kompetencave të lëndës	Situata e të nxënës	Burimet
23	Lindja e rajoneve tregtare dhe e bankave	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Vlerëson rolin e tregtisë në zhvillimin e qytetit mesjetar;</li> <li>• përcakton strukturën shoqërore të Europës mesjetare;</li> <li>• krahason mënyrën e jetesës së shtresave të ndryshme shoqërore në Europën mesjetare;</li> <li>• evidenton tiparet e artit, kulturës, arsimit dhe besimit fetar në qytetet mesjetare.</li> </ul>	Nxënësit diskutojnë për lindjen dhe zhvillimin e qyteteve duke u ndalur te roli i tyre si qendra zejtarie dhe tregtie dhe rolin që luajtën rajonet tregtare.	Teksti mësimor; e-libri; Harta e Europës mesjetare. Imazhe e foto të ndryshme që i përkasin qyteteve të Europës mesjetare dhe monedhave e parave të kësaj periudhe, Enciklopedi
24	Marrëdhëniet midis qytetërimit, perëndimor dhe atij lindor	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Përshkruan marrëdhëniet midis qytetërimit arab dhe atij evropian;</li> <li>• përkufizon termin <i>kryqëzatë</i>;</li> <li>• shpjegon shkaqet e fillimit të kryqëzatave;</li> <li>• evidenton pasojat e kryqëzatave në marrëdhëniet mes dy qytetërimeve;</li> <li>• njih dhe vlerëson disa nga figurat historike që i përkasin kësaj tematike, si: Papa Urbani II, Saladini, Dhimitri i Arbrit etj.</li> </ul>	Mësuesi/ja diskuton me nxënësit rreth qytetërimit lindor e perëndimor duke bërë krahasim mes tyre.	Teksti, mësimor; e-libri; harta e Europës mesjetare, materiale për figura të shquara, të kryqëzatave, kryqtarëve, shembuj nga qytetërimi lindor dhe perëndimor Enciklopedi
25	Karakteristikat kryesore të qyteteve mesjetare në territoret arbërore (Situatë e sugjeruar)	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Rendit disa të dhëna për kulturën arbërore, si: gjuhën, simbolet shtetërore, monedhat, ndërtimet, veshjet, veglat e punës, armët etj.;</li> <li>• përmend dhe përshkruan disa nga aspektet e zhvillimit të arsimit, letërsisë, artit dhe të fesë në mesjetë.</li> </ul>	Mësuesi/ja diskuton me nxënësit rreth njohurive për karakteristikat kryesore të qyteteve mesjetare.	Teksti mësimor; e-libri; Harta e Shqipërisë Materiale me pamje nga qytetet kryesore mesjetare të Shqipërisë Enciklopedi

**PLANIFIKIMI 3-MUJOR  
(PRILL –QERSHOR)**

**FUSHA: HISTORI  
LËNDA: HISTORI**

**SHKALLA III  
KLASA VI**

**VITI SHKOLLOR 2015-2016**

Nr.	Temat mësimore	Shkathtësitë për realizimin e kompetencave të lëndës	Situata e të nxënit	Burimet
26 27	Kalatë mesjetare shqiptare (2 orë) (situatë e sugjeruar)	<ul style="list-style-type: none"> <li>● Paraqet fakte historike lidhur me kalatë shqiptare;</li> <li>● portretizon kalatë më të shquara shqiptare;</li> <li>● analizon rëndësinë e kalave në përbaljet e pushtimeve të ndryshme në qytetet shqiptare;</li> <li>● krijon një fletëpalosje ose album për një kala shqiptare.</li> </ul>	Mësuësija dhe nxënësit diskutojnë për qytetet shqiptare me kala të ndërtuara në periudhën e mesjetës.	Teksti mësimor; e-libri; Harta e Shqipërisë Materiale fotografike dhe/ose filmike nga kalatë shqiptare, materiale dhe botime të ndryshme për kalatë shqiptare Enciklopedi
<p><b>Tematika 5. Tiparet e sistemeve politike evropiane shekujt XII – XV</b></p> <p>Përshkrimi i tematikës: Përmes kësaj tematike, nxënësit demonstronë njohuri, aftësi/shkathtësi, qëndrime dhe vlera mbi procesin e lindjes së shtet-kombeve: nga copëtimi feudal te mbretëritë e përqendruara, veçoritë e këtij procesi në Europën Perëndimore. Tematika trajton Mbretërinë e Anglisë, atdheun e parlamentarizmit; kalimin nga monarkia absolute në atë kushtetuese: marrëdhëniet midis mbretërve dhe princërve në Angli; lindjen e parlamentarizmit në Angli dhe ndikimin e tij në zhvillimet e mëvonshme historike. Njëpërmet kësaj tematike, nxënësit kuptojnë rëndësinë që pati Karta e Madhe e Lirive si fillesë historike e demokracisë parlamentare. Tematika zhvillon modelin klasik të monarkisë absolute në Francë, copëtimin feudal të saj, hapat e forcimit të monarkisë franceze, karakterin e absolutizmit francez. Njëpërmet kësaj tematike, nxënësit aftësohen dhe për organizimin politik, ekonomik dhe shoqëror të Perandorisë Osmane, zhvillimin e arsimit, artit, kulturës, shkencës në mesjetë. Kjo tematikë sugjerohet të zhvillohet në <b>8 orë</b> mësimore. Për tematikën e dhënë më poshtë janë parashikuar dhe veprimtari/projekte, të cilat jepen në rubrikën “Situata të sugjeruara”. Këto orë veprimtarish/projektesh mësuësive dhe autori i tekstit i integron brenda orëve të tematikës. Tematika së bashku me veprimtaritë/projektet realizojnë kompetencat kërc për të nxënëit gjatë gjithë jetës.</p>				



Nr.	Temat mësimore	Shkathësitë për realizimin e kompetencave të lëndës	Situata e të nxënës	Burimet
28	Fillesat e shtet-kombeve	<ul style="list-style-type: none"> <li>● Përkufizon konceptin <i>shtet-komb</i>;</li> <li>● tregon shtet-kombet në hartën e Europës mesjetare;</li> <li>● përshkruan procesin e kalimit nga copëtimi feudal në shtet-kombe;</li> <li>● dallon veçoritë e procesit të krijimit të shtet-kombeve, në Europën Perëndimore;</li> <li>● përshkruan karakteristikat e sistemit politik të Europës Perëndimore, duke evidentuar forcimin e pushtetit mbretëror.</li> </ul>	Mësuesi/ja dhe nxënësit diskutojnë për qytetet mesjetare, monarkinë absolute dhe tiparet e tyre.	Teksti mësimor; e-libri; Harta e Europës mesjetare Imazhe e foto të ndryshme që i përkasin Europës mesjetare Enciklopedi Materiale nga interneti
29	Mbretëria e Anglisë dhe Monarkia Franceze	<ul style="list-style-type: none"> <li>● Përshkruan marrëdhëniet midis princërve dhe mbretërve në Angli;</li> <li>● vlerëson ndarjen e pushtetit të mbretit nga parlamenti;</li> <li>● vlerëson rolin e Kartës së Madhe të Lirive në respektimin e të drejtave të njeriut;</li> <li>● dallon ndryshimet ndërmjet monarkisë kushtetuese dhe asaj absolute;</li> <li>● shpjegon marrëdhëniet hierarkike midis feudalëve dhe mbretërve në Francë;</li> <li>● përshkruan etapat e zhvillimit të monarkisë franceze, duke evidentuar karakterin klasik të absolutizmin francez.</li> </ul>	Mësuesi/ja dhe nxënësit bashkëbisedojnë për parlamentin dhe monarkinë, rolin dhe funksionin e tyre.	Teksti mësimor; e-libri; Harta e Europës mesjetare Harta e Anglisë dhe Francës Materiale nga interneti për Kartën e Madhe të Lirisë Enciklopedi
30	Ndryshimet ndërmjet sistemeve politike europiane: Anglia dhe Franca	<ul style="list-style-type: none"> <li>● Krahason ndryshimet ndërmjet sistemit politik anglez dhe sistemit politik francez;</li> <li>● evidenton veçoritë kryesore të formimit të shtet-kombeve.</li> </ul>	Nxënësit dhe mësuesi/ja bashkëbisedojnë për shtet-kombet e veçoritë e tyre dhe krahasojnë monarkinë angleze me atë franceze.	Teksti mësimor; e-libri; Harta e Anglisë dhe Francës Materiale nga interneti për Kartën e Madhe të Lirisë Enciklopedi

Nr.	Temat mësimore	Shkathtësitë për realizimin e kompetencave të lëndës	Situata e të nxënës	Burimet
31	Perandoria Osmane	<ul style="list-style-type: none"> <li>Tregon lidhjen midis selxhukëve dhe osmanëve;</li> <li>vë në dukje kushtet historike të formimit të Perandorisë Osmane;</li> <li>përshkruan rrugën e krijimit të shtetit osman;</li> <li>tregon karakterin dhe organizimin politik dhe shoqëror të Perandorisë Osmane.</li> </ul>	Nxënësit risjellin për diskutim çështje të rënies së Perandorisë Bizantine dhe të qytetërimit arab.	Teksti mësimor; e-libri; Harta e Europës mesjetare Harta e Azisë dhe Afrikës Materiale nga interneti për Perandorinë Osmane Enciklopedi
32	Unë jam shqiptar, pasardhës i arbërve (3 orë)	<ul style="list-style-type: none"> <li>Njeh aspekte të jetës në principatën e Arbrit, si: vëndndodhja e saj në hartën e Europës, organizimi shtetëror, zhvillimi urban, kultura dhe besimi;</li> <li>përcakton tiparet të jetës së përditshme në këto principata;</li> <li>diskuton për jetën dhe origjinën e Gjergj Kastriot Skënderbeut;</li> <li>vierëson rolin e tij si hero kombëtar;</li> <li>vierëson jehonën e veprës së Skënderbeut në artin dhe kulturën botërore;</li> <li>vierëson trashëgiminë e qytetërimeve mesjetare.</li> </ul>	Nxënësit dhe mësuesi/ja diskutojnë për pushtimin e Ballkanit nga osmanët dhe qëndresën shqiptare.	Teksti mësimor; e-libri; Harta e Ballkanit Harta e Shqipërisë në epokën e Skënderbeut Materiale të ndryshme, botime, pamje filmike të Skënderbeut dhe luftërave të tij; Enciklopedi
33				
34				
35		<ul style="list-style-type: none"> <li>Testim ose përforsim konceptesh</li> </ul>		
36	Kultura dhe besimi në qytetërimet mesjetare	<ul style="list-style-type: none"> <li>Evidenton tiparet e zhvillimit të artit, kulturës, arsimit në qytetërimet mesjetare;</li> <li>dallon rolin e fesë në qytetërimet mesjetare;</li> <li>krahason tendencat e zhvillimit të artit, kulturës dhe arsimit në qytetërimin arab dhe atë perëndimor;</li> <li>njeh dhe vierëson disa nga figurat historike që i përkasin kësaj tematike, si: Henriku II, Henriku VII, Mbreti Xhon, Uat Tajler, Eduardi i Anglisë, Huniadi, Mehmeti II, Llazari, Skënderbeu etj.</li> </ul>	Nxënësit diskutojnë për artin dhe kulturën në mesjetë.	Teksti mësimor; e-libri; Harta e Europës mesjetare Harta e Azisë dhe Afrikës Materiale nga interneti për kulturën dhe artin mesjetar (përfshirë këtu pamje nga ndërtesa, skulptura, piktura, etj. që i përkasin periudhës së mesjetës) Enciklopedi

## TEMATIKA 1. Qytetërimet botërore në antikitet. Luginat lumore, djepi i qytetërimeve të hershme (mijëvjeçari IV – II pr. K.)

**Përshkrimi i tematikës:** Përmes kësaj tematike, nxënësit demonstrojnë njohuri, aftësi/shkathtësi, qëndrime dhe vlera mbi lindjen e qytetërimeve në luginat lumore dhe tiparet e qytetërimeve të hershme në Mesopotami dhe Egjipt. Kjo tematikë sugjerohet të zhvillohet në 7 orë mësimore. Për tematikën e dhënë më poshtë janë parashikuar dhe veprimtari/projekte, të cilat jepen në rubrikën "Situata të sugjeruara". Këto orë veprimtarish/projektësh, mësuesi/ja dhe autori i tekstit i integrojnë brenda orëve të tematikës. Tematika së bashku me veprimtaritë/projektet realizojnë kompetencat lëndore dhe kompetencat kyç për të nxënit gjatë gjithë jetës.

1

Fusha:	Lënda: Histori	Shkalla: III	Klasa: 6
<b>Tematika 1:</b> • Qytetërimet botërore në antikitet. Luginat lumore, djepi i qytetërimeve të hershme (mijëvjeçari IV- II pr. K.)	<b>Tema mësimore:</b> • <b>Llogaritja e kohës (situatë e sugjeruar)</b>	<b>Situata e të nxënit:</b> • Mësuesi/ja jep situata dhe diskuton me nxënësit rreth llogaritjes së kohës: si llogariten periudhat para dhe pas vitit 1.	

### Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyç:

#### **Kompetenca e të menduarit**

##### **Nxënësi:**

- përdor numrat negativë dhe pozitivë për llogaritjen e kohës;
- zhvillon kompetencën e të menduarit për realizimin e kërkimit historik;
- zhvillon kompetencën për të përzgjedhur burimet, për të interpretuar të shkuarën nëpërmjet informacionit, për të dhënë argumente bazuar në burime dhe për të saktësuar saktësinë e burimeve.

#### **Kompetenca e komunikimit dhe e të shprehurit**

##### **Nxënësi:**

- zhvillon kompetencën e komunikimit për të ndërtuar kompetencat historike, për të shqyrtuar, për të analizuar, për të parashtruar pyetje, për të argumentuar, për të diskutuar dhe për të komunikuar informacionin historik, konceptet dhe idetë.

#### **Kompetenca e të nxënit**

##### **Nxënësi:**

- zbaton në mënyrë të pavarur udhëzimet për një temë, veprim, aktivitet ose detyrë që i kërkohet;
- identifikon përparësitë dhe mangësitë e tij në lidhje me zotërimin e dijeve dhe kompetencave historike në funksion të përparimit dhe përmirësimit të suksesit të tij.

#### **Kompetenca për jetën, sipërmarrjen dhe mjedisin**

##### **Nxënësi:**

- zhvillon një kërkim individual ose në grup për të kryer një veprimtari në histori.

#### **Kompetenca personale**

##### **Nxënësi:**

- kupton, nëpërmjet kërkimit historik, përvojën e njeriut, marrëdhëniet shkak-pasojë, trashëgiminë kulturore, rëndësinë historike, ndryshimet dhe vazhdimësinë që ka pësuar shoqëria përgjatë kohërave;
- përdor aftësitë e komunikimit, punës në grup etj., për të prezantuar dhe argumentuar idetë e tij.

### **Kompetenca qytetare**

#### **Nxënësi:**

- shqyrton një sërë burimesh që paraqesin perspektiva të ndryshme kulturore, në mënyrë që të zhvillojë kuptimin historik.

### **Kompetenca digjitale**

#### **Nxënësi**

- zhvillon kompetencën digjitale për të kërkuar, përzgjedhur, analizuar dhe komunikuar informacion historik;
- përdor një sërë burimesh digjitale të informacionit dhe analizon në mënyrë kritike këto burime historike;
- bashkëpunon, diskuton dhe debaton me të tjerët për të ndërtuar konceptet dhe kompetencat historike.

#### **Rezultatet e të nxënit të kompetencave sipas temës.**

##### **Nxënësi:**

- ndërton dhe lexon vijën e kohës;
- dallon dy periudhat e mëdha historike: para K. dhe pas K.
- ndan periudhat historike në mijëvjeçarë, shekuj dhe vite;
- bën llogaritjen e kohës, duke marrë si bazë vitin 1.

##### **Fjalë kyç:**

- Vijë e kohës
- Kronologji
- Dekadë
- Shekull
- Mijëvjeçar
- Vit

##### **Burimet:**

- Teksti mësimor
- e-libri
- Termometër
- Shkalla e kohës

##### **Lidhja me fushat e tjera dhe me tema ndërkurrikulare:**

- Matematikë

### **Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve:**

**PNP:** Bashkëbisedim - Shpjegim - Punë praktike

#### **Parashikimi:** Bashkëbisedim

Mësuesi/ja e nis orën mësimore me një bashkëbisedim me nxënësit, ku u kërkon atyre të tregojnë se si e përllogaritin kohën në ditët e sotme, duke u nisur nga mosha e tyre, kur kanë lindur, sa vjeç do të jenë pas disa vitesh, si vijnë vitet duke u rritur apo ulur, në çfarë viti jemi, sa vite ka njerëzimi që ekziston etj.




#### **Ndërtimi i njohurive:** Shpjegimi

Në një tabak kartoni mësuesi/ja paraqet vijën e kohës të ndarë nga viti 1 në dy zona, A dhe B. Zona A është “Para lindjes së Krishtit” (para erës së re) dhe zona B është “Pas lindjes së Krishtit” (pas erës së re).

Ai/ajo u shkruan nxënësve në tabelë data të ngjarjeve të ndryshme historike dhe i fton t'i vendosin në **vijën e kohës**, duke pasur parasysh periudhat para dhe pas lindjes së Krishtit.

Lufta e Dytë Ilirio-Romake u zhvillua në vitin 229 para lindjes së Krishtit (pr. K.). Nxënësit e vendosin te zona A. Lojërat e para olimpike u zhvilluan në vitin 776 pr. K. Skënderbeu lindi në vitin 1405 dhe nxënësit e vendosin te zona B, "Pas lindjes së Krishtit". Mësuesi/ja bën dallimet e dy periudhave: para lindjes së Krishtit dhe pas lindjes së Krishtit, ku thekson që vitet vijnë duke u zbritur në periudhën para lindjes së Krishtit dhe duke u rritur në periudhën pas lindjes së Krishtit.



Ai/ajo drejton pyetje si shembull:

- *Cili vit vjen pas vitit 229 para lindjes së Krishtit?*

Në periudhën e hershme, njerëzit nuk e matnin kohën si sot, me kalendar, ditë, orë, javë, shekuj, mijëvjeçar, por e llogarisnin nga ngjarje të rëndësishme që ndodhnin, si: pozicioni i hënës, përmbytjet, tërmetet etj.

Përveçse me vite, koha llogaritet me muaj, shekuj, mijëvjeçarë etj.

Mësuesi/ja shkruan në tabelë:

1 mijëvjeçar = 1 000 vite

1 shekull = 100 vite

1 dekadë = 10 vite

Para lindjes së Krishtit, përllogaritja e kohës fillon nga viti 100 në vitin 1, që është shekulli I para lindjes së Krishtit; viti 200-101 është shekulli II e me radhë, ndërsa pas lindjes së Krishtit shekulli I fillon nga viti 1 dhe mbaron në vitin 100; shekulli II janë vitet 101-200, shekulli 3 janë vitet 201-300 e kështu me radhë.

**Përforcimi i njohurive:** Punë praktike

Punohen në klasë ushtrimet 4, 5 dhe ushtrimin 6 të rubrikës "Ushtrihu", për të përforcuar njohuritë që lidhen me:

- a. llogaritjen e viteve,
- b. përcaktimin e shekujve;
- c. për të dalluar vitet më të hershëm dhe më të vona;
- d. për të shënuar shekujt kur jepen vitet dhe anasjelltas.

**Vlerësimi:**

Vlerësimi bëhet duke pasur parasysh pjesëmarrjen e nxënësve në orën e mësimit në të gjitha etapat e saj dhe duke vënë në dukje rezultatet.

**Detyrë:** Ndërtoni një tabelë të llogaritjes së kohës dhe duke u mbështetur në vijën e kohës:

a) Tregoni cilat nga vitet e mëposhtme janë më të hershme dhe cilat më të vona:

Vitet pas Krishtit: 125 ps. K., 5 ps. K., 2001 ps. K.

Vitet para Krishtit: 125 pr. K., 5 pr. K., 2001 pr. K.

b) Shënoni shekujt që u përkasin këtyre viteve.

**Sqarime për zgjidhjen e ushtrimeve të rubrikës:  
“Gjurmojmë-Mendojmë-Arsyetojnë-Nxjerrim përfundime”**

**Ushtrimi 4.**

Për të gjetur se sa vite ka mes dy datave, kemi dy raste që lidhen me dy veprime matematikore: me mbledhjen dhe zbritjen. Veprimi i mbledhjes (+) përdoret kur të dyja datat u përkasin periudhave të ndryshme (pr. K. dhe ps. K.), si në rastin e ushtrimit 4.  $250 + 250 = 500$ .

Përgjigje: Në mes dy datave apo ngjarjeve ka një periudhë kohore prej 500 vitesh. Një rast i ngjashëm është edhe ky shembull: Mbreti Genti u dorëzua te romakët në vitin 167 pr. K., ndërsa kryengritja e Batos kundër romakëve u zhvillua në vitin 9 ps. K. Mes këtyre dy ngjarjeve kanë kaluar:  $167 + 9 = 176$  vjet. Kështu mund të themi se kryengritja e Batos u zhvillua 176 vjet pas dorëzimit të Gentit te romakët; ose mbreti Genti është dorëzuar te romakët 176 vjet para kryengritjes së Batos. Veprimi matematikor i zbritjes (-) përdoret kur dy datat apo ngjarjet i përkasin një periudhe si pr. K., ashtu dhe ps. K. P.sh., gjithmonë zbritet nga numri më i madh numri më i vogël. Konkretisht: Pavarësia e Shqipërisë ndodhi në vitin 1912, ndërsa pushtimi i vendit nga Italia Fashiste ndodhi në vitin 1939. Në mes këtyre dy ngjarjeve kanë kaluar  $1939 - 1912 = 27$  vjet. Në vitin 229 pr. K. filloi lufta e parë iliro-romake, ndërsa mbretëria ilire ra në vitin 167. Mes të këtyre dy ngjarjeve kanë kaluar  $229 - 167 = 62$  vjet.

**Ushtrimi 5.**

Të synohet që të krijohet një vlerësim i përgjithshëm dhe i shpejtë për përcaktimin e një shekulli për një datë të dhënë në mënyrë mekanike pa përdorur tabelën e kohës. Kemi dy raste:

a. kur data është një numër i plotë me tri apo katër shifra, p.sh. 600 pr. K., 200 ps. K. apo 1500 pr. K. 1600 ps. K. 2000 pr. K. 2000 ps. K. etj. Në këto raste, shifra e parë e datave me tre numra tregon shekullin dhe konkretisht shek. VI pr. K., shek II ps. K., ndërsa datat me katër shifra shekullin e tregojnë dy numrat e parë (mijëshe e qindëshe) dhe konkretisht shek. 15. pr. K., shek. 16 ps. K, shek 29 pr. K. dhe shek. 20 ps. K..

b. Kur numrat nuk janë të plotë, p.sh. 225 ps. K., 750 pr. K., 324 pr. K., 537 ps. K. 850 ps. K. apo 1403 pr. K., 1005 pr. K., 1650 pr. K., 1250 ps. K., 1550 ps. K., 20015 ps. K. Në këto raste, rregulli matematikor është ky: në datat me tri shifra shekullin e shpreh numri i qindësheve plus një dhe konkretisht:  $2 + 1 =$  shek. 3;  $7 + 1 =$  shek. 8;  $3 + 1 =$  shek. 4;  $5 + 1 =$  shek. 6;  $8 + 1 =$  shek. 9. Në rastin e dytë mblidhet numri një me dy shifrat e para (mijëshet e qindëshet) dhe konkretisht:  $14 + 1 =$  shek. 15;  $10 + 1 =$  shek. 2;  $16 + 1 =$  shek. 17;  $12 + 1 =$  shek. 13;  $15 + 1 =$  shek. 16;  $20 + 1 =$  shek. 21. Shekullit të parë i përkasin të gjitha datat që kanë dy apo një shifër si për periudhën ps. K apo pr. K., si vitet 54, 8, 1 pr. K. apo 54, 8, 1 ps. K., pasi shekulli I përfshin vitet 1-100 ps. K. dhe 100 - 1 pr. K.

**Ushtrimi 7.**

a. Viti më i hershëm ps. K. është viti 125, sepse është shumë larg nesh dhe viti 2001 më i vonë se është më afër nesh.

b. Viti më i hershëm pr. K. është viti 2001 dhe më i vonë, pra më i afërm, është viti 125.

Fusha:	Lënda: Histori	Shkalla: III	Klasa: 6
<b>Tematika 1:</b> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Qytetërimet botërore në antikitet. Luginat lumore, djepi i qytetërimeve të hershme (mijëvjeçari IV - II pr. K.)</li> </ul>	<b>Tema mësimore:</b> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Lindja e qytetërimeve në luginat lumore</li> </ul>	<b>Situata e të nxënit:</b> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Mësuesi/ja diskuton me nxënësit rreth lindjes së qytetërimeve në luginat lumore.</li> </ul>	
<p><b>Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyç:</b></p> <p><b>Kompetenca e komunikimit dhe e të shprehurit</b>  <b>Nxënësi:</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• zhvillon kompetencën e komunikimit për të ndërtuar kompetencat historike për të shqyrtuar, për të analizuar, për të parashtruar pyetje, për të argumentuar, për të diskutuar dhe për të komunikuar informacionin historik, konceptet dhe idetë.</li> </ul> <p><b>Kompetenca personale</b>  <b>Nxënësi:</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• zhvillon mendimin krijues për të ndërtuar interpretime të reja, të cilat shpjegojnë aspekte të së shkuarës, që janë të diskutueshme.</li> </ul> <p><b>Kompetenca qytetare</b>  <b>Nxënësi:</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• kupton se si qytetërimet dhe shoqëritë janë formuar nga grupe njerëzish me kultura të ndryshme;</li> <li>• identifikon dallimet dhe ngjashmëritë ndërmjet kulturave të ndryshme dhe kultivon respekt ndaj kulturave të ndryshme nga ajo e tij.</li> </ul>			
<p><b>Rezultatet e të nxënit të kompetencave sipas temës.</b>  <b>Nxënësi:</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• tregon në hartë vendndodhjen e qytetërimeve që lindën në brigjet e lumenjve (Mesopotami, Egjipt);</li> <li>• përcakton kohën e lindjes së qytetërimeve në Mesopotami dhe Egjipt;</li> <li>• vlerëson rolin e mjedisit gjeografik në lindjen dhe zhvillimin e qytetërimit në (Mesopotami, Egjipt);</li> <li>• krahason dy qytetërimet dhe përcakton të përbashkëtat dhe dallimet ndërmjet tyre.</li> </ul>		<p><b>Fjalë kyç:</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Luginë lumore</li> <li>• Mesopotami</li> <li>• Egjipt</li> <li>• Gjysmëhëna pjellore</li> <li>• Oazë</li> <li>• Deltë</li> </ul>	
<p><b>Burimet:</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Teksti mësimor, e-libri</li> <li>• Harta</li> <li>• Enciklopedi</li> <li>• Materiale nga interneti</li> </ul>		<p><b>Lidhja me fushat e tjera dhe me tema ndërkurrikulare:</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Gjeografi</li> <li>• Art pamor</li> </ul>	




## Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve:

PNP: Stuhi mendimesh - Shpjegim - Punë me tekstin

### Parashikimi: Stuhi mendimesh

Mësuesi/ja shkruan në tabelë fjalën “Qytetërimet e para” dhe i pyet nxënësit se çfarë dinë rreth tyre, ku shtriheshin, çfarë kanë dëgjuar për to dhe çfarë informacionesh mund të sjellin. Ajo shkruan në tabelë disa nga përgjigjet, të cilat ndihmojnë në marrjen e njohurive të reja.



### Ndërtimi i njohurive:

#### 1. Shpjegim

Qytetërimi egjiptian lindi në brigjet e lumit Nil. Në brigjet e lumenjve të tjerë lindën qytetërimet të tjera, si ai mesopotam (luginat e lumenjve Tigër dhe Euftrat), qytetërimi indian (lumi Ind), qytetërimi kinez (Lumi i Verdhë dhe lumi Jance etj).

Mësuesi/ja pyet:

- Pse qytetërimet lindën buzë lumenjve?

Nxënësit nxiten të argumentojnë me përgjigjet e tyre, duke sjellë fakte, të cilat mund të jenë:

1. Sepse uji është burimi kryesor për jetën, për peshkim (florën dhe faunën ujore) ujitje të tokave, për tregti, për transport.
2. Sepse luginat lumore kishin klimë të ngrohtë.
3. Sepse në këto brigje kishte tokë të mjaftueshme dhe ishin mjedise shumë të përshtatshme për të jetuar.

Sipas zbulimeve arkeologjike, dallohen dy periudha kohore që lidhen me lindjen dhe zhvillimin e lulëzimin e qytetërimeve:

- I) nga mijëvjeçari i katërt deri në të tretin **lindën** qytetërimet e hershme dhe
- II) nga mijëvjeçari i tretë deri në të parin **lulëzuan** qytetet e hershme.

#### 2. Plotësimi i skemës: Kronologjia.

Të vendosen dy segmente:


a. shek.IV-III, b. shek.III-I

Në periudhën e parë, veprimtaria kryesore e njerëzve është bujqësia dhe blegtoaria.

Në periudhën e dytë lindën qytetet dhe u zhvillua ekonomia. Klima e ngrohtë pranë luginave lumore mundësonte një mjedis të përshtatshëm për të jetuar.

Prandaj, luginat e lumenjve Nil, Tigër e Euftrat janë quajtur streha e parë e qytetërimeve botërore.

Këto luginat, që së bashku në hartë paraqesin pamjen e gjysmëhënës, janë quajtur “Gjysmëhëna e begatë”.



Luginat e lumenjve Tigër, Euftrat e Nil së bashku paraqesin pamjen e një gjysmëhëne, ndaj janë quajtur “Gjysmëhëna e begatë ose pjellore”



Këto lugina kishin disa tipare të përbashkëta, si: klimë të thatë me pak reshje dhe lumenj të mëdhenj e të lundrueshëm. Përveç tipareve të përbashkëta, këto lugina kishin edhe dallime. P.sh., lumi Nil kishte regjim ujor të qëndrueshëm (dilte nga shtrati në muajt korrik dhe shtator), ndërsa lumenjtë Tigër dhe Eufrat dilnin nga shtrati shpesh, duke përmbytur tokat e mbjella me kultura bujqësore. Ndryshim tjetër ishte pozicioni gjeografik: lugina e Nilit kufizohej me shkretëtirën, ndërsa Mesopotamia kishte pozicion të favorshëm; ajo kishte lidhje me tri kontinente dhe kishte komunikim me fqinjët.

**Përforcimi i njohurive:** Punë me tekstin

Në këtë fazë të orës mësimore punohet me rubrikën "Gjurmojmë, mendojmë..."

Mësuesi/ja orienton nxënësit të:

- plotësojnë skemën "Lulëzimi i qytetërimeve";
- tregojnë në hartë shtrirjen e qytetërimeve që lindën në brigjet e lumenjve;
- tregojnë veprimtaritë e njerëzve gjatë qytetërimeve të hershme dhe lulëzimit të tyre.

**Vlerësimi:**

Vlerësimi bëhet duke pasur parasysh ose duke ndjekur pjesëmarrjen e nxënësve në orën e mësimit në të gjitha etapat e saj e duke i vënë në dukje rezultatet.

**Detyrë:** Kërkoni në internet shtetet që shtrihen sot në territorin e *gjysmëhënës pjellore*. Krijoni një hartë memece dhe plotësojeni atë me shtetet përkatëse.

**Sqarime për zgjidhjen e ushtrimeve të rubrikës:**

**Gjurmojmë-Mendojmë-Arsyetojnë-Nxjerrim përfundime**

**Ushtrimi 3.** "Lulëzimi i qyteteve".

Skema e këtij ushtrimi ka këtë përgjigje: bujqësia, blegtoria, tregtia lindën qytetet, u formuan shtetet, u shpik shkrimi, u zhvilluan: feja, arti, shkenca. Mësuesi/ja duhet t'u tërheqë vëmendjen nxënësve edhe për dy elemente, që lidhen me zhvillimin e qytetërimit, siç është ndarja e punës siç e shpreh skema dhe lindja e shtresave shoqërore, si: bujq, blegtorë, artizanë, tregtarë, nëpunës, sundimtarë, klerikë, artistë, mësues, shkencëtarë etj.

**Ushtrimi 10.**

Në territorin e "Gjysmëhënës pjellore" sot gjenden këto shtete: Iraku, Kuvajti, Siria, Libani, Jordania, Izraeli, Palestina, Qiproja dhe Egjipti.

Fusha:	Lënda: Histori	Shkalla: III	Klasa: 6
<b>Tematika 1:</b> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Qytetërimet botërore në antikitet. Luginat lumore, djepi i qytetërimeve të hershme (mijëvjeçari IV- II pr. K.)</li> </ul>	<b>Tema mësimore:</b> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Qytetërimi në Mesopotami</li> </ul>	<b>Situata e të nxënit:</b> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Mësuesi/ja ndërlihd temën e re me njohuritë paraprake që kanë nxënësit duke i shprehur ato sipas një radhitjeje logjike dhe duke i pasuruar me informacion të ri.</li> </ul>	
<b>Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyç:</b>			
<b>Kompetenca e komunikimit dhe e të shprehurit</b>			
<b>Nxënësi:</b> <ul style="list-style-type: none"> <li>• zhvillon kompetencën e komunikimit për të ndërtuar kompetencat historike për të shqyrtuar, për të analizuar, për të parashtruar pyetje, për të argumentuar, për të diskutuar dhe për të komunikuar informacionin historik, konceptet dhe idetë.</li> </ul>			
<b>Kompetenca e të nxënit</b>			
<b>Nxënësi:</b> <ul style="list-style-type: none"> <li>• zhvillon kompetencën e të nxënit për të shfrytëzuar të dhënat për të demonstruar të kuptuarit e koncepteve historike dhe shoqërore, duke i prezantuar nëpërmjet formave të ndryshme të të shprehurit;</li> <li>• ndërlihd temën e re ose një çështje të dhënë me njohuritë dhe përvojat paraprake, duke i paraqitur në forma të ndryshme të të shprehurit sipas një radhitjeje logjike;</li> <li>• parashtron pyetje kërkimore dhe përgjigjet duke u bazuar në argumente dhe burime.</li> </ul>			
<b>Kompetenca për jetën dhe mjedisin</b>			
<b>Nxënësi:</b> <ul style="list-style-type: none"> <li>• zhvillon kompetencën për jetën dhe mjedisin për të identifikuar dhe vlerësuar burimet e nevojshme për interpretimin e ngjarjes historike.</li> </ul>			
<b>Kompetenca e të menduarit</b>			
<b>Nxënësi:</b> <ul style="list-style-type: none"> <li>• zhvillon mendimin krijues për të ndërtuar interpretime të reja, të cilat shpjegojnë aspekte të së shkuarës, që janë të diskutueshme;</li> <li>• zhvillon mendimin kritik për të përzgjedhur burimet, për të interpretuar të shkuarën nëpërmjet informacioneve, për të dhënë argumente bazuar në burime dhe për të saktësuar saktësinë e burimeve.</li> </ul>			
<b>Kompetenca qytetare</b>			
<b>Nxënësi:</b> <ul style="list-style-type: none"> <li>• evidenton se si qytetërimet dhe shoqëritë janë formuar nga grupe njerëzish me kultura të ndryshme;</li> <li>• identifikon dallimet dhe ngjashmëritë ndërmjet kulturave të ndryshme dhe kultivon respekt ndaj kulturave të ndryshme nga e tij;</li> <li>• zhvillon mirëkuptimin ndërkulturor, duke vlerësuar kulturat, gjuhët dhe besimet e ndryshme;</li> <li>• kupton perspektivat, besimet dhe qëndrimet e njerëzve në të shkuarën e në të tashmen dhe rëndësinë e njohjes së historisë së tyre dhe të tjerëve;</li> <li>• shqyrton një sërë burimesh që paraqesin perspektiva të ndryshme kulturore, në mënyrë që të zhvillojë kuptimin historik.</li> </ul>			

<p><b>Rezultatet e të nxënit të kompetencave sipas temës.</b></p> <p><b>Nxënësi:</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• përshkruan veçoritë e ndërtimit shoqëror në Mesopotami;</li> <li>• përshkruan veçoritë e zhvillimit ekonomik në Mesopotami;</li> <li>• tregon tiparet e organizimit shtetëror në Mesopotami;</li> <li>• tregon rolin e ligjeve të Hamurabit në zhvillimet ekonomike, shoqërore e politike në Mesopotami.</li> </ul>	<p><b>Fjalë kyç:</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Shtresë shoqërore</li> <li>• Prift</li> <li>• Skllav</li> <li>• Sumer</li> <li>• Qytet-shtet</li> <li>• Dinasti</li> <li>• Ujitje artificiale</li> <li>• Punë angari</li> </ul>
<p><b>Burimet:</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Teksti mësimor</li> <li>• e-libri (teksti elektronik)</li> <li>• Harta</li> <li>• Enciklopedi</li> <li>• Materiale nga interneti</li> </ul>	<p><b>Lidhja me fushat e tjera dhe me tema ndërkurrikulare:</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Gjeografi</li> </ul>

**Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve:**


**PNP:** Stuhi mendimesh - Ditari dypjesësh - Punë me tekstin

**Parashikimi:** Stuhi mendimesh

Mësuesi/ja duke pasur parasysh njohuritë e nxënësve nga mësimi i kaluar, u kërkon atyre të rikujtojnë të gjitha njohuritë rreth Mesopotamisë. Ai/ajo u drejton nxënësve pyetjen:

- *Çfarë dini për qytetërimin mesopotam?*

Përgjigjet e nxënësve shkruhen në dërrasë të zezë, ku mësuesi/ja ka vizatuar një skemë të thjeshtë.




**Ndërtimi i njohurive:** Ditari dypjesësh

Mësuesi/ja orienton nxënësit të lexojnë pjesën e parë të tekstit "Ndërtimi i shoqërisë në Mesopotami", duke u ndalur në pikat kryesore dhe ndërton skemën e ditarit dypjesësh në tabelë, të cilën e plotëson së bashku me nxënësit.

<b>Çështja</b>	<b>Komenti</b>
Ndërtimi i shoqërisë në Mesopotami	<ul style="list-style-type: none"> <li>Shoqëria në Mesopotami ishte e ndarë në shtresa të hapura, që do të thotë se mund të kaloje nga një shtresë në tjetrën po të ndryshoje gjendjen ekonomike.</li> </ul>

Mësuesi/ja ndërton në dërrasën e zezë piramidën e shtresave shoqërore në qytetërimin mesopotam dhe së bashku me nxënësit diskutojnë rolin e secilës shtresë, duke theksuar se skllevërit ishin shtresa më e shtypur.



Shoqëria në Mesopotami ishte më e zhvilluar dhe më e hapur se në të gjitha vendet e tjera të botës së lashtë.

<b>Çështja</b>	<b>Komenti</b>
Zhvillimi i jetës ekonomike	<ul style="list-style-type: none"> <li>U zhvilluan degët e ekonomisë, si: bujqësia, blegtoria, zejtaria, tregtia etj.</li> <li>Mesopotamia u shndërrua nga një vend kënetor në një vend të begatë.</li> <li>U ndërtuan kanale ujitëse, kulluese, shadufe, rezervuarë.</li> <li>U shpik parmenda e tërhequr nga kafshët, që i dha hov bujqësisë.</li> <li>Në zejtari u zhvilluan shumë zanate e profesione.</li> <li>Tregtia ndihmoi në përhapjen e kulturës mesopotame me vendet e tjera.</li> </ul>
Organizimi shtetëror	<p>Përfshin katër periudha dinastike me qytet-shtete të ndara, të pavarura dhe në konflikt me njëri-tjetrin:</p> <ol style="list-style-type: none"> <li><b>Dinastia Sumero-akade</b>, ku u bë bashkimi i qyteteve nën kryesinë e qytetit Ur;</li> <li><b>Dinastia Babilonase</b>, që arriti lulëzimin në kohën e Mbretit Hamurab (1792-1750 pr. K.), i cili hartoi sistemin e ligjeve, përfshirë këtu edhe kodin që njihet me emrin <i>Kodi i Hamurabit</i>;</li> <li><b>Dinastia Asiriane</b> në mijëvjeçarin e dytë, me kryeqytet Ninivën;</li> <li><b>Dinastia e Babilonisë së Re</b>, me mbret Nabukodonozorin.</li> </ol> <p>Në vitin 539 pr. K. persët pushtuan Mesopotaminë.</p>



**Përforcimi i njohurive:** Punë me tekstin

Nxënësit punojnë rubrikën "Gjurmojmë - Mendojmë..."

-Punohet ushtrimi 2, ku nxënësit:

- a) evidentojnë në hartë mbretëritë që u krijuan dhe ato që patën zgjerimin më të madh territorial;
- b) evidentojnë rolin që pati mjedisi në zgjerimin e mbretërive.

-Punohet ushtrimi 3, ku nxënësit japin mendimi e tyre mbi strukturën e shoqërisë në Mesopotami.

-Punohet ushtrimi 4, ku nxënësit diskutojnë sa të barabarta dhe të drejta janë ligjet e Hamurabit.

**Vlerësimi:**

Vlerësimi bëhet duke pasur parasysh pjesëmarrjen e nxënësve në orën e mësimit në të gjitha etapat e saj e duke i vënë në dukje rezultatet.

**Detyrë:** Gjeni në internet ose burime të tjera disa ligje të tjera nga Kodi i Hamurabit dhe shkruajini në fletore.

**Sqarime për zgjidhjen e ushtrimeve të rubrikës:  
Gjurmojmë-Mendojmë-Arsyetojnë-Nxjerrim përfundime**

**Ushtrimi 2.**

Zgjerimin më të madh, siç e tregon harta, duke u mbështetur në legjendën e saj, e arriti Mbretëria Asiriane. Mbretëritë në Mesopotami u zgjeruan nga veriu dhe veriperëndimi, sepse në atë drejtim nuk kishin pengesa natyrore, që ta vështirësonin zgjerimin e tyre. (Në këtë përgjigje mësuesi/ja mbështetet te vlerat e mjedisit, pa trajtuar aspekte të tjera politike, siç ishte lindja e shtetit pers në Lindje etj.)

**Ushtrimi 5.**

Veçoritë e emancipimit të shoqërisë në Mesopotami janë:

- a. Jeta në shoqërinë e Mesopotamisë mbështetej në ligje.
- b. Shtresat shoqërore ishin të hapura.
- c. Sundimtari nuk vlerësohej si Zot.
- d. Gruaja gëzonte mjaft të drejta.
- e. Ishte zhvilluar mjaft kultura, arti dhe shkenca.

**Ushtrimi 6.**

Ligji merr vlerë reale kur:

- a. Jo vetëm hartohet e shpallet, por kur zbatohet realisht.
  - b. Kur të gjithë qytetarët janë të barabartë përpara ligjit. Ai e humbet vlerën e vet kur ai zbatohet pjesërisht apo në mënyrë selektive (për disa po e për disa jo).
- Kërkohet që nxënësi t'i gjykojë ligjet e Hamurabit në këtë këndvështrim.

**Ushtrimi 7.**

- Të organizohet një diskutim në klasë me këtë tematikë:

- a. - A njihet nga nxënësit rregullorja e shkollës apo e klasës nëse ka?
- b. - Si duhet vlerësuar ajo?
- c. - Cilat janë të drejtat e detyrat e nxënësit, mësuesit (shkollës) dhe prindit?
- ç. - Çfarë ndodh kur ajo nuk zbatohet apo zbatohet në mënyrë selektive etj.?

Fusha:	Lënda: Histori	Shkalla: III	Klasa: 6
<b>Tematika 1:</b> <ul style="list-style-type: none"> <li>Qytetërimet botërore në antikitet. Luginat lumore, djepi i qytetërimeve të hershme (mijëvjeçari IV- II pr. K.)</li> </ul>	<b>Tema mësimore:</b> <ul style="list-style-type: none"> <li>Qytetërimi egjiptian</li> </ul>	<b>Situata e të nxënit:</b> <ul style="list-style-type: none"> <li>Mësuesi/ja ndërlidh temën e re me njohuritë paraprahe që kanë nxënësit duke i shprehur ato sipas një radhitjeje logjike.</li> </ul>	
<b>Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyç:</b> <b>Kompetenca e komunikimit dhe e të shprehurit</b> <b>Nxënësi:</b> <ul style="list-style-type: none"> <li>zhvillon kompetencën e komunikimit për të ndërtuar kompetencat historike për të shqyrtuar, për të analizuar, për të parashtruar pyetje, për të argumentuar, për të diskutuar dhe për të komunikuar informacionin historik, konceptet dhe idetë.</li> </ul> <b>Kompetenca e të nxënit</b> <b>Nxënësi:</b> <ul style="list-style-type: none"> <li>zhvillon kompetencën e të nxënit për të shfrytëzuar të dhënat për të demonstruar të kuptuarit e koncepteve historike dhe shoqërore, duke i prezantuar nëpërmjet formave të ndryshme të të shprehurit;</li> <li>ndërlidh temën e re ose një çështje të dhënë me njohuritë dhe përvojat paraprahe, duke i paraqitur në forma të ndryshme të të shprehurit sipas një radhitjeje logjike;</li> <li>parashtron pyetje kërkimore dhe përgjigjet duke u bazuar në argumente dhe burime.</li> </ul> <b>Kompetenca për jetën dhe mjedisin</b> <b>Nxënësi:</b> <ul style="list-style-type: none"> <li>zhvillon kompetencën për jetën dhe mjedisin për të identifikuar dhe vlerësuar burimet e nevojshme për interpretimin e ngjarjes historike.</li> </ul> <b>Kompetenca e të menduarit</b> <b>Nxënësi:</b> <ul style="list-style-type: none"> <li>zhvillon mendimin krijues për të ndërtuar interpretime të reja, të cilat shpjegojnë aspekte të së shkuarës, që janë të diskutueshme;</li> <li>zhvillon mendimin kritik për të përzgjedhur burimet, për të interpretuar të shkuarën nëpërmjet informacionit, për të dhënë argumente bazuar në burime dhe për të saktësuar saktësinë e burimeve.</li> </ul> <b>Kompetenca qytetare</b> <b>Nxënësi:</b> <ul style="list-style-type: none"> <li>kupton se si qytetërimet dhe shoqëritë janë formuar nga grupe njerëzish me kultura të ndryshme, identifikon dallimet dhe ngjashmëritë ndërmjet kulturave të ndryshme dhe kultivon respekt ndaj kulturave të ndryshme nga e tij;</li> <li>zhvillon mirëkuptimin ndërkulturor, duke vlerësuar kulturat, gjuhët dhe besimet e ndryshme;</li> <li>kupton perspektivat, besimet dhe qëndrimet e njerëzve në të shkuarën e në të tashmen dhe rëndësinë e njohjes së historisë së tyre dhe të tjerëve;</li> <li>shqyrton një sërë burimesh që paraqesin perspektiva të ndryshme kulturore, në mënyrë që të zhvillojë kuptimin historik.</li> </ul>			

<p><b>Rezultatet e të nxënit të kompetencave sipas temës.</b>  <b>Nxënësi:</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• përshkruan veçoritë e ndërtimit shoqëror në Egjipt;</li> <li>• përshkruan veçoritë e zhvillimit ekonomik në Egjipt;</li> <li>• tregon tiparet e organizimit shtetëror në Egjipt.</li> </ul>	<p><b>Fjalë kyç:</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Faraon</li> <li>• Të privilegjuar</li> <li>• Të paprivilegjuarit</li> <li>• Tempull</li> <li>• Papirus</li> </ul>
<p><b>Burimet:</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Teksti mësues, e-libri</li> <li>• Harta</li> <li>• Enciklopedi</li> <li>• Materiale nga interneti</li> </ul>	<p><b>Lidhja me fushat e tjera dhe me tema ndërkurrikulare:</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Gjeografi</li> <li>• Art pamor</li> </ul>

**Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve:**

**PNP:** Stuhi mendimesh - Ditari dypjesësh - Punë me tekstin

**Parashikimi:** Stuhi mendimesh

Mësuesi/ja, duke pasur parasysh njohuritë që kanë marrë nxënësit për Egjiptin, u kërkon të sjellin në mendje të gjithë informacionin që kanë për këtë vend. Ai/ajo shkruan në dërrasë të zezë "Egjipt" dhe kërkon që nxënësit të plotësojnë skemën.

```

graph TD
    A(Lulëzoi në luginën e Nilit) --- B(Egjipti)
    C(U zhvillua bujqësia, tregtia, artet, feja) --- B
    D(Kufizohej nga shkretëtirat) --- B
    E(Sundohej nga faraonët) --- B
    
```

Nxënësit e ndërtojnë dhe plotësojnë këtë skemë edhe në fletoret e tyre.

**Ndërtimi i njohurive:** Ditari dypjesësh

Mësuesi/ja orienton nxënësit të lexojnë pjesën e parë të tekstit duke u ndalur në pikat kryesore dhe ndërton në tabelë skemën e ditarit dypjesësh, të cilën e plotëson së bashku me nxënësit.

<b>Çështja</b>	<b>Komentit</b>
Ndërtimi i shoqërisë në Egjipt	Shoqëria në Egjipt ishte e ndarë në shtresa të mbyllura, që do të thotë se nuk mund të kaloje dot nga një shtresë në tjetrën.

Mësuesi/ja ndërton piramidën e shtresave në shoqërinë e lashtë egjiptiane dhe e plotëson atë së bashku me nxënësit.



Faraoni, priftërinjtë, nobilët dhe shkruerit përbënin elitën ose shtresën e privilegjuar. Të paprivilegjuarit përbënin pjesën më të madhe të popullsisë, që ishin zejtarët, fshatarët, sklevërit. Ata bënë punë angari në bujqësi, ndërtim etj. Kjo ishte shtresë e shtypur.

<b>Çështja</b>	<b>Komenti</b>
Jeta ekonomike	<ul style="list-style-type: none"> <li>• U zhvilluan degët e ekonomisë, si: bujqësia, blegtoaria, industria, tregtia etj.</li> <li>• Bujqësia ishte dega kryesore, me kultura, si: gruri, elbi, papirusi; me sistem ujor të zhvilluar etj.</li> <li>• Blegtoaria kishte karakter shtëpiak.</li> <li>• Zejtaria u zhvillua shumë me zeje, si: përpunimi i bakrit, hekurit, arit, argjendit; punimi i drurit, endja.</li> <li>• Tregtia bëhej brenda dhe jashtë vendit me rrugë tokësore dhe detare. Ajo ndihmoi në ndërthurjen e kulturave dhe zhvillimin e qytetërimit botëror.</li> </ul>
Organizimi shtetëror	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Në shek. IV Egjipti ishte i ndarë në 42 shtete të vogla, të pavarura dhe në konflikt me njëri-tjetrin.</li> <li>• Më 3800 pr. K., sundimtari Mene bashkoi Egjiptin dhe krijoi shtetin e parë të bashkuar.</li> <li>• Shteti i Egjiptit kishte monarki të trashëgueshme.</li> <li>• Faraoni (mbreti) e drejtonte shtetin me aparat të madh burokratik. Nuk kishte gjyqe të përhershme (si në Mesopotami).</li> <li>• Në Egjipt kanë ekzistuar tri mbretëri: 1. Mbretëria e Vjetër, 2. Mbretëria e Mesme, 3. Mbretëria e Re.</li> <li>• Në vitin 525 pr. K. Egjipti u pushtua nga persët e më vonë nga romakët.</li> </ul>

**Përforcimi i njohurive:** Punë me tekstin

Nxënësit punojnë rubrikën “Gjurmojmë-Mendojmë-Arsyetojmë-Nxjerrim përfundime”.

- Punohet me hartën për të evidentuar mbretëritë që u krijuan në Egjipt.
- Ndërtohet dhe gjykohet struktura e shoqërisë në Egjipt.
- Diskutohet si kuptohet shprehja “shtresa të mbyllura”: a e pengojnë ato zhvillimin e shoqërisë?



**Vlerësimi:**

Vlerësimi bëhet duke pasur parasysh pjesëmarrjen e nxënësve në orën e mësimit në të gjitha etapat e saj e duke vënë në dukje rezultatet.

**Detyrë:** Mblidhni materiale nga interneti rreth piramidave në Egjipt, për kohën dhe mënyrën e ndërtimit të tyre dhe paraqiteni punimin tuaj para klasës. Diskutoni rreth materialeve që keni mbledhur.

**Sqarime për zgjidhjen e ushtrimeve të rubrikës:  
Gjurmojmë-Mendojmë-Arsyetojmë-Nxjerrim përfundime**

**Ushtrimi 4.**

a. Jetë më të qetë e më të pasur bënë shkruarit. Ata hynin në shtresën e të privilegjuarve, vlerësoheshin, paguheshin dhe punonin kryesisht në sferën e administratës, tempujve, ushtri pranë oborrit mbretëror etj.

b. më të rëndësishëm ishin bujqit, sepse me punën e tyre e detyrimet që kryenin ata mbanin shtetin.

**Ushtrimi 5.**

"Shtresat e mbyllura" e pengonin shumë zhvillimin, sepse nuk vlerësohej meritokracia, baza e zhvillimit të një shoqërie, por origjina shoqërore, e cila sillte në poste drejtuese edhe njerëz të paaftë.

**Ushtrimi 6.**

Ndërtimet e mëdha në Egjipt, si: sistemi ujqor, tempujt, pallatet mbretërore, piramidat etj., ishin kryesisht vepër e punës së papaguar (angarisë) të bujqve.

Fusha:	Lënda: Histori	Shkalla: III	Klasa: 6
<b>Tematika 1:</b> ● Qytetërimet botërore në antikitet. Luginat lumore, djepi i qytetërimeve të hershme (mijëvjeçari IV- II pr. K.)	<b>Tema mësimore:</b> ● <b>Kultura dhe besimi në Mesopotami dhe Egjipt</b>	<b>Situata e të nxënit:</b> ● Mësuesi/ja zgjedh të dhëna nga burime të ndryshme për të demonstruar të kuptuarin e koncepteve në lidhje me temën.	
<p><b>Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyç:</b>  <b>Kompetenca e komunikimit dhe e të shprehurit</b>  <b>Nxënësi:</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>● zhvillon kompetencën e komunikimit për të ndërtuar kompetencat historike për të shqyrtuar, për të analizuar, për të parashtruar pyetje, për të argumentuar, për të diskutuar dhe për të komunikuar informacionin historik, konceptet dhe idetë.</li> </ul> <p><b>Kompetenca e të menduarit</b>  <b>Nxënësi:</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>● zhvillon mendimin kritik për të përzgjedhur burimet, për të interpretuar të shkuarën nëpërmjet informacionit, për të dhënë argumente bazuar në burime dhe për të saktësuar saktësinë e burimeve.</li> </ul> <p><b>Kompetenca qytetare</b>  <b>Nxënësi:</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>● zhvillon mirëkuptimin ndërkulturor, duke vlerësuar kulturat, gjuhët dhe besimet e ndryshme;</li> <li>● kupton se si qytetërimet dhe shoqëritë janë formuar nga grupe njerëzish me kultura të ndryshme, identifikon dallimet dhe ngjashmëritë ndërmjet kulturave të ndryshme dhe kultivon respekt ndaj kulturave të ndryshme nga e tij;</li> <li>● shqyrton një sërë burimesh që paraqesin perspektiva të ndryshme kulturore, në mënyrë që të zhvillojë kuptimin historik.</li> </ul> <p><b>Kompetenca personale</b>  <b>Nxënësi:</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>● kupton nëpërmjet kërkimit historik përvojën e njeriut, marrëdhëniet shkak-pasojë, trashëgiminë kulturore, rëndësinë historike, ndryshimet dhe vazhdimësinë që ka pësuar shoqëria përgjatë kohërave.</li> </ul>			
<p><b>Rezultatet e të nxënit të kompetencave sipas temës.</b>  <b>Nxënësi:</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>● analizon kulturën materiale e shpirtërore të qytetërimeve në Mesopotami dhe Egjipt;</li> <li>● dallon karakteristikat e përbashkëta dhe të veçantat ndërmjet dy kulturave;</li> <li>● vlerëson rolin e arritjeve të këtyre qytetërimeve në jetën e sotme;</li> <li>● njeh dhe vlerëson disa nga figurat historike që i përkasin kësaj tematike, si Sargoni, Hamurabi, Menesi, Ramsesi II etj.</li> </ul>		<p><b>Fjalë kyç:</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>● Politeist</li> <li>● Kult</li> <li>● Hieroglif</li> <li>● Shkrim kuneiform</li> <li>● Mozaik</li> <li>● Reliev</li> </ul>	



<p><b>Burimet:</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Teksti mësimor, e-libri</li> <li>• Harta</li> <li>• Pamje e foto të zotave të ndryshëm</li> <li>• Enciklopedi</li> <li>• Materiale nga interneti</li> </ul>	<p><b>Lidhja me fushat e tjera dhe me tema ndërkurrikulare:</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Gjeografi</li> <li>• Art pamor</li> </ul>
---	--

**Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve:**

**PNP:** Parashikimi me terma paraprakë - Skema e mendjes - Punë me tekstin

**Parashikimi:** Parashikimi me terma paraprakë


Mësuesi/ja i njih nxënësit me temën e re. Shkruan disa fjalë në tabelë, si: *priftërinj, tempull, besim fetar, Zot, faraon* dhe u tregon disa figura të perëndive në Egjipt. Ajo u kërkon nxënësve të bëjnë lidhjen e këtyre fjalëve dhe figurave me temën e mësimin. Duke marrë shkas nga përgjigjet e nxënësve, mësuesi/ja bën të mundur edhe ndërtimin e njohurive.



Disa nga perënditë kryesore në Egjiptin e lashtë

**Ndërtimi i njohurive:** Skema e mendjes

Mësuesi/ja orienton nxënësit të lexojnë pjesën e parë, që flet për veçoritë e besimin në Egjipt dhe Mesopotami dhe plotëson skemën.




Perënditë paraqiteshin me trupin e njeriut dhe kokë kafshe (këtu mësuesi/ja tregon disa pamje të perëndive të lashta me trup njeriu dhe kokë kafshe).




Skulpturë e Perëndisë Anubis, me kokë çakalli





Skulpturë e perëndisë Ra, me kokë fajkoi



Në Mesopotami çdo mbretëri kishte zotat e vet:



Më pas mësuesja shpjegon se përveç besimit, pjesë përbërëse e kulturës janë edhe arti e shkenca, të cilat arritën një shkallë të lartë zhvillimi në Mesopotami dhe në Egjipt dhe ndikuan edhe në zhvillimin e mëvonshëm të qytetërimit botëror.



Në fund, mësuesi/ja thekson se të gjitha këto arritje në fusha të ndryshme kanë pasur një ndikim të madh në zhvillimin e qytetërimit botëror. Këto qytetërime e lashta i dhuruan njerëzimit dhe të gjithë botës shpikje të mëdha, si: shpikja e shkrimit, që solli lindjen e historisë duke u mbështetur në burime shkrimore dhe kalendarin e mbështetur në sistemin hënor; shpikja e sistemit ujor, anijes me vela, letrës, njohuritë e para mjekësore, kodet ligjore, bitumi etj.

**Përforcimi i njohurive:** Punë me tekstin

Në këtë fazë të orës mësimore punohet me rubrikën “Gjurmojmë-Mendojmë-Arsyetojmë-Nxjerrim përfundime”: Për të verifikuar marrjen e njohurive, mësuesi/ja drejton disa pyetje përmbledhëse:

- Cilat ishin veçoritë në besimet e popujve?
- Çfarë janë tempujt dhe kush shërbente në ta?
- Çfarë solli lindja e shkrimit?
- Si arritën egjiptianët të krijonin ndërtime madhështore?

**Vlerësimi:**

Vlerësimi bëhet duke pasur parasysh ose duke ndjekur pjesëmarrjen e nxënësve në orën e mësimit në të gjitha etapat e saj e duke i vënë në dukje rezultatet.

**Detyrë:**

- Përgatisni një album me pamje të qytetërimit mesopotam dhe egjiptian.
- Nxënësit ndahen në grupe duke u orientuar për orën pasardhëse, që është një orë "Situatë e sugjeruar", "Parailirët dhe ilirët". Nxënësit orientohen të kërkojnë për vendin ku u shfaqën parailirët dhe burimet që vërtetojnë vazhdimësinë iliro-shqiptare.

**Sqarime për zgjidhjen e ushtrimeve të rubrikës:  
Gjurmojmë-Mendojmë-Arsyetojmë-Nxjerrim përfundime**

**Ushtrimi 3.**

- Përdorimin e tullës, bitumit, trarëve në mure dhe elementeve arkitektonike, si: harku, kolona dhe kupola.

**Ushtrimi 4.**

Lindja e shkrimit solli lindjen e burimeve historike shkrimore, me të cilat fillon historia, e ndarë nga parahistoria, që mbështetej vetëm në burime historike materiale apo lëndore (periudha e gurit apo ajo litike).

**Ushtrimi 5.**

Gjetja sot e mumieve të paprishura dëshmon shkallën e lartë të mjekësisë në Egjiptin e vjetër dhe të shkencës në përgjithësi, sepse ruajtja e mumieve lidhet edhe me shkencat e tjera, si: kimi, biologji, anatomi etj.

**Ushtrimi 6.**

Të përdoret diagrami i Venit: dy rrathe, Egjipti, Mesopotamia, në prerjen e përbashkët të shkruhet shkrimi dhe në hapësirat e lira fjalët: kuneiform dhe hieroglifë.

**Ushtrimi 7.**

Arritën nëpërmjet njohurive shkencore, si: matematika, gjeometria, fizika, kimia etj., që tregojnë shkallën e lartë të zhvillimit të shkencës e kulturës te këta popuj.

**Ushtrimi 9.**

Pikturat shprehin florën, faunën, veprimtaritë e njerëzve, si: gjuetia, bujqësia, lundrimi, si dhe kujdesi për natyrën që i rrethonte.

Fusha:	Lënda: Histori	Shkalla: III	Klasa: 6
<b>Tematika 1:</b> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Qytetërimet botërore në antikitet. Luginat lumore, djepi i qytetërimeve të hershme (mijëvjeçari IV- II pr. K.)</li> </ul>	<b>Tema mësimore:</b> <ul style="list-style-type: none"> <li>• <b>Parailirët dhe ilirët (situatë e sugjeruar)</b></li> </ul>	<b>Situata e të nxënit:</b> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Mësuesi/ja zgjedh të dhëna nga burime të ndryshme për të demonstruar të kuptuarin e koncepteve në lidhje me temën nëpërmjet mjeteve pamore, si video-projektor, albume, fotografi etj.</li> </ul>	
<p><b>Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyç:</b></p> <p><b>Kompetenca e komunikimit dhe e të shprehurit</b>  <b>Nxënësi:</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• zhvillon kompetencën e komunikimit për të ndërtuar kompetencat historike për të shqyrtuar, për të analizuar, për të parashtruar pyetje, për të argumentuar, për të diskutuar dhe për të komunikuar informacionin historik, konceptet dhe idetë.</li> </ul> <p><b>Kompetenca e të menduarit</b>  <b>Nxënësi:</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• zhvillon kompetencën e të menduarit për realizimin e kërkimit historik;</li> <li>• zhvillon mendimin kritik për të përzgjedhur burimet, për të interpretuar të shkuarën nëpërmjet informacionit, për të dhënë argumente bazuar në burime dhe për të saktësuar saktësinë e burimeve.</li> </ul> <p><b>Kompetenca e të nxënit</b>  <b>Nxënësi:</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• zbaton në mënyrë të pavarur udhëzimet për një temë, veprim, aktivitet ose detyrë që i kërkohet;</li> <li>• vlerëson pikëpamjet e ndryshme, si dhe menaxhon emocionet, ndjenjat, kohën, shfrytëzimin e burimeve dhe mjeteve gjatë kryerjes së një detyre në histori;</li> <li>• identifikon përparësitë dhe mangësitë e tij në lidhje me zotërimin e dijeve dhe kompetencave historike në funksion të përparimit dhe përmirësimit të suksesit të tyre.</li> </ul> <p><b>Kompetenca për jetën, sipërmarrjen dhe mjedisin</b>  <b>Nxënësi:</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• harton hapat që duhet të ndjekë për realizimin e një kërkimi historik për një ngjarje të dhënë;</li> <li>• zhvillon një kërkim individual ose në grup për kryerjen e një veprimtarie në histori;</li> <li>• diskuton individualisht ose në grup për rëndësinë që ka e shkuara në kuptimin e së tashmes dhe perspektivat e së ardhmes;</li> </ul> <p><b>Kompetenca personale</b>  <b>Nxënësi:</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• kupton nëpërmjet kërkimit historik përvojën e njeriut, marrëdhëniet shkak-pasojë, trashëgiminë kulturore, rëndësinë historike, ndryshimet dhe vazhdimësinë që ka pësuar shoqëria përgjatë kohërave;</li> <li>• përdor aftësitë e komunikimit, punës në grup etj., për të prezantuar dhe argumentuar idetë e tij.</li> </ul> <p><b>Kompetenca qytetare</b>  <b>Nxënësi:</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• përdor aftësitë e komunikimit, punës në grup etj., për të prezantuar dhe argumentuar idetë e tij;</li> <li>• shpjegon origjinën dhe zhvillimin e identitetit kombëtar, duke vlerësuar trashëgiminë material edhe shpirtërore.</li> </ul>			

- shqyrton një sërë burimesh që paraqesin perspektiva të ndryshme kulturore, në mënyrë që të zhvillojë kuptimin historik.

**Kompetenca digjitale**

**Nxënësi**

- zhvillon kompetencën digjitale për të kërkuar, përzgjedhur, analizuar dhe komunikuar informacion historik;
- përdor një sërë burimesh digjitale të informacionit dhe analizon në mënyrë kritike këto burime historike;
- komunikon, prezanton dhe parashtron njohuritë, aftësitë dhe qëndrimet;
- bashkëpunon, diskuton dhe debaton me të tjerët për të ndërtuar konceptet dhe kompetencat historike.

<p><b>Rezultatet e të nxënësve sipas temës:</b></p> <p><b>Nxënësi:</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>● përcakton popullsinë parailire si pararendëse e kulturës së bronzit;</li> <li>● tregon në hartë vendbanimet e kulturës së bronzit;</li> <li>● përshkruan kulturën materiale dhe shpirtërore të popullsisë parailire.</li> </ul>	<p><b>Fjalë kyç:</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>● Parailir</li> <li>● Ilir</li> <li>● Vendbanim</li> <li>● Kulturë materiale</li> <li>● Kulturë shpirtërore</li> </ul>
<p><b>Burimet:</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>● Teksti mësimor, e-libri</li> <li>● Harta</li> <li>● Pamje e foto të ndryshme të vendbanimeve, mjeteve dhe sendeve të ndryshme që i përkasin periudhës së gurit</li> <li>● Enciklopedi</li> <li>● Materiale nga interneti</li> </ul>	<p><b>Lidhja me fushat e tjera dhe me tema ndërkurrikulare:</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>● Gjeografi</li> <li>● Art pamor</li> </ul>

**Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve:**

**PNP:** Bashkëbisedim, lexim i orientuar, punë me hartën, punë në grupe

Pasi janë njohur më parë me temën, nxënësit orientohet nga mësuesi/ja për të lexuar pjesën "Lexim i orientuar".

Si fillim bëjnë një parashikim për pjesën që do të lexojnë për parailirët dhe ilirët. Nxënësit evidentojnë:

- *Ilirët kanë jetuar mijëra vjet më parë.*
- *Arkeologët kanë zbuluar vendbanime të ndryshme ilire, si në Xarë, Gajtan, Maliq, Prespë etj.*
- *Arkeologët kanë gjetur armë dhe vegla të ndryshme pune të ilirëve.*
- *Ilirët janë paraardhësit tanë.*

Nxënësit janë orientuar më parë për angazhimin e tyre në kërkim të së kaluarës të popullit tonë, të paraardhësve tanë, duke evidentuar vendin ku janë shfaqur parailirët, vendbanimet e tyre, kur u formua popullsia ilire, cilat ishin disa nga mënyra e jetesës së banorëve parailirë dhe ilirë.

Klasa është ndarë paraprakisht në disa grupe:

**1. Grupi i parë** mbledh pamje, vizatime, skica etj., të vendbanimeve parailire dhe ilire.

**2. Grupi i dytë** evidenton me forma të ndryshme, si vizatime, pamje, piktura, etj., të veprimtarive kryesore të parailirëve dhe ilirëve.

**3. Grupi i tretë** grumbullon materiale të ndryshme, si: pamje, objekte etj., që dokumentojnë besimin, kulturën dhe botën shpirtërore të parailirëve dhe ilirëve. Për këtë ata grumbullojnë informacione të ndryshme që lidhen me pamje nga vizatime shkëmbore që janë gjetur në shpella në zona të ndryshme të vendit.

Në etapën e dytë të veprimtarisë nxënësit bashkëpunojnë dhe përgatisin një ekspozitë të vogël, me fletëpalosje, albume, punime në Power Point etj.

Në etapën e fundit, një përfaqësues i secilit grup prezanton punimin e grupit të tij/saj dhe në fund të orës diskutohet për punimet që paraqitën grupet dhe jepen edhe vlerësimet.

Nxënësit bëjnë vlerësimet e tyre për punën e secilit grup.

**Vlerësimi:**

Vlerësimi bëhet duke pasur parasysh pjesëmarrjen e nxënësve në orën e mësimit në të gjitha etapat e saj e duke i vënë në dukje rezultatet.

**Detyrë:**

- Nxënësit ndahen në dy grupe dhe duke u orientuar për orën pasardhëse, që është një orë projekt me temë “Lindja dhe lulëzimi i qytetërimeve në Indi dhe në Kinën e lashtë”, orientohen të kërkojnë informacione dhe të dhëna njëri grup për Kinën e lashtë dhe tjetri për Indinë.



Fusha:	Lënda: Histori	Shkalla: III	Klasa: 6
<b>Tematika 1:</b> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Qytetërimet botërore në antikitet. Luginat lumore, djepi i qytetërimeve të hershme (mijëvjeçari IV- II pr. Krishtit)</li> </ul>	<b>Tema mësimore:</b> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Lindja dhe lulëzimi i qytetërimeve në Indi dhe në Kinën e lashtë (situatë e sugjeruar)</li> </ul>	<b>Situata e të nxënit:</b> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Mësuesi/ja zgjedh të dhëna nga burime të ndryshme për të demonstruar të kuptuarin e koncepteve në lidhje me temën nëpërmjet mjeteve pamore, si video-projektor, albume, fotografi etj.</li> </ul>	

### Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyç:

#### **Kompetenca e komunikimit dhe e të shprehurit**

##### **Nxënësi:**

- zhvillon kompetencën e komunikimit për të ndërtuar kompetencat historike për të shqyrtuar, për të analizuar, për të parashtruar pyetje, për të argumentuar, për të diskutuar dhe për të komunikuar informacionin historik, konceptet dhe idetë

#### **Kompetenca e të menduarit**

##### **Nxënësi:**

- zhvillon kompetencën e të menduarit për realizimin e kërkimit historik;
- zhvillon mendimin kritik për të përzgjedhur burimet, për të interpretuar të shkuarën nëpërmjet informacionit, për të dhënë argumente bazuar në burime dhe për të vërtetuar saktësinë e burimeve.

#### **Kompetenca e të nxënit**

##### **Nxënësi:**

- zbaton në mënyrë të pavarur udhëzimet për kryer veprimtarinë që i kërkohet;
- ndërlidh temën e re ose një çështje të dhënë me njohuritë dhe përvojat paraprake, duke i paraqitur në forma të ndryshme të të shprehurit sipas një radhitjeje logjike;
- identifikon përparësitë dhe mangësitë e tij në lidhje me zotërimin e dijeve dhe kompetencave historike në funksion të përparimit dhe përmirësimit të suksesit të tyre.

#### **Kompetenca për jetën, sipërmarrjen dhe mjedisin**

##### **Nxënësi:**

- harton hapat që duhet të ndjekë për realizimin e një kërkimi historik për një ngjarje të dhënë;
- zhvillon një kërkim individual ose në grup për kryerjen e një veprimtarie në histori;
- diskuton individualisht ose në grup për rëndësinë që ka e shkuara në kuptimin e së tashmes dhe perspektivat e së ardhmes.

#### **Kompetenca personale**

##### **Nxënësi:**

- zhvillon kompetencën personale për të kuptuar veten dhe të tjerët, ndryshimet dhe ngjashmëritë, për të menaxhuar marrëdhëniet ndërmjet njëri-tjetrit, për të vlerësuar pikëpamjet e të tjerëve, qofshin këto dhe të ndryshme nga të tija;
- kupton nëpërmjet kërkimit historik përvojën e njeriut, marrëdhëniet shkak-pasojë, trashëgiminë kulturore, rëndësinë historike, ndryshimet dhe vazhdimësinë që ka pësuar shoqëria përgjatë kohërave;
- përdor aftësitë e komunikimit, punës në grup etj., për të prezantuar dhe argumentuar idetë e tij.

### **Kompetenca qytetare**

#### **Nxënësi:**

- përdor aftësitë e komunikimit, punës në grup etj., për të prezantuar dhe argumentuar idetë e tij;
- shqyrton një sërë burimesh që paraqesin perspektiva të ndryshme kulturore, në mënyrë që të zhvillojë kuptimin historik.

### **Kompetenca digjitale**

#### **Nxënësi**

- zhvillon kompetencën digjitale për të kërkuar, përzgjedhur, analizuar dhe komunikuar informacion historik;
- përdor një sërë burimesh digjitale të informacionit dhe analizon në mënyrë kritike këto burime historike;
- komunikon, prezanton dhe parashtron njohuritë, aftësitë dhe qëndrimet;
- bashkëpunon, diskuton dhe debaton me të tjerët për të ndërtuar konceptet dhe kompetencat historike.

<p><b>Rezultatet e të nxënit të kompetencave sipas temës:</b></p> <p><b>Nxënësi:</b></p> <ul style="list-style-type: none"><li>● tregon në hartë shtrirjen e qytetërimit indian dhe kinez;</li><li>● përshkruan veçoritë e qytetërimit indian;</li><li>● përcakton veçoritë e qytetërimit kinez;</li><li>● vlerëson kontributin e qytetërimeve të lindjes në zhvillimin e qytetërimit botëror.</li></ul>	<p><b>Fjalë kyç:</b></p> <ul style="list-style-type: none"><li>● Qytetërim kinez</li><li>● Qytetërim indian</li><li>● Lindje e Largët</li><li>● Azi</li></ul>
<p><b>Burimet:</b></p> <ul style="list-style-type: none"><li>● Teksti mësimor, e-libri</li><li>● Harta</li><li>● Pamje e foto të ndryshme të vendbanimeve, mjeteve dhe sendeve të ndryshme që i përkasin periudhës së bronzit</li><li>● Enciklopedi</li><li>● Materiale nga interneti</li></ul>	<p><b>Lidhja me fushat e tjera dhe me tema ndërkurrikulare:</b></p> <ul style="list-style-type: none"><li>● Gjeografi</li><li>● Art pamor</li></ul>

### **Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve:**

**PNP:** Bashkëbisedim, lexim i orientuar, punë me hartën, punë në grupe

Në etapën e parë të orës mësimore mësuesi/ja shfaq me video-projektor një material të përgatitur më parë, me karakteristikat e qytetërimit indian dhe kinez, për të theksuar më shumë dhe për të qartësuar renditjen dhe prezantimin e materialeve të përgatitura nga nxënësit. Nxënësit orientohet nga mësuesi/ja për të lexuar tekstin.

Mësuesi/ja e ka ndarë paraprakisht klasën në tri grupe:

#### **Grupi 1:**

##### **Qytetërimi indian:**

- Fillimet e qytetërimit indian
- Organizimi shoqëror
- Kultura dhe besimi

#### **Grupi 2:**

##### **Qytetërimi kinez**

- Fillimet e qytetërimit indian
- Organizimi shoqëror
- Kultura dhe besimi

#### **Grupi 3:**

##### **Veçoritë e dy qytetërimeve**

- Të përbashkëtat e këtyre dy qytetërimeve
- Dallimet mes qytetërimit kinez dhe atij indian

Në etapën e dytë nxënësit bashkëpunojnë dhe përgatisin një ekspozitë të vogël, me fletëpalosje, albume, punime në Power Point për të dy qytetërimet, përfshirë edhe të veçantat dhe të përbashkëtat e tyre.



Aspekte të jetës së qytetërimit të lashtë indian



Aspekte të jetës së qytetërimit të lashtë kinez

Në etapën e fundit, një përfaqësues i secilit grup prezanton punimin e grupit të tij/saj dhe në fund të orës diskutohet për punimet që paraqitën grupet dhe jepen edhe vlerësimet.

Nxënësit bëjnë vlerësimet e tyre për punën e secilit grup.

**Vlerësimi:**

Vlerësimi bëhet duke pasur parasysh pjesëmarrjen e nxënësve në orën e mësimit në të gjitha etapat e saj e duke i vënë në dukje rezultatet.

**Detyrë:**

Përgatitni një album me pamje të vendbanimeve, mjeteve të punës, armëve, veshjeve etj., të qytetërimit indian dhe atij kinez.

Fusha:	Lënda: Histori	Shkalla: III	Klasa: 6
<b>Tematika 1:</b> Qytetërimet botërore në antikitet. Luginat lumore, djepi i qytetërimeve të hershme (mijëvjeçari IV - II pr. K.	<b>Tema mësimore:</b> <ul style="list-style-type: none"> <li>• <b>Përsëritje</b></li> </ul>	<b>Situata e të nxënit:</b> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Nxënësit dhe mësuesi/ ja diskutojnë dhe risjellin në vëmendje çështjet dhe konceptet kryesore të kësaj tematike</li> </ul>	

### **Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyç:**

#### ***Kompetenca e komunikimit dhe e të shprehurit***

##### **Nxënësi:**

- zhvillon kompetencën e komunikimit për të ndërtuar kompetencat historike për të shqyrtuar, për të analizuar, për të parashtruar pyetje, për të argumentuar, për të diskutuar dhe për të komunikuar informacionin historik, konceptet dhe idetë;
- përdor funksionet gjuhësore të teksteve historike, duke përfshirë fjalorin historik, fjali të ndërtuara saktë për përshkrimin e ngjarjeve, për shpjegimin e marrëdhënieve shkak-pasojë, përdorimin e gjerë të emrave, ndajfoljeve dhe mbiemrave për të përshkruar vendet, njerëzit dhe ngjarjet.

#### ***Kompetenca e të menduarit***

##### **Nxënësi:**

- zhvillon mendimin krijues për të ndërtuar interpretime të reja, të cilat shpjegojnë aspekte të së shkuarës, që janë të diskutueshme.

#### ***Kompetenca e të nxënit***

##### **Nxënësi:**

- zhvillon kompetencën e të nxënit për të shfrytëzuar të dhënat për të demonstruar të kuptuarit e koncepteve historike dhe shoqërore, duke i prezantuar nëpërmjet formave të ndryshme të të shprehurit;
- vlerëson pikëpamjet e ndryshme, si dhe menaxhon emocionet, ndjenjat, kohën, shfrytëzimin e burimeve dhe mjeteve gjatë kryerjes së një detyre në histori;
- parashtron pyetje kërkimore dhe përgjigjet duke u bazuar në argumente dhe burime;
- identifikon përparësitë dhe mangësitë e tij në lidhje me zotërimin e dijeve dhe kompetencave historike në funksion të përparimit dhe përmirësimit të suksesit të tyre.

#### ***Kompetenca për jetën, sipërmarrjen dhe mjedisin***

##### **Nxënësi:**

- diskuton individualisht ose në grup për rëndësinë që ka e shkuara në kuptimin e së tashmes dhe perspektivat e së ardhmes;
- bashkëvepron në mënyrë aktive me moshatarët dhe të tjerët (pavarësisht statusit të tyre social, etnik etj.) për realizimin e një veprimtarie të përbashkët.

#### ***Kompetenca personale***

##### **Nxënësi:**

- zhvillon kompetencën personale për të kuptuar veten dhe të tjerët, ndryshimet dhe ngjashmëritë, për të menaxhuar marrëdhëniet ndërmjet njëri-tjetrit, vlerësuar pikëpamjet e të tjerëve, qofshin këto dhe të ndryshme nga të tija;
- kupton nëpërmjet kërkimit historik përvojën e njeriut, marrëdhëniet shkak-pasojë, trashëgiminë kulturore, rëndësinë historike, ndryshimet dhe vazhdimësinë që ka pësuar shoqëria përgjatë kohërave;
- përdor aftësitë e komunikimit, punës në grup etj., për të prezantuar dhe argumentuar idetë e tij.

**Kompetenca qytetare**

**Nxënësi:**

- zhvillon kompetencën qytetare për të shqyrtuar në mënyrë kritike sjelljet, motivet dhe veprimet e njerëzve në të shkuarën, që mund të jenë rezultat i ndryshimit të qëndrimeve shoqërore dhe standardeve të ndryshme;
- shqyrton burimet historike për të kuptuar ngjarjet dhe zhvillimet që kanë ndikuar në shoqëri dhe grupe të ndryshme kulturore në kohëra të ndryshme, si dhe shpjegon natyrën, shkaqet dhe pasojat e konflikteve dhe ndërvarësinë kulturore;
- kupton se si qytetërimet dhe shoqëritë janë formuar nga grupe njerëzish me kultura të ndryshme, identifikon dallimet dhe ngjashmëritë ndërmjet kulturave të ndryshme dhe kultivon respekt ndaj kulturave të ndryshme nga e tij;
- përdor aftësitë e komunikimit, punës në grup etj., për të prezantuar dhe argumentuar idetë e tij.
- kupton nëpërmjet kërkimit historik përvojën e njeriut, marrëdhëniet shkak-pasojë, trashëgiminë kulturore, rëndësinë historike, ndryshimet dhe vazhdimësinë që ka pësuar shoqëria përgjatë kohërave;
- shqyrton një sërë burimesh që paraqesin perspektiva të ndryshme kulturore, në mënyrë që të zhvillojë kuptimin historik.

**Kompetenca digjitale**

**Nxënësi**

- zhvillon kompetencën digjitale për të kërkuar, përzgjedhur, analizuar dhe komunikuar informacion historik;
- përdor një sërë burimesh digjitale të informacionit dhe analizon në mënyrë kritike këto burime historike;
- komunikon, prezanton dhe parashtron njohuritë, aftësitë dhe qëndrimet;
- bashkëpunon, diskuton dhe debaton me të tjerët për të ndërtuar konceptet dhe kompetencat historike.

<p><b>Rezultatet e të nxënit të kompetencave sipas temës:</b></p> <p><b>Nxënësi:</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• vlerëson trashëgiminë e qytetërimeve mesjetare;</li> <li>• vlerëson rëndësinë e ngjarjeve, të njerëzve dhe të zhvillimeve në kontekstin e tyre historik dhe në ditët e sotme.</li> </ul>	<p><b>Fjalë kyç:</b></p> <p>Qytetërim antik Luginë lumore</p>
<p><b>Burimet:</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Teksti mësimor</li> <li>• e - libri</li> <li>• Harta e qytetërimeve të hershme</li> </ul>	<p><b>Lidhja me fushat e tjera dhe me tema ndërkurrikulare:</b></p> <p>Art pamor Gjeografi</p>

**Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve:**

**PNP: Konkurs**

Nxënësit janë njoftuar më parë për zhvillimin e një konkursi mes tyre. Mësuesi/ja e ndan klasën në dy grupe dhe secili grup zgjedh emrin dhe logon apo simbolin e tij përkatës, si dhe një përfaqësues. Më pas mësuesi/ja rendit rregullat dhe kriteret e vlerësimit në dërrasë të zezë dhe i njuh nxënësit me to. Disa nga rregullat janë:

- një nxënës flet dhe të tjerët dëgjojnë;
- nuk lejohet kopjimi;
- nuk lejohet diskutimi me zë të lartë.

Mësuesi/ja mund të shtojë rregulla të tjera sipas rastiit. Vlerësimi bëhet mbi këto 2 kritere:

- pyetja e saktë:
- shpejtësia e përgjigjes:

Pastaj mësuesi/ja fillon me pyetjet.

**Pyetja 1:** Pyetja e parë është e përbashkët. (6 pikë)

- *Ktheni vitet e dhëna në shekuj dhe mijëvjeçarë:*
  - Viti 3200 para Krishtit
  - Viti 1901 para Krishtit
  - Viti 732
  - Viti 1620
  - Viti 1840
  - Viti 2015

**Pyetja 2:** (3 pikë)

Grupi A

- *Krahasoni luginën e Nilit dhe Mesopotamisë për nga regjimi uJOR.*

Grupi B

- *Krahasoni luginën e Nilit dhe Mesopotamisë për nga pozicioni gjeografik.*

**Pyetja 3:** Pyetje me shkrim. (2 pikë)

Grupi A

- *Shek. II para K., fillon \_\_\_\_\_ mbaron \_\_\_\_\_.*
- *Shek. IV para K., fillon \_\_\_\_\_ mbaron \_\_\_\_\_.*
- *Shek. VI pas K., fillon \_\_\_\_\_ mbaron \_\_\_\_\_.*
- *Shek. XI fillon \_\_\_\_\_ mbaron \_\_\_\_\_.*

Grupi B

- *Shek. I para K., fillon \_\_\_\_\_ mbaron \_\_\_\_\_.*
- *Shek. V para K., fillon \_\_\_\_\_ mbaron \_\_\_\_\_.*
- *Shek. VI pas K., fillon \_\_\_\_\_ mbaron \_\_\_\_\_.*
- *Shek. XIX fillon \_\_\_\_\_ mbaron \_\_\_\_\_.*

**Pyetja 4:** (1 pikë)

Grupi A:

- *Cilat ishin shtresat në shoqërinë mesopotame?*

Grupi B:

- *Kur filloi periudha dinastike në Mesopotami?*

**Pyetja 5:** (3 pikë)

Grupi A:

- *Ç'veçori kishin të privilegjuarit në shoqërinë egjiptiane?*

Grupi B:

- *Ç'veçori kishin të paprivilegjuarit në shoqërinë egjiptiane?*

**Pyetja 6:** (1 pikë, përgjigjja duhet të jetë "Po" ose "Jo")

Grupi A:

- *Në Egjipt në mijëvjeçarin e katërt kishte 42 shtete të vogla.*

Grupi B:

- *Shtresat në Egjipt ishin të hapura.*

**Pyetja 7:** Gjeni në fjalor fjalët e dhëna dhe shpjegojini.

(4 pikë)

Grupi A:

- *Mesopotam*
- *Dinasti*
- *Punë angari*
- *Politeist*

Grupi B:

- *Kronologji*
- *Qytet-shtet*
- *Nëpunës*
- *Oaze*

**Pyetja 8:** (Këtu grupet zgjedhin një përfaqësues, që të jetë i saktë dhe i shpejtë, pasi do të përballet me përfaqësuesin e grupit kundërshtar në pyetjet e shpejta). (1 pikë, pyetje rrufe.)

- *Gjysmëhëna pjellore ose \_\_\_\_\_*
- *U quajtën streha e parë e qytetërimin botëror: \_\_\_\_\_*
- *Ku gjendet sot i ruajtur Kodi i Hamurabit? \_\_\_\_\_*
- *Në vitin 525 para Krishtit ndodhi \_\_\_\_\_*
- *\_\_\_\_\_ krijoi shtetin e parë të bashkuar në Egjipt.*

**Pyetja 9:** Pyetja është e përbashkët për të dyja grupet. (3 pikë saktësia dhe 1 pikë shpejtësia e përgjigjes.)

- *3 shpikjet më të mëdha të egjiptianëve janë:*
  - a. \_\_\_\_\_
  - b. \_\_\_\_\_
  - c. \_\_\_\_\_
- *3 shpikjet më të mëdha të mesopotamëve janë:*
  - a. \_\_\_\_\_
  - b. \_\_\_\_\_
  - c. \_\_\_\_\_

**Pyetja 10:** (pyetje e përbashkët, me shkrim) Këtu zgjidhet një nxënës që është krijuar, nga secili grup për të kryer këtë detyrë, pasi konsultohet me pjesëtarët e grupit. (3 pikë saktësia, 1 pikë ai grup që e mbaron i pari).

- *Analizoni shprehjen "Sy për sy dhe dhëmbë për dhëmbë".*

Vlerësohet me pikët maksimale punimi që ka analizuar më bukur dhe më saktë shprehjen e dhënë.

#### Vlerësimi:

Në fund të konkursit mblidhen pikët dhe shpallet skuadra fituese. Mësuesi/ja analizon ecurinë e konkursit dhe bën vlerësimet duke pasur parasysh:

- informacionin më të plotë e më të saktë;
- shpejtësinë e përgjigjeve;
- bashkëpunimin më të mirë mes pjesëtarëve të grupit;
- pjesëmarrjen dhe aktivizimin e nxënësve në konkurs;
- punën individuale.

#### Detyrë:

Në varësi të periudhës kur do të zhvillohet ora e përsëritjes, mësuesi/ja mund të caktojë detyra për të mbledhur informacione për mësimin pasardhës.

## Tematika 2. Qytetërimet në brigjet e deteve të Mesdheut (shek. VII pr. K. - shek. V ps. K.)

**Përshkrimi i tematikës:** Përmes kësaj tematike, nxënësit demonstrojnë njohuritë, aftësitë/shkathhtësitë, qëndrimet dhe vlerat mbi lindjen dhe përhapjen e qytetërimeve në brigjet e deteve të Mesdheut. Kjo tematikë trajton veçoritë e qytetërimeve që shtrihen në brigjet e Mesdheut, si ai fenikas, hebre, minoik; qytetërimin grek dhe romak, organizimin shoqëror, jetën politike, zhvillimin e kulturës dhe shkencën, besimin në këto qytetërimet etj. Nëpërmjet kësaj tematike, nxënësit mësojnë për përfundimin e qytetërimeve antike në Europë dhe fillimin e qytetërimeve mesjetare (shekujt I -V ps. K.), si dhe për popujt që migruan në territorin e Perandorisë Romake. Kjo tematikë sugjerohet të zhvillohet në 8 orë mësimore. Për këtë tematikë janë parashikuar edhe veprimtari/projekte, të cilat jepen në rubrikën “Situata të sugjeruara”. Këto orë veprimtarish/projektësh, mësuesi/ja dhe autorët e tekstit i integrojnë brenda orëve të tematikës. Tematika së bashku me situatat e sugjeruara realizojnë kompetencat lëndore dhe kompetencat kyç për të nxënëit gjatë gjithë jetës.

1

Fusha:	Lënda: Histori	Shkalla: III	Klasa: 6
<b>Tematika 2:</b> <ul style="list-style-type: none"> <li>Qytetërimet në brigjet e deteve të Mesdheut (shekulli VII pr. K. – shekullin V ps. K.)</li> </ul>	<b>Tema mësimore:</b> <ul style="list-style-type: none"> <li><b>Qytetërimet në brigjet e deteve të Mesdheut</b></li> </ul>	<b>Situata e të nxënëit:</b> <ul style="list-style-type: none"> <li>Mësuesi/ja u kërkon nxënësve të sjellin në mendje karakteristikat e qytetërimit mesopotam dhe egjiptian për të bërë lidhjen me qytetërimet e popujve të detit nëpërmjet teknikës “Stuhi mendimesh”.</li> </ul>	

### Rezultatet e të nxënëit sipas kompetencave kyç:

#### **Kompetenca e të nxënëit**

##### **Nxënësi:**

- zhvillon kompetencën e të nxënëit, për të shfrytëzuar të dhënat, për të demonstruar të kuptuarit e koncepteve historike dhe shoqërore, duke i prezantuar nëpërmjet formave të ndryshme të të shprehurit;
- ndërlidh temën e re ose një çështje të dhënë me njohuritë dhe përvojat paraprake, duke i paraqitur në forma të ndryshme të të shprehurit sipas një radhitjeje logjike;
- parashtron pyetje kërkimore dhe përgjigjet duke u bazuar në argumente dhe burime.

#### **Kompetenca e komunikimit dhe e të shprehurit**

##### **Nxënësi:**

- zhvillon kompetencën e komunikimit për të ndërtuar kompetencat historike, për të shqyrtuar, analizuar, për të parashtruar pyetje, për të argumentuar, për të diskutuar dhe për të komunikuar informacionin historik, konceptet dhe idetë.



**Kompetenca për jetën dhe mjedisin**

**Nxënësi:**

- zhvillon kompetencën për jetën dhe mjedisin për të identifikuar dhe vlerësuar burimet e nevojshme për interpretimin e ngjarjes historike.

**Kompetenca e të menduarit**

**Nxënësi:**

- zhvillon mendimin krijues për të ndërtuar interpretime të reja, të cilat shpjegojnë aspekte të së shkuarës, që janë të diskutueshme;
- zhvillon aftësinë për të përzgjedhur burimet, për të interpretuar të shkuarën nëpërmjet informacionit, për të dhënë argumente bazuar në burime dhe për të saktësuar saktësinë e burimeve.

**Kompetenca qytetare**

**Nxënësi:**

- kupton se si qytetërimet dhe shoqëritë janë formuar nga grupe njerëzish me kultura të ndryshme;
- identifikon dallimet dhe ngjashmëritë ndërmjet kulturave të ndryshme dhe kultivon respekt ndaj kulturave të ndryshme nga e tij;
- zhvillon mirëkuptimin ndërkulturor, duke vlerësuar kulturat, gjuhët dhe besimet e ndryshme;
- kupton perspektivat, besimet dhe qëndrimet e njerëzve në të shkuarën e në të tashmen dhe rëndësinë e njohjes së historisë së tyre dhe të tjerëve;
- shqyrton një sërë burimesh, që paraqesin perspektiva të ndryshme kulturore, në mënyrë që të zhvillojë kuptimin historik.



<p><b>Rezultatet e të nxënit të kompetencave sipas temës.</b></p> <p><b>Nxënësi:</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• tregon në hartë vendosjen dhe shtrirjen e popujve në brigjet e deteve të Mesdheut;</li> <li>• identifikon faktorët e zhvillimit të qytetërimeve në brigjet e deteve të Mesdheut.</li> </ul>	<p><b>Fjalë kyç:</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Fenikas</li> <li>• Hebre</li> <li>• Nomad</li> <li>• Minoik</li> <li>• Koloni</li> <li>• Monoteist</li> </ul>
<p><b>Burimet:</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Teksti mësimor</li> <li>• e-libri</li> <li>• Hartë e Mesdheut</li> <li>• Enciklopedi</li> <li>• Materiale nga interneti</li> </ul>	<p><b>Lidhja me fushat e tjera dhe me tema ndërkurrikulare:</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Gjeografi</li> <li>• Art pamor</li> </ul>

## Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve:

**PNP:** Stuhi mendimesh - Skema e mendjes - Kontrolli i njohurive

**Parashikimi:** Stuhi mendimesh

Mësuesi/ja shkruan në tabelë grupin emëror “Popujt e deteve” dhe i pyet nxënësit se çfarë u sjell në mendje ky grup emëror. Më pas ai/ajo i pyet se cilat shtete lagen nga Deti Mesdhe dhe nëndete të tij (Deti Jon, Adriatik, Egje etj.) Duke u bazuar në këtë grup emëror, nxënësit përpiqen të thonë disa nga popujt që lagen nga Deti Mesdhe. Mësuesi/ja shkruan në tabelë disa nga përgjigjet e tyre, të cilat ndihmojnë në marrjen e njohurive të reja.




**Ndërtimi i njohurive:** Skema e mendjes

Mësuesi/ja u thotë nxënësve se sot do të mësojnë karakteristikat e tri qytetërimeve të rëndësishme, që janë:


1. qytetërimi fenikas
2. qytetërimi hebre
3. qytetërimi minoik

Këto qytetërimet kanë shërbyer si ura lidhëse mes qytetërimeve që u zhvilluan më vonë në Europën Jugore, në Ballkan dhe në Gadishullin Apenin. Pikërisht këto qytetërimet, të vendosura në brigjet e Detit Mesdhe, shërbyen si rrugë komunikimi në shkëmbimin e qytetërimeve antike mes tri kontinenteve: Europë, Azi dhe Afrikë.


Mësuesi/ja shkruan në tabelë grupin emëror “Qytetërimi fenikas” dhe u kërkon nxënësve ta lexojnë këtë pjesë, duke nënvizuar pikat kryesore, të cilat i shkruan në dërrasë të zezë.



Qytetërimi fenikas arriti shkallën më të lartë me zhvillimin e sistemit të shkrimit. Ata shpikën alfabetin. Më pas, mësuesi/ja shkruan në tabelë fjalët "Hebrenjtë" dhe i pyet nxënësit nëse kanë dëgjuar për hebrenjtë dhe çfarë dinë për ta.



Pasi ka dhënë disa nga veçoritë e qytetërimit hebre, mësuesi/ja shkruan në tabelë fjalët "Qytetërimi minoik".



**Përforcimi i njohurive:** Kontrolli i njohurive

Mësuesi/ja punon me rubrikën "Gjurmojmë-Mendojmë..." në tekst. Ai/ajo i orienton nxënësit të plotësojnë tabelën e ushtrimit 4, duke vendosur shenjën + aty ku duhet.

	Fenikasit	Hebrenjtë	Kretasit
Krijuan koloni në brigjet e Mesdheut			
Ishin monoteistë			
Qytet-shtetet ruajtën autonominë			
Kulturë para-greke			
Krijuan alfabet			

**Vlerësimi:**

Vlerësimi bëhet duke pasur parasysh pjesëmarrjen e nxënësve në orën e mësimit në të gjitha etapat e saj e duke vënë në dukje rezultatet.

**Detyrë:** Kërkoni në internet të dhëna për Fenikinë dhe hebrenjtë dhe shkruajini ato në fletore.

**Sqarime për zgjidhjen e ushtrimeve të rubrikës:  
Gjurmojmë-Mendojmë-Arsyetojnë-Nxjerrim përfundime**

**Ushtrimi 5.**

"Agjent tregtie" do të thotë ndërmjetës, që marrin mallin që prodhojnë të tjerët dhe e dërgojnë te porositësit apo e hedhin në tregje, ku ky mall kërkohet, p.sh. pambukun e Indisë e hedhin në tregjet mesdhetare. Këtë gjë bënin edhe fenikasit.

Fusha:	Lënda: Histori	Shkalla: III	Klasa 6
<b>Tematika 2:</b> <ul style="list-style-type: none"> <li>Qytetërimet në brigjet e deteve të Mesdheut (shekulli VII pr. K. - shekullin V ps. K.)</li> </ul>	<b>Tema mësimore:</b> <ul style="list-style-type: none"> <li><b>Qytetërimi grek</b></li> </ul>	<b>Situata e të nxënit:</b> <ul style="list-style-type: none"> <li>Mësuesi/ja u kërkon nxënësve të sjellin në mendje karakteristikat e qytetërimit mesopotam dhe egjiptian, për të bërë lidhjen me qytetërimin grek nëpërmjet teknikës “Marrëdhënie pyetje-përgjigje”.</li> </ul>	

### **Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyç:**

#### ***Kompetenca e të menduarit***

##### **Nxënësi:**

- analizon të dhënat numerike për të kuptuar të shkuarën, vazhdimësinë dhe ndryshimin;
- zhvillon mendimin krijues për të ndërtuar interpretime të reja, të cilat shpjegojnë aspekte të së shkuarës, që janë të diskutueshme;
- zhvillon aftësitë për të përzgjedhur burimet, për të interpretuar të shkuarën nëpërmjet informacioneve, për të dhënë argumente bazuar në burime dhe për të saktësuar saktësinë e burimeve.

#### ***Kompetenca e komunikimit dhe e të shprehurit***

##### **Nxënësi:**

- zhvillon kompetencën e komunikimit për të ndërtuar kompetencat historike, për të shqyrtuar, analizuar, për të parashtruar pyetje, për të argumentuar, për të diskutuar dhe për të komunikuar informacionin historik, konceptet dhe idetë.

#### ***Kompetenca e të nxënit***

##### **Nxënësi:**

- zhvillon kompetencën e të nxënit për të shfrytëzuar të dhënat, për të demonstruar të kuptuarit e koncepteve historike dhe shoqërore, duke i prezantuar nëpërmjet formave të ndryshme të të shprehurit;
- ndërlidh temën e re ose një çështje të dhënë me njohuritë dhe përvojat paraprake, duke i paraqitur në forma të ndryshme të të shprehurit sipas një radhitjeje logjike;
- parashtron pyetje kërkimore dhe përgjigjet duke u bazuar në argumente dhe burime.

#### ***Kompetenca për jetën dhe mjedisin***

##### **Nxënësi:**

- zhvillon kompetencën për jetën dhe mjedisin, për të identifikuar dhe vlerësuar burimet e nevojshme për interpretimin e ngjarjes historike.

#### ***Kompetenca qytetare***

##### **Nxënësi:**

- kupton se si qytetërimet dhe shoqëritë janë formuar nga grupe njerëzish me kultura të ndryshme;
- identifikon dallimet dhe ngjashmëritë ndërmjet kulturave të ndryshme dhe kultivon respekt ndaj kulturave të ndryshme nga e tij;
- zhvillon mirëkuptimin ndërkulturor, duke vlerësuar kulturat, gjuhët dhe besimet e ndryshme;
- kupton perspektivat, besimet dhe qëndrimet e njerëzve në të shkuarën e në të tashmen dhe rëndësinë e njohjes së historisë së tyre dhe të tjerëve;
- shqyrtton një sërë burimesh që paraqesin perspektiva të ndryshme kulturore, në mënyrë që të zhvillojë kuptimin historik.

<p><b>Rezultatet e të nxënit të kompetencave sipas temës.</b></p> <p><b>Nxënësi:</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• tregon tiparet e organizimit shoqëror në qytetërimin grek;</li> <li>• përshkruan evolucionin politik të qytet-shteteve greke të Athinës dhe të Spartës;</li> <li>• vlerëson rolin e demokracisë antike në zhvillimin e qytetërimin grek dhe qytetërimeve të mëvonshme;</li> <li>• përshkruan tiparet e artit, kulturës, besimit, shkencës dhe të arsimit në qytetërimin grek.</li> </ul>	<p><b>Fjalë kyç:</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Polis</li> <li>• Republikë</li> <li>• Demokraci</li> <li>• Arhond (aristokrat)</li> <li>• Oligarki</li> <li>• Tragjedi</li> <li>• Komedi</li> </ul>
<p><b>Burimet:</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Teksti mësues</li> <li>• e-libri</li> <li>• Harta</li> <li>• Pamje e foto të ndryshme të vendbanimeve, mjeteve dhe sendeve të ndryshme që i përkasin periudhës së qytetërimin të hershëm grek</li> <li>• Enciklopedi</li> <li>• Materiale nga interneti</li> </ul>	<p><b>Lidhja me fushat e tjera dhe me tema ndërkurrikulare:</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Gjeografi</li> <li>• Art pamor</li> </ul>

**Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve:**

**PNP:** Marrëdhënie pyetje-përgjigje - Lexim i drejtuar - Kontrolli i njohurive

**Parashikimi:** Marrëdhënie pyetje-përgjigje

Fillimisht u drejtohen disa pyetje nxënësve, për të risjellë në mendje njohuritë që ata kanë marrë në temat e mëparshme për Mesopotaminë dhe Egjiptin. Disa nga pyetjet janë:

- *Si ishte organizuar shoqëria në qytetërimet e lashta?*
- *Si ishte organizimi i shtetit?*
- *Cila ishte pararendëse e qytetërimin grek?*
- *Ku u zhvillua qytetërimi para-grek?*
- *Çfarë janë qytet-shtetet?*
- *A ishte e ndarë në shtresa shoqëria në Greqinë e lashtë?*
- *Kush nga ju e ka vizituar Greqinë?*
- *Po në Akropol dhe muzeun e tij, a keni qenë? Çfarë ju bëri më shumë përshtypje?*

Disa nga përgjigjet e nxënësve, që ndihmojnë në marrjen e njohurive të reja, mësuesi/ja i shkruan në dërrasë të zezë.



Piramida e Gizës në Egjipt



Akropoli në Athinë

### Ndërtimi i njohurive: Lexim i drejtuar

Mësuesi/ja u kërkon nxënësve të lexojnë pjesën e parë, që flet për organizimin shoqëror në qytetërimin grek. Fillimisht, nxënësit duhet të parashikojnë për atë që do të lexojnë. Disa nga përgjigjet e tyre mund të jenë se shoqëria ishte e ndarë në shtresa. Skllevërit ishin shtresa pa të drejta etj.

Mësuesi/ja thekson se qytet-shtetet në Greqi quheshin polise. Dy qytet-shtetet më të famshme në atë kohë ishin Athina dhe Sparta. Pasi të kenë lexuar pjesën e parë, mësuesi/ja shkruan në tabelë:

Shoqëria athinase ishte e ndarë në 4 shtresa	
Aristokracia	Pronarët e tokave
Demosi	Populli (zejtarë e tregtarë që jetonin në qytet, si dhe fshatarët)
Metikët	Të ardhurit që nuk gëzonin të drejta politike
Skllevërit	Nuk kishin fare të drejta

Këtu nxënësit bëjnë përputhjen e parashikimit që bënë me atë që mësuat.


Më pas, mësuesi/ja shkruan në tabelë organizimin e shoqërisë spartane.

Shoqëria spartane ishte e ndarë në 3 shtresa	
Spartanët	Pronarët e tokave
Periekët	Qytetarë të lirë që merreshin me zeytari e tregti
Iliotët	Ishin skllevër që punonin tokat e spartanëve, por që lejoheshin të mbanin një pjesë të prodhimit. Nuk kishin të drejta.

Mësuesi/ja shpjegon këtu, se roli i gruas në Athinë ishte të edukonte fëmijëve dhe kishte të drejta të kufizuara shoqërore, kurse gruaja spartane i jepte rëndësi edukimit fizik, për të përgatitur fëmijë të fortë për ushtrinë spartane.



Grua greke që përkujdeset për fëmijën



Grua spartane që i jep rëndësi edukimit fizik të fëmijës

Nxënësit japin parashikimet e tyre për nëntemën e dytë: *Jeta politike në Greqinë e lashtë*. Ata parashikojnë se të drejtën për qeverisje e kishin shtresat e pasura: aristokratët. Pasi kanë lexuar tekstin, ata mësojnë se qeverisja e Athinës nga monarki kaloi në republikë, që është formë qeverisëse pa mbret, por që ishte në duart e aristokratëve, shtresës së lartë, ndaj edhe u quajt “Republikë aristokrate”.



- Organet drejtuese në Athinë: → 1. Mbledhja popullore  
→ 2. Këshilli i drejtësisë dhe 9 arhondët

Mësuesi/ja thekson se reformat e Solonit dhe të Klisenit e rritën pjesëmarrjen e demosit në qeverisje. Ishte Kliseni, ai që vendosi *republikën demokratike*.

Kurse forma e qeverisjes në Spartë ishte oligarki, me karakter të qartë ushtarak.

- Organet drejtuese në Spartë: → 1. Mbledhja popullore  
→ 2. Këshilli i pleqve  
→ 3. Mbikëqyrësit  
→ 4. Dy mbretërit

Më pas, orientohen nxënësit të lexojnë nëntemën *Besimi dhe kultura në qytetërimin grek*. Më parë ata parashikojnë për atë që do të lexojnë. Disa nga parashikimet e tyre mund të jenë se grekët besonin në shumë zota dhe zhvilluan shumë shkenca të ndryshme, si: skulpturën, pikturën, arkitekturën, letërsinë etj. Pas leximit të nëntemës, nxënësit mësojnë se besimi i grekëve të lashtë ishte politeist, pra besonin në shumë perëndi me fuqi të mbinatyrshme, që jetonin në malin e Olimp dhe që atje përcaktonin fatin e njeriut. Disa nga perënditë ishin Zeusi (zoti i qiellit dhe i tokës), Hera (nëna e shumë perëndive), Athinaja (perëndesha e mençurisë), Dionisi (perëndia e verës) etj. Nxënësit mësojnë se grekët shumë perëndi i huazuan nga qytetërimet më të hershme. Përveçse të perënditë, grekët besonin edhe te heronjtë e tyre dhe, madje, çdo qytet kishte heroin e vet që e mbronte, si Herakli, Tezeu etj.

Arti në Greqi mori një hov të madh. Në Greqi lindi edhe teatri. Aristofani ishte themeluesi i komedisë dhe Eskili i tragjedisë. Edhe arkitektura u zhvillua shumë. Mjekësia, astronomia, fizika, matematika ishin disa nga fushat e shkencës që njohën zhvillime të mëdha në qytetërimin grek. Greqia është vendi që në vitin 776 pr. K. zhvilloi lojërat olimpike, që organizohen edhe sot.

**Përforcimi:** Kontrolli i njohurive

Mësuesi/ja drejton disa pyetje për të verifikuar marrjen e informacionit.

- Cilat ishin organet që drejtonin qeverisjen në Athinë?
- Cilët mermin pjesë dhe kishin të drejtë të zgjidheshin në këto organe drejtuese?
- Cilat janë të përbashkëtat dhe të veçantat e përbërjes së shoqërisë në Athinë dhe Spartë?
- Cilat janë reformat që ndërmorën Soloni dhe Kliseni?

**Vlerësimi:**

Vlerësimi bëhet duke pasur parasysh pjesëmarrjen e nxënësve në orën e mësimit në të gjitha etapat e saj e duke i vënë në dukje rezultatet.

**Detyrë:**

Mësuesi/ja ndan klasën në dy grupe dhe jep si detyrë shtëpie ushtrimin 10 të rubrikës "Vlerësoni".

- Grupi i parë komenton thënien e parë të nënës spartane: "Bir, kthehu me ose mbi mburojë".
- Grupi i dytë komenton thënien spartane: "Armët janë muret tona".

**Sqarime për zgjidhjen e ushtrimeve të rubrikës:  
Gjurmojmë-Mendojmë-Arsyetojmë-Nxjerrim përfundime**

**Ushtrimi 10.**

- a. Shpjegohet kështu: Kthehu me mburojë, pra me fitore dhe mbi mburojë, pra i vdekur nëse humbet.
- b. Nuk na mbrojnë muret, por forca jonë; ne e mbrojmë lirinë e vendin tonë me armët, guximin, trimërinë e aftësitë tona.

Fusha:	Lënda: Histori	Shkalla: III	Klasa: 6
<b>Tematika 2:</b> <ul style="list-style-type: none"> <li>Qytetërimet në brigjet e deteve të Mesdheut (shekulli VII pr. K. - shekullin V ps. K.)</li> </ul>	<b>Tema mësimore:</b> <ul style="list-style-type: none"> <li><b>Qytetërimi romak</b></li> </ul>	<b>Situata e të nxënit:</b> <ul style="list-style-type: none"> <li>Mësuesi/ja bën lidhjen e qytetërimit grek me atë romak nëpërmjet teknikës "Marrëdhënie pyetje-përgjigje" dhe ndikimet që patën ato te njëri-tjetri.</li> </ul>	

### **Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyç:**

#### ***Kompetenca e të nxënit***

##### **Nxënësi:**

- zhvillon kompetencën e të nxënit për të shfrytëzuar të dhënat, për të demonstruar të kuptuarit e koncepteve historike dhe shoqërore, duke i prezantuar nëpërmjet formave të ndryshme të të shprehurit;
- ndërlidh temën e re ose një çështje të dhënë me njohuritë dhe përvojat paraprake, duke i paraqitur në forma të ndryshme të të shprehurit sipas një radhitjeje logjike;
- parashtron pyetje kërkimore dhe përgjigjet duke u bazuar në argumente dhe burime.

#### ***Kompetenca e komunikimit dhe e të shprehurit***

##### **Nxënësi:**

- zhvillon kompetencën e komunikimit, për të ndërtuar kompetencat historike për të shqyrtuar, për të analizuar, për të parashtruar pyetje, për të argumentuar, për të diskutuar dhe për të komunikuar informacionin historik, konceptet dhe idetë.

#### ***Kompetenca e të menduarit***

##### **Nxënësi:**

- analizon të dhënat numerike për të kuptuar të shkuarën, për shembull për të kuptuar shkakun dhe pasojën, vazhdimësinë dhe ndryshimin;
- zhvillon mendimin krijues për të ndërtuar interpretime të reja, të cilat shpjegojnë aspekte të së shkuarës, që janë të diskutueshme;
- zhvillon mendimin kritik për të përzgjedhur burimet, për të interpretuar të shkuarën nëpërmjet informacionit, për të dhënë argumente bazuar në burime dhe për të saktësuar saktësinë e burimeve.

#### ***Kompetenca qytetare***

##### **Nxënësi:**

- kupton se si qytetërimet dhe shoqëritë janë formuar nga grupe njerëzish me kultura të ndryshme;
- identifikon dallimet dhe ngjashmëritë ndërmjet kulturave të ndryshme dhe kultivon respekt ndaj kulturave të ndryshme nga e tij;
- zhvillon mirëkuptimin ndërkulturor, duke vlerësuar kulturat, gjuhët dhe besimet e ndryshme;
- kupton perspektivat, besimet dhe qëndrimet e njerëzve në të shkuarën e në të tashmen dhe rëndësinë e njohjes së historisë së tyre dhe të tjerëve;
- shqyrton një sërë burimesh që paraqesin perspektiva të ndryshme kulturore, në mënyrë që të zhvillojë kuptimin historik.

#### ***Kompetenca për jetën dhe mjedisin***

##### **Nxënësi:**

- zhvillon kompetencën për jetën dhe mjedisin, për të identifikuar dhe vlerësuar burimet e nevojshme për interpretimin e ngjarjes historike.



<p><b>Rezultatet e të nxënit të kompetencave sipas temës.</b></p> <p><b>Nxënësi:</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• përcakton kohën e lindjes së qytetërimit romak;</li> <li>• përshkruan tiparet e organizimit shoqëror të qytetërimit romak;</li> <li>• tregon aspekte të jetës së përditshme të jetës romake;</li> <li>• përshkruan evolucionin politik të Romës;</li> <li>• dallon krijimin e së Drejtës Romake, si një prej legjislacioneve më të rëndësishme të jurisprudencës botërore.</li> </ul>	<p><b>Fjalë kyç:</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Patric</li> <li>• Plebe</li> <li>• Skllav</li> <li>• Gladiator</li> <li>• Tribunë</li> <li>• Senat</li> <li>• Perandor</li> <li>• E Drejta Romake</li> </ul>
<p><b>Burimet:</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Teksti mësimor</li> <li>• e-libri</li> <li>• Harta</li> <li>• Pamje e foto të ndryshme të vendbanimeve, mjeteve dhe sendeve të ndryshme që i përkasin periudhës së qytetërimit romak</li> <li>• Enciklopedi</li> <li>• Materiale nga interneti</li> </ul>	<p><b>Lidhja me fushat e tjera dhe me tema ndërkurrikulare:</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Gjeografi</li> <li>• Art pamor</li> </ul>

**Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve:**

**PNP:** Marrëdhënie pyetje-përgjigje - Lexim i drejtuar - Kontrolli i njohurive

**Parashikimi:** Marrëdhënie pyetje-përgjigje

Duke pasur parasysh njohuritë që kanë për qytetërimet e lashta, mësuesi/ja e drejton këtë fazë të mësimit me metodën "Marrëdhënie pyetje-përgjigje". Ai/ajo u drejton nxënësve disa pyetje, për të risjellë në mendje njohuritë që ata kanë marrë në temat e mëparshme për Mesopotaminë, Egjiptin dhe Greqinë e lashtë. Disa nga pyetjet janë:

- Çfarë dini ju për qytetërimin romak?
- A keni parë ndonjë film ku trajtohet kjo periudhë?
- Kush nga ju e ka vizituar Romën?
- A e keni parë Koloseun? Çfarë ju ka bërë përshtypje?
- A mendoni se në qytetërimin romak, shoqëria ishte e ndarë në shtresa?

Pasi ka shkruar në tabelë disa nga përgjigjet që ndihmojnë në marrjen e njohurive të reja, mësuesi/ja u tregon nxënësve legjendën e themelimit të Romës.



**Ndërtimi i njohurive:** Lexim i drejtuar

Mësuesi/ja u kërkon nxënësve të parashikojnë për atë që do të lexojnë në nëntemën e parë “Jeta shoqërore në qytetërimin romak”. Nxënësit parashikojnë se shoqëria në qytetërimin romak ishte e ndarë në shtresa, ashtu si në qytetërimet e tjera. Pasi kanë lexuar tekstin, nxënësit mësojnë se qytetërimi romak u zhvillua gjatë mijëvjeçarit të parë. Qyteti i Romës u themelua nga fiset latine e sabine në vitin 800, duke bashkuar ngulimet e tyre. Mësuesi/ja ndërton tabelën:

**Popullsia në qytetërimin romak ndahej në 3 shtresa:**

Patricët	Pronarët e tokave dhe të skllëvërve, skllavopronarët
Plebenjtë	Fshatarë, zejtarë e tregtarë
Skllëvërit	Robër luftime. Në gjendje të tmerrshme ishin skllëvërit gladiatorë.

Pakënaqësia e plebenjve ndaj qeverisjes, kushtet ekonomike dhe ndryshimet politike e shoqërore bënë që patricët të pranonin disa nga kërkesat e tyre. Këto kërkesa u shkruan në *12 tabela bronzi*. Plotësimi i kërkesave të tyre bëri që plebenjtë të fitonin të drejtën e përfaqësimit në administratën shtetërore. Ata u quajtën **tribunë të popullit** dhe fituan të drejtën e vetos. Këtu mësuesi/ja bën pyetjen:



- *Çfarë tregon e drejta e plebenjve për t'u përfaqësuar në senat dhe administratë?*

Këtu kalohet në nëntemën e dytë, “Jeta politike në Romën e lashtë”, ku nxënësit japin parashikimet e tyre për jetën politike në Romën e lashtë. Ashtu si në Athinë, qeverisja u kthye nga monarkia në republikë, formë qeverisëse me përfaqësi nga populli.

Pas leximit të orientuar, nxënësit mësojnë se që nga themelimi i saj e deri në shek. VI pr. K., Roma ishte monarkia dhe drejtohej nga mbreti. Pakënaqësia e popullit solli dëbimin e mbretit dhe vendosjen e republikës që drejtohej nga patricët. Në vend të mbretit u zgjodhën dy konsuj dhe një rol të madh kishte asambleja popullore. Republika u forcua shumë ekonomikisht dhe ushtarakisht dhe me anë të pushtimeve, u bë sundimtare e Italisë dhe Mesdheut. Më vonë u zgjerua drejt vendeve të Ballkanit dhe Azisë së Vogël.

Mësuesi/ja ndërton një tabelë në dërrasë të zezë, ku shkruan emrat *Cezari* dhe *Oktaviani*, ku bashkë me nxënësit plotëson karakteristikat e dy perandorëve të Romës së lashtë, çfarë dinë nxënësit rreth këtyre figurave dhe çfarë mësuuan. Disa prej tyre mund të keni parë dhe filma apo të keni lexuar për këta perandorë.

**Cezari**



- Diktator, perandor
- Ka luajtur një rol të rëndësishëm në transformimin e Republikës Romake në Perandorinë Romake.
- Ai konsiderohet si një prej gjenive ushtarakë më të mëdhenj të kohës dhe një prej liderëve më të fortë.
- Shekspiri ka shkruar tragjedinë "Jul Cezari" për këtë figurë historike.
- Pas kthimit triumfal në Romë, ndaj tij u organizua një komplot, ku ai u vra nga miku i tij i ngushtë, Bruti, ndaj dhe sot është shumë e famshme thënia: "Edhe ti, Brut?!"

**Oktaviani**



- Perandor
- Oktaviani mposhti Antonin dhe Kleopatrën e Egjiptit në betejën e Akciumit në vitin 31 p.e.s dhe u bë sunduesi i padiskutueshëm i Romës,
- Në vitin 27 p.e.s., Oktaviani arriti të shpallej perandor me titullin "August".
- Perandoria e Romës, nën sundimin e Oktavianit, qe perandoria më e fuqishme e botës në atë kohë.

Më pas, mësuesi/ja orienton nxënësit të lexojnë nëntemën "Besimi dhe kultura në qytetërimin romak". Ashtu si në qytetërimin grek, nxënësit parashikojnë se romakët ishin politeistë. Po ashtu, u zhvilluan shumë shkencë të ndryshme, si: skulptura, piktura, letërsia etj.

Pas leximit të nëntemës, nxënësit mësojnë se kultura romake është një vazhdimësi e kulturës dhe e artit grek. Madje ata huazuan shumë nga perënditë greke, duke u ndërruar emrat, si Jupiteri, zoti i qiellit (Zeusi grek), Junona, mbrojtëse e çdo shtëpie (Hera greke), Saturni (mbrojtësi i bimëve), Marsi, mbrojtësi i luftës, (Aresi grek). Romakët u shquan si arkitektë të zotë në ndërtimet e tyre, ku përdorën harqet e kolonat.

Ndërtesat romake: teatro, stadione, ujësjellës, qendra tregtare, tempuj, biblioteka

Shkrimtarë: Ovidi, Virgjili

Mendimtarë: Ciceroni, Seneka

Historianë: Taciti, Plutarku

Mbi gjithçka, romakët u shquan për *kodin ligjor*, që sot quhet **E Drejta Romake**, ku përcaktoheshin qartë parimet mbi pronën, parime që janë bazë e legjislacionit të sotëm.

**Përforcimi:** Kontrolli i njohurive

Drejtohen disa pyetje për të verifikuar marrjen e njohurive nga nxënësit:

- *Kur u themelua Roma?*
- *Kur sundoi monarkia në Romë dhe kur u vendos republika?*
- *Kur u shkruan ligjet në 12 tabela?*
- *Cila ishte përbërja dhe organizimi i shoqërisë romake?*
- *Cilat janë disa nga figurat e shquara të artit dhe shkencës në Romë?*
- *Çfarë i dhanë romakët kulturës botërore?*

**Vlerësimi:**

Vlerësimi bëhet duke pasur parasysh pjesëmarrjen e nxënësve në orën e mësimit në të gjitha etapat e saj e duke vënë në dukje rezultatet.

**Detyrë:**

Ndërtoni një tabelë, ku të krahasoni përbërjen shoqërore të Romës, Athinës dhe Spartës. Gjeni se ku ndryshojnë ato.

**Sqarime për zgjidhjen e ushtrimeve të rubrikës:  
Gjurmojmë-Mendojmë-Arsyetojnë-Nxjerrim përfundime**

**Ushtrimi 5.**

- a. Shteti pësoi një evolucion (zhvillim) drejt demokracisë. Pati një pjesëmarrje më të gjerë të popullit në drejtimin e vendit.
- b. Kjo e drejtë fuqizonte zërin e pakicës në drejtimin e shtetit dhe ndalonte përdorimin e autoritetit të shumicës sunduese të shtetit për të marrë vendime në dëm të popullit dhe konkretisht të plebenjve që përbënin shumicën e popullit.

Fusha:	Lënda: Histori	Shkalla: III	Klasa: 6
<b>Tematika 2:</b> <ul style="list-style-type: none"> <li>Qytetërimet në brigjet e deteve të Mesdheut (shekulli VII pr. K. - shekullin V ps. K.)</li> </ul>	<b>Tema mësimore:</b> <ul style="list-style-type: none"> <li><b>Ndërprerja e qytetërimit antik në Europë dhe fillimi i qytetërimeve mesjetare (shek. I -V ps. K.)</b></li> </ul>	<b>Situata e të nxënit:</b> <ul style="list-style-type: none"> <li>Mësuesi/ja ndërlihd njohuritë e mëparshme me ato të reja nëpërmjet teknikës "Stuhi mendimesh".</li> </ul>	

**Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyç:****Kompetenca e të nxënit****Nxënësi:**

- zhvillon kompetencën e të nxënit për të shfrytëzuar të dhënat për të demonstruar të kuptuarit e koncepteve historike dhe shoqërore, duke i prezantuar nëpërmjet formave të ndryshme të të shprehurit;
- përzgjedh të dhëna nga burime të ndryshme, i klasifikon ato burime sipas rëndësisë që kanë për temën;
- parashtron pyetje kërkimore dhe përgjigjet duke u bazuar në argumente dhe burime;
- zbaton në mënyrë të pavarur udhëzimet për një temë, veprim, aktivitet ose detyrë që i kërkohet;
- ndërlihd temën e re ose një çështje të dhënë me njohuritë dhe përvojat paraprake, duke i paraqitur në forma të ndryshme të të shprehurit sipas një radhitjeje logjike.

**Kompetenca e të menduarit****Nxënësi:**

- zhvillon kompetencën e të menduarit për realizimin e kërkimit historik;
- zhvillon mendimin kritik për të përzgjedhur burimet, për të interpretuar të shkuarën nëpërmjet informacionit, për të dhënë argumente bazuar në burime dhe për të vërtetuar saktësinë e burimeve;
- zhvillon mendimin krijues për të ndërtuar interpretime të reja, të cilat shpjegojnë aspekte të së shkuarës, që janë të diskutueshme;
- analizon të dhënat numerike për të kuptuar të shkuarën, për shembull për të kuptuar shkakun dhe pasojën, vazhdimësinë dhe ndryshimin;
- ndërton dhe interpreton grafikë, diagrame, tabela statistikore për paraqitjen e të dhënave historike; përdor numrat negativë dhe pozitivë për llogaritjen e kohës.

**Kompetenca për jetën, sipërmarrjen dhe mjedisin****Nxënësi:**

- zhvillon kompetencën për jetën, sipërmarrjen dhe mjedisin, për të identifikuar dhe vlerësuar burimet e nevojshme për interpretimin e ngjarjes historike;
- diskuton individualisht ose në grup për rëndësinë që ka e shkuara në kuptimin e të tashmes dhe perspektivat e të ardhmes.

<b>Rezultatet e të nxënit të kompetencave sipas temës.</b>	<b>Fjalë kyç:</b> <ul style="list-style-type: none"> <li>Krishterim</li> <li>Dyndje</li> <li>Skllav</li> <li>Senator</li> <li>Perandor</li> <li>Senat</li> <li>Jurisprudencë</li> <li>E drejta e votës</li> </ul>
<b>Nxënësi:</b> <ul style="list-style-type: none"> <li>përshkruan kushtet e lindjes së krishterimit, duke evidentuar rrethanat historike të kalimit nga besimi pagan në atë të krishterë;</li> <li>liston faktorët historikë që ndikuan në përhapjen e krishterimit;</li> <li>përshkruan faktorët historikë që shkaktuan lëvizjen e popujve;</li> <li>tregon në hartë "dyndjen e popujve" në Europë;</li> <li>tregon pasojat që sollën migrimet e popujve në Europë;</li> <li>dallon rolin e migrimeve të popujve si faktor kyç në lindjen e qytetërimit mesjetar;</li> <li>njuh dhe vlerëson disa nga figurat historike që u përkasën qytetërimeve grek e romak, si Minos, Homeri, Solon, Kliteni, Perikliu, Jul Cezari, Oktaviani, Spartaku, Romuli, Atila, Teodoriku, Aleksandri i Madh etj.</li> </ul>	

**Burimet:**

- Teksti mësimor
- e-libri
- Harta
- Pamje e foto të ndryshme të ikonave kishtare, kishave, objekteve dhe vendeve të besimit të krishterë
- Enciklopedi
- Materiale nga interneti

**Lidhja me fushat e tjera dhe me tema ndërkurrikulare:**

- Gjeografi
- Qytetari
- Art pamor

**Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve:**

**PNP:** Diskutim - Ditari dypjesësh - Kontrolli i njohurive

**Parashikimi:** Diskutim

Mësuesi/ja i njeh nxënësit me temën e re dhe hap një diskutim në klasë për besimet dhe tolerancën fetare në Shqipëri, duke iu drejtuar pyetje nxënësve se çfarë kuptojnë me “tolerancë fetare”, kujt besimi fetar i përkasin, ku besonin njerëzit në antikitet, si ushtrohej besimi fetar në antikitet, çfarë dinë për festën e Krishtlindjes, a ka parë ndonjëri prej tyre një objekt fetar të lashtë në vendet e Europës Perëndimore etj.

**Ndërtimi i njohurive:** Ditari dypjesësh

Mësuesi/ja u kërkon nxënësve të lexojnë nëntemën e parë të mësimit, “Ndryshimi i madh. Faktorët historikë”, duke nënvizuar dhe bërë komentin e tyre për të.

<b>Çështja</b>	<b>Komenti</b>
Ndryshimi i madh	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Shekujt I-V sollën ndërprerjen e qytetërimeve antike dhe lindjen e qytetërimit mesjetar.</li> <li>• U formuan popuj të rinj dhe qytete të reja.</li> </ul>
Faktorët që sollën ndryshimet	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Lindja e krishterimit dhe përhapja e tij.</li> <li>• Dyndjet e popujve ndryshuan Europën.</li> <li>• Rënia e Perandorisë Romake të Perëndimit.</li> <li>• Lindja e një mendësie të re, mënyre jetese, kulture, art.</li> </ul>

Më pas, mësuesi/ja kalon në nëntemën e dytë, “Lindja dhe përhapja e krishterimit”.



<b>Çështja</b>	<b>Komenti</b>
Kushtet historike	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Kriza e përgjithshme kishte përfshirë Perandorinë Romake.</li> <li>• Humbja e shpresës për të ardhmen.</li> <li>• Lodhja dhe dëshpërimi nga luftërat e vazhdueshme.</li> <li>• Sundimi i keq i perandorëve dhe i guvernatorëve në provinca.</li> </ul>
Lindja e krishterimit	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Jezusi (<i>shpëtimtar</i>, në gjuhën hebraike) filloi t'u fliste njerëzve për Zotin dhe jetën e përtejme.</li> <li>• Jezusi u kryqëzua në Jerusalem.</li> <li>• Pasuesit e Krishtit, apostujt dhe besimtarët, që përhapnin mësimet e Krishtit ("lajmin e mirë"), u përdoqën, u burgosën, vranë nga perandorët e Romës.</li> </ul>
Përhapja e krishterimit	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Perandori Konstandini i Madh njohu zyrtarisht lirinë e besimit të krishterë në vitin 313 ps. K.</li> <li>• U ndërpre përndjekja e të krishterëve.</li> <li>• Perandori Teodos e shpalli krishterimin fe zyrtare në vitin 380 ps. K.</li> </ul>

Nxënësit plotësojnë në fletoren e tyre atë që mësuesi/ja shkruan në tabelë.

Në nëntemën e tretë, "Dyndjet e popujve", mësuesi/ja evidenton dy çështje: 1. Shkaqet; 2. Pasojat.

<b>Çështja</b>	<b>Komenti</b>
Shkaqet	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Perandoria u shtri në një territor tepër të madh dhe qe mjaft e vështirë për t'u qeverisur.</li> <li>• Prandoria u sulmua nga grupe popujsh të Lindjes dhe Verilindjes (fiset gjermane, hunët e vandalët).</li> <li>• Këta popuj patën kërkesa për jetë më të mirë, toka pjellore e pasuri.</li> </ul>
Pasojat	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Lindën popuj të rinj, si shkak i përzierjes së vendasve me popullsinë e ardhur.</li> <li>• U shemb Perandoria Romake e Perëndimit.</li> <li>• U krijuan shtetet e reja në territoret e kësaj perandorie.</li> <li>• U ndërpre qytetërimi i vjetër dhe u krijuan kushtet për lindjen e një qytetërimi të ri: qytetërimin mesjetar.</li> </ul>

Këtu mësuesi/ja evidenton se luftërat për pushtet dhe administrimi tepër i dobët i territoreve të pushtuara e dobësuan shumë perandorinë dhe rënduan krizën e saj. Kjo solli si rezultat edhe ndarjen e perandorisë në Perandori të Lindjes dhe Perandori të Perëndimit, që u finalizua në vitin 395. Perandoria e Perëndimit ra pas pushtimit nga Odoakri në vitin 476 ps. K. Kjo solli fundin e kësaj perandorie, ndërsa Perandoria e Lindjes vazhdoi të jetonte më vonë edhe për një mijë vite të tjera.

**Përforcimi:** Kontrolli i njohurive

Mësuesi/ja drejton disa pyetje, për të verifikuar marrjen e informacionit nga nxënësit.

- *Kur lindi krishterimi dhe çfarë shënon lindja e tij?*
- *Cilët perandorë njohën lirinë e besimit të krishterë?*
- *Ku dallon popullsia e Palestinës nga të gjithë popujt e Perandorisë Romake?*
- *Cilët janë faktorët që ndikuan në përhapjen e krishterimit?*
- *Cilat janë shkaqet që lidhen me dyndjen e popujve në Perandorinë Romake?*

**Vlerësimi:**

Vlerësimi bëhet duke pasur parasysh pjesëmarrjen e nxënësve në orën e mësimit në të gjitha etapat e saj dhe duke vënë në dukje rezultatet e arritura.

**Detyrë:**

- Mblidhni informacione rreth lindjes së Krishtit, përhapjes së krishterimit dhe ndikimit që pati kjo ngjarje në jetën e njerëzve.
- *Për orën pasardhëse:* Nxënësit ndahen në grupe, për t'u orientuar për orën pasardhëse, që është një orë projekt me temë "Banorët e hershëm të Ballkanit dhe ilirët". Nxënësit orientohen të kërkojnë informacione dhe të dhëna për zonat ku u shfaqën ilirët dhe burimet që vërtetojnë vazhdimësinë iliro-shqiptare.

**Sqarime për zgjidhjen e ushtrimeve të rubrikës:  
Gjurmë-Mendojmë-Arsyetojnë-Nxjerrim përfundime**

**Ushtrimi 6.**

Ky problem shtrohet për diskutim përpara nxënësve, të cilët lihen të lirë të japin mendimet e tyre. Përpara klasës shtrohet pyetja: *Çfarë ndodh me një person, familje apo shoqëri po humbi shpresat për të ardhmen dhe e kundërta, kur ata ushqehen me shpresën për të nesërmen?* Rasti i parë sjell dëshpërim, pakënaqësi, urrejtje e shqetësim për jetën e përditshme, ndërsa rasti i dytë sjell besim, forcë, guxim për të jetuar e për të kapur të nesërmen që shpreson.

Kujdes! Mësuesi/ja nuk duhet t'i japë asnjë ngjyrë politike diskutimit, por ta orientojë atë drejt situatave individuale dhe mund ta lidhë dhe me fenomenin e emigracionit, i cili u shfaq në Arbëri pas pushtimit osman, si dhe gjatë shek. XIX, veçanërisht për Shqipërinë e Jugut apo pas përmbysjes së diktaturës, fenomen ky që ndër shekuj ka përfshirë pothuajse të gjitha vendet. Ndjenja kombëtare e familjare, dashuria për punën e zhvillimi ekonomik i vendit si veprojnë në këtë rast e si nxiten ato. Problemi ndoshta është i një shkalle që kapërcen nivelin e moshës, por diskutimi i lirë e orienton mësuesin për këtë temë me vlera më shumë edukative e shpirtërore sesa historike. (Ky është vetëm një sugjerim!)

**Ushtrimi 8.**

Krishterimi fillimisht u përvetësua nga të varfrit, sepse ata përbënin shtresën më të shtypur, më të dëshpëruar, e cila kishte humbur shpresën për të ardhmen.



Fusha:	Lënda: Histori	Shkalla: III	Klasa: 6
<b>Tematika 2:</b> <ul style="list-style-type: none"> <li>Qytetërimet në brigjet e deteve të Mesdheut (shekulli VII pr. K. - shekullin V ps. K.)</li> </ul>	<b>Tema mësimore:</b> <ul style="list-style-type: none"> <li><b>Banorët e hershëm të Ballkanit dhe ilirët</b> (situatë e sugjeruar)</li> </ul>	<b>Situata e të nxënit:</b> <ul style="list-style-type: none"> <li>Mësuesi/ja zgjedh të dhëna nga burime të ndryshme për të demonstruar të kuptuarin e koncepteve në lidhje me temën nëpërmjet mjeteve pamore, si video-projektor, albume, fotografi etj.</li> </ul>	

**Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyç:****Kompetenca e komunikimit dhe e të shprehurit****Nxënësi:**

- zhvillon kompetencën e komunikimit për të ndërtuar kompetencat historike për të shqyrtuar, analizuar, për të parashtruar pyetje, për të argumentuar, për të diskutuar dhe për të komunikuar informacionin historik, konceptet dhe idetë.

**Kompetenca e të menduarit****Nxënësi:**

- zhvillon kompetencën e të menduarit për realizimin e kërkimit historik;
- zhvillon mendimin kritik për të përzgjedhur burimet, për të interpretuar të shkuarën nëpërmjet informacionit, për të dhënë argumente bazuar në burime dhe për të vërtetuar saktësinë e burimeve.

**Kompetenca e të nxënit****Nxënësi:**

- zbaton në mënyrë të pavarur udhëzimet për një temë, veprim, aktivitet ose detyrë që i kërkohet;
- ndërlidh temën e re ose një çështje të dhënë me njohuritë dhe përvojat paraprake, duke i paraqitur në forma të ndryshme të të shprehurit sipas një radhitjeje logjike;
- vlerëson pikëpamjet e ndryshme, si dhe menaxhon emocionet, ndjenjat, kohën, shfrytëzimin e burimeve dhe mjeteve gjatë kryerjes së një detyre në histori;
- identifikon përparësitë dhe mangësitë e tij në lidhje me zotërimin e dijeve dhe kompetencave historike në funksion të përparimit dhe përmirësimit të suksesit të tyre.

**Kompetenca për jetën, sipërmarrjen dhe mjedisin****Nxënësi:**

- harton hapat që duhet të ndjekë për realizimin e një kërkimi historik për një ngjarje të dhënë;
- zhvillon një kërkim individual ose në grup për kryerjen e një veprimtarie në histori;
- diskuton individualisht ose në grup për rëndësinë që ka e shkuara në kuptimin e së tashmes dhe perspektivat e të ardhmes.

**Kompetenca personale****Nxënësi:**

- zhvillon kompetencën personale për të kuptuar veten dhe të tjerët, ndryshimet dhe ngjashmëritë, për të menaxhuar marrëdhëniet ndërmjet njëri-tjetrit, për të vlerësuar pikëpamjet e të tjerëve, qofshin këto dhe të ndryshme nga të tija;
- kupton nëpërmjet kërkimit historik përvojën e njeriut, marrëdhëniet shkak-pasojë, trashëgiminë kulturore, rëndësinë historike, ndryshimet dhe vazhdimësinë që ka pësuar shoqëria përgjatë kohërave;
- përdor aftësitë e komunikimit, punës në grup etj., për të prezantuar dhe argumentuar idetë e tij.

### **Kompetenca qytetare**

#### **Nxënësi:**

- përdor aftësitë e komunikimit, punës në grup etj., për të prezantuar dhe argumentuar idetë e tij;
- kupton nëpërmjet kërkimit historik përvojën e njeriut, marrëdhëniet shkak-pasojë, trashëgiminë kulturore, rëndësinë historike, ndryshimet dhe vazhdimësinë që ka pësuar shoqëria përgjatë kohërave;
- shpjegon origjinën dhe zhvillimin e identitetit kombëtar duke vlerësuar trashëgiminë material edhe shpirtërore;
- shqyrton një sërë burimesh që paraqesin perspektiva të ndryshme kulturore në mënyrë që të zhvillojë kuptimin historik.

### **Kompetenca digjitale**

#### **Nxënësi**

- zhvillon kompetencën digjitale për të kërkuar, përzgjedhur, analizuar dhe komunikuar informacion historik;
- zgjedh një sërë burimesh digjitale të informacionit dhe analizon në mënyrë kritike këto burime historike;
- komunikon, prezanton dhe parashtron njohuritë, aftësitë dhe qëndrimet;
- bashkëpunon, diskuton dhe debaton me të tjerët për të ndërtuar konceptet dhe kompetencat historike.



<p><b>Rezultatet e të nxënit të kompetencave sipas temës.</b></p> <p><b>Nxënësi:</b></p> <ul style="list-style-type: none"><li>• tregon në hartë shtrirjen e qytetërimeve të hershme në Ballkan, duke evidentuar qytetërimin ilir;</li><li>• vlerëson etnosin ilir;</li><li>• tregon fiset ilire dhe organizimin shtetëror të tyre;</li><li>• përshkruan karakteristikat e jetës së përditshme në Iliri, si: veshja, ushqimi, mobilimi i shtëpive, martesat, zakonet, artin dhe besimin e tyre etj.</li></ul>	<p><b>Fjalë kyç:</b></p> <ul style="list-style-type: none"><li>• Ilir</li><li>• Maqedonas</li><li>• Trakë</li><li>• Tumë</li><li>• Vendbanim</li><li>• Palafite</li><li>• Pagan</li><li>• Banorë të hershëm</li><li>• Pirroja i Epirit</li><li>• Teuta</li></ul>
<p><b>Burimet:</b></p> <ul style="list-style-type: none"><li>• Teksti mësimor</li><li>• e-libri</li><li>• Harta e Ballkanit</li><li>• Materiale me pamje nga jeta dhe të mjeteve të punës e armëve të fiseve ilire</li><li>• Enciklopedi</li><li>• Materiale nga interneti</li></ul>	<p><b>Lidhja me fushat e tjera dhe me tema ndërkurrikulare:</b></p> <ul style="list-style-type: none"><li>• Gjeografi</li><li>• Art pamor</li></ul>

**Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve:**

**PNP:** Stuhi mendimesh - Lexim i orientuar - Prezantimi i punimit

**Parashikimi:** Stuhi mendimesh

Mësuesi/ja shkruan në tabelë fjalët "Parailirë" dhe "Ilirë" dhe nxit nxënësit të shprehin njohuritë që kanë për këta dy terma. Mësuesi/ja hedh në tabelë mendimet që shprehin nxënësit.



Më pas, mësuesi/ja pyet nxënësit:

- Cilët janë disa nga popujt e Ballkanit?
- Cilët janë fqinjët tanë?

**Ndërtimi i njohurive:** Lexim i orientuar

Duke marrë shkas nga përgjigjet e tyre, mësuesi/ja u kërkon nxënësve të lexojnë tekstin. Pas leximit të tekstit, ndahet klasa në katër grupe pune, ku secili grup merr detyrën përkatëse të caktuar paraprakisht nga mësuesi/ja, si më poshtë:

Grupi 1: Përgatitja e hartës së Ballkanit në mijëvjeçarin II-I me banorët e hershëm.

Grupi 2: Fiset ilire dhe shtrirja e tyre.

Grupi 3: Organizimi shtetëror i fiseve ilire.

Grupi 4: Besimi, arti dhe kultura e fiseve ilire.

Në këtë etapë, nxënësit bashkëpunojnë dhe bashkërendojnë materialet që kanë grumbulluar dhe i përgatisin ato në formën e një ekspozite të vogël, një fletëpalosjeje, një album, punim në Power Point për fiset ilire, shtrirjen e tyre, organizmin shtetëror, besimi, artin dhe kulturën e tyre.

**Përforcimi:** Prezantimi i punimit

Në etapën e fundit, një përfaqësues i secilit grup prezanton punimin e grupit të tij/saj dhe në fund të orës diskutohet për punimet që paraqitën grupet dhe jepen edhe vlerësimet.

Nxënësit bëjnë vlerësimet e tyre për punën e secilit grup.

**Vlerësimi:**

Vlerësimi bëhet duke pasur parasysh:

- Informacionin më të plotë e më të saktë që dha grupi.
- Prezantimin më të mirë.
- Bashkëpunimin më të mirë në grup.
- Pjesëmarrjen dhe aktivizimin e nxënësve në orën e mësimit.
- Punën individuale.

**Detyrë:**

- Përgatisni një kënd për fiset ilire, duke evidentuar vendbanimet, mjetet e punës, armët, veshjet, shtrirjen e tyre, harta etj.
- *Për orën pasardhëse:* Nxënësit ndahen në grupe duke u orientuar për orën pasardhëse, që është një orë projekt me temë "Maqedonia". Nxënësit orientohen të kërkojnë informacione dhe të dhëna qytetërimin maqedonas.

Fusha:	Lënda: Histori	Shkalla: III	Klasa: 6
<b>Tematika 2:</b> <ul style="list-style-type: none"> <li>Qytetërimet në brigjet e deteve të Mesdheut (shekulli VII pr. K. - shekullin V ps. K.)</li> </ul>	<b>Tema mësimore:</b> <ul style="list-style-type: none"> <li><b>Maqedonia</b> (<i>situatë e sugjeruar</i>)</li> </ul>	<b>Situata e të nxënit:</b> <ul style="list-style-type: none"> <li>Mësuesi/ja zgjedh të dhëna nga burime të ndryshme për të demonstruar të kuptuarin e koncepteve në lidhje me temën nëpërmjet mjeteve pamore, si video-projektor, albume, fotografi etj.</li> </ul>	

### Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyç:

#### **Kompetenca e komunikimit dhe e të shprehurit**

##### **Nxënësi:**

- zhvillon kompetencën e komunikimit për të ndërtuar kompetencat historike, për të shqyrtuar, për të analizuar, për të parashtruar pyetje, për të argumentuar, për të diskutuar dhe për të komunikuar informacionin historik, konceptet dhe idetë.

#### **Kompetenca e të menduarit**

##### **Nxënësi:**

- zhvillon kompetencën e të menduarit për realizimin e kërkimit historik;
- zhvillon mendimin kritik për të përzgjedhur burimet, për të interpretuar të shkuarën nëpërmjet informacionit, për të dhënë argumente bazuar në burime dhe për të vërtetuar saktësinë e burimeve.

#### **Kompetenca e të nxënit**

##### **Nxënësi:**

- zbaton në mënyrë të pavarur udhëzimet për një temë, veprim, aktivitet ose detyrë që i kërkohet;
- ndërlidh temën e re ose një çështje të dhënë me njohuritë dhe përvojat paraprake, duke i paraqitur në forma të ndryshme të të shprehurit sipas një radhitjeje logjike;
- vlerëson pikëpamjet e ndryshme, si dhe menaxhon emocionet, ndjenjat, kohën, shfrytëzimin e burimeve dhe mjeteve gjatë kryerjes së një detyre në histori;
- identifikon përparësitë dhe mangësitë e tij në lidhje me zotërimin e dijeve dhe kompetencave historike në funksion të përparimit dhe përmirësimit të suksesit të tyre.

#### **Kompetenca për jetën, sipërmarrjen dhe mjedisin**

##### **Nxënësi:**

- harton hapat që duhet të ndjekë për realizimin e një kërkimi historik për një ngjarje të dhënë;
- zhvillon një kërkim individual ose në grup për kryerjen e një veprimtarie në histori;
- diskuton individualisht ose në grup për rëndësinë që ka e shkuara në kuptimin e së tashmes dhe perspektivat e së ardhmes.

#### **Kompetenca personale**

##### **Nxënësi:**

- zhvillon kompetencën personale për të kuptuar veten dhe të tjerët, ndryshimet dhe ngjashmëritë, për të menaxhuar marrëdhëniet me të tjerët, vlerësuar pikëpamjet e të tjerëve, qofshin këto dhe të ndryshme nga të tija;
- kupton nëpërmjet kërkimit historik përvojën e njeriut, marrëdhëniet shkak-pasojë, trashëgiminë kulturore, rëndësinë historike, ndryshimet dhe vazhdimësinë që ka pësuar shoqëria përgjatë kohërave;
- përdor aftësitë e komunikimit, punës në grup etj., për të prezantuar dhe argumentuar idetë e tij.

**Kompetenca qytetare**

**Nxënësi:**

- përdor aftësitë e komunikimit, punës në grup etj., për të prezantuar dhe argumentuar idetë e tij.
- shpjegon origjinën dhe zhvillimin e identitetit kombëtar duke vlerësuar trashëgiminë materiale dhe shpirtërore;
- shqyrton një sërë burimesh që paraqesin perspektiva të ndryshme kulturore, në mënyrë që të zhvillojë kuptimin historik.

**Kompetenca digjitale**

**Nxënësi**

- zhvillon kompetencën digjitale për të kërkuar, përzgjedhur, analizuar dhe komunikuar informacion historik;
- përdor një sërë burimesh digjitale të informacionit dhe analizon në mënyrë kritike këto burime historike;
- komunikon, prezanton dhe parashton njohuritë, aftësitë dhe qëndrimet;
- bashkëpunon, diskuton dhe debaton me të tjerët për të ndërtuar konceptet dhe kompetencat historike.

<p><b>Rezultatet e të nxënit të kompetencave sipas temës:</b></p> <p><b>Nxënësi:</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• tregon në hartë shtrirjen e qytetërimit maqedonas;</li> <li>• tregon për organizimin shtetëror të Maqedonisë;</li> <li>• përshkruan karakteristikat e organizimit ushtarak të Maqedonisë;</li> <li>• përshkruan jetën dhe pushtimet e Aleksandrit të Madh të Maqedonisë.</li> </ul>	<p><b>Fjalë kyç:</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Aleksandri i Madh</li> <li>• Falangë</li> <li>• Ballkan</li> <li>• Pushtim</li> </ul>
<p><b>Burimet:</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Teksti mësimor</li> <li>• e-libri</li> <li>• Harta e Ballkanit</li> <li>• Materiale me pamje nga jeta dhe të mjeteve të punës e armëve të fiseve ilire</li> <li>• Enciklopedi</li> <li>• Materiale nga interneti</li> </ul>	<p><b>Lidhja me fushat e tjera dhe me tema ndërkurrikulare:</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Gjeografi</li> <li>• Art pamor</li> </ul>

**Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve:**

PNP: Bashkëbisedim - Lexim i orientuar - Prezantimi i punimit

**Parashikimi:** Bashkëbisedim

Mësuesi/ja i ka udhëzuar paraprakisht nxënësit për informacionet dhe të dhëna që duhet të mbledhin për Maqedoninë e hershme dhe Aleksandrin e Madh. Ndërkohë, nxiten nxënësit të lexojnë tekstin dhe më pas fillojnë të punojnë së bashku për të përgatitur punimet e tyre sipas udhëzimeve dhe ndarjeve në grupe pune që janë caktuar paraprakisht nga mësuesi/ja me detyrat përkatëse, si më poshtë:

Grupi 1: Pozicioni gjeografik dhe organizimi shtetëror i Maqedonisë.

Grupi 2: Organizimi ushtarak (falangat) i Maqedonisë nën sundimin e Filipit II.

Grupi 3: Pushtimet dhe luftërat e Aleksandrit të Madh (që sollën edhe lindjen e kulturës helenistike).



Aleksandri i Madh



Pjesa me ngjyrë kafe tregon territoret e pushtuara nga Aleksandri

**Ndërtimi i njohurive:** Lexim i orientuar.

Në etapën e dytë nxënësit bashkëpunojnë dhe bashkërendojnë materialet që kanë grumbulluar dhe i përgatisin ato në formën e një ekspozite të vogël, e një fletëpalosjeje, albumi, punimi në Power Point për Maqedoninë, shtrirjen e saj, organizmin ushtarak në periudhën e Filipit II dhe Aleksandrit të Madh, si dhe kulmin e zhvillimit dhe rënien e Maqedonisë.

**Përforcimi:** Prezantimi i punimit

Në etapën e fundit, një përfaqësues i secilit grup prezanton punimin e grupit të tij/saj dhe në fund të orës diskutohet për punimet që paraqitën grupet dhe jepen edhe vlerësimet. Nxënësit bëjnë vlerësimet e tyre për punën e secilit grup.

**Vlerësimi:**

Vlerësimi bëhet duke pasur parasysh:

- Informacionin më të plotë e më të saktë.
- Prezantimin më të mirë.
- Bashkëpunimin më të mirë në grup.
- Pjesëmarrjen dhe aktivizimin e nxënësve në orën e mësimit.
- Punën individuale.

**Detyrë:**

- Përgatisni një kënd me materiale dhe foto të Aleksandrit të Madh, duke evidentuar luftërat, pushtimet, ushtrinë, armët, veshjet dhe simbolet e tij e të Mbretit Filipi II.
- *Për orën pasardhëse:* Nxënësit ndahen në grupe duke u orientuar për orën pasardhëse, që është një orë projekt me temë “Perandorët romakë me origjinë ilire”. Nxënësit orientohen të kërkojnë informacione dhe të dhëna për perandorët romakë me origjinë ilire.

**Sqarime për zgjidhjen e ushtrimeve të rubrikës:  
Gjurmojmë-Mendojmë-Arsyetojmë-Nxjerrim përfundime**

**Ushtrimi 1.**

Falanga ishte njësi ushtarake e fuqishme, por e ngurtë. Në rrethana të caktuara, kur mund të goditej në befasi në brinjë (anë), ajo nuk mund të ndryshonte ballin e luftës (vijën e parë të frontit).

**Ushtrimi 2.**

Filipi II përdori këtë simbol për të treguar forcën e tij, sepse luani shprehte pozitën e “sunduesit” në mbretërinë e kafshëve dhe ishte kafsha më e fuqishme në botën e kafshëve.

**Ushtrimi 3.**

Granik, Issa, Gaugameta (në hartë shoqërohen me një simbol të veçantë).

**Ushtrimi 4.**

Ngjyrosjet duke përzierë dy ngjyrat e dhëna, të cilat japin ngjyrën jeshile (të blertë), që në këtë rast simbolizon kulturën henelistike, si një kulturë e përzier që jep një përmbajtje të re.

Fusha:	Lënda: Histori	Shkalla: III	Klasa: 6
<b>Tematika 2:</b> <ul style="list-style-type: none"> <li>Qytetërimet në brigjet e deteve të Mesdheut (shekulli VII pr. K. - shek. V ps. K.)</li> </ul>	<b>Tema mësimore:</b> <ul style="list-style-type: none"> <li><b>Perandorët romakë me origjinë ilire</b> (<i>situatë e sugjeruar</i>)</li> </ul>	<b>Situata e të nxënit:</b> Mësuesi/ja diskuton me nxënësit rreth njohurive që ata kanë për Perandorinë Romake.	

**Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyç:**
**Kompetenca e komunikimit dhe e të shprehurit**
**Nxënësi:**

- zhvillon kompetencën e komunikimit për të ndërtuar kompetencat historike për të shqyrtuar, për të analizuar, për të parashtruar pyetje, për të argumentuar, për të diskutuar dhe për të komunikuar informacionin historik, konceptet dhe idetë.

**Kompetenca e të menduarit**
**Nxënësi:**

- zhvillon kompetencën e të menduarit për realizimin e kërkimit historik;
- zhvillon mendimin kritik për të përzgjedhur burimet, për të interpretuar të shkuarën nëpërmjet informacionit, për të dhënë argumente bazuar në burime dhe për të vërtetuar saktësinë e burimeve.

**Kompetenca e të nxënit**
**Nxënësi:**

- zbaton në mënyrë të pavarur udhëzimet për një temë, veprimtari, aktivitet ose detyrë që i kërkohet;
- ndërlidh temën e re ose një çështje të dhënë me njohuritë dhe përvojat paraprake, duke i paraqitur në forma të ndryshme të të shprehurit sipas një radhitjeje logjike;
- vlerëson pikëpamjet e ndryshme, si dhe menaxhon emocionet, ndjenjat, kohën, shfrytëzimin e burimeve dhe mjeteve gjatë kryerjes së një detyre në histori;
- identifikon përparësitë dhe mangësitë e tij në lidhje me zotërimin e dijeve dhe kompetencave historike në funksion të përparimit dhe përmirësimit të suksesit të tyre.

**Kompetenca për jetën, sipërmarrjen dhe mjedisin**
**Nxënësi:**

- harton hapat që duhet të ndjekë për realizimin e një kërkimi historik për një ngjarje të dhënë;
- zhvillon një kërkim individual ose në grup për kryerjen e një veprimtarie në histori;
- diskuton individualisht ose në grup për rëndësinë që ka e shkuara në kuptimin e së tashmes dhe perspektivat e së ardhmes.

**Kompetenca personale**
**Nxënësi:**

- zhvillon kompetencën personale për të kuptuar veten dhe të tjerët, ndryshimet dhe ngjashmëritë, për të menaxhuar marrëdhëniet ndërmjet njëri-tjetrit, për të vlerësuar pikëpamjet e të tjerëve qofshin këto dhe të ndryshme nga të tija;
- kupton nëpërmjet kërkimit historik përvojën e njeriut, marrëdhëniet shkak-pasojë, trashëgiminë kulturore, rëndësinë historike, ndryshimet dhe vazhdimësinë që ka pësuar shoqëria përgjatë kohërave;
- përdor aftësitë e komunikimit, punës në grup etj., për të prezantuar dhe argumentuar idetë e tij.

### **Kompetenca qytetare**

#### **Nxënësi:**

- përdor aftësitë e komunikimit, punës në grup etj., për të prezantuar dhe argumentuar idetë e tij;
- kupton nëpërmjet kërkimit historik përvojën e njeriut, marrëdhëniet shkak-pasojë, trashëgiminë kulturore, rëndësinë historike, ndryshimet dhe vazhdimësinë që ka pësuar shoqëria përgjatë kohërave;
- shpjegon origjinën dhe zhvillimin e identitetit kombëtar duke vlerësuar trashëgiminë materiale dhe shpirtërore;
- shqyrton një sërë burimesh që paraqesin perspektiva të ndryshme kulturore, në mënyrë që të zhvillojë kuptimin historik.

### **Kompetenca digjitale**

#### **Nxënësi**

- zhvillon kompetencën digjitale për të kërkuar, përzgjedhur, analizuar dhe komunikuar informacion historik;
- akseson një sërë burimesh digjitale të informacionit dhe analizon në mënyrë kritike këto burime historike;
- komunikon, prezanton dhe parashtron njohuritë, aftësitë dhe qëndrimet;
- bashkëpunon, diskuton dhe debaton me të tjerët për të ndërtuar konceptet dhe kompetencat historike.

<p><b>Rezultatet e të nxënit të kompetencave sipas temës:</b></p> <p><b>Nxënësi:</b></p> <ul style="list-style-type: none"><li>• zbulon të dhëna për perandorët romakë me origjinë ilire;</li><li>• përshkruan jetën dhe kontributin e perandorëve romakë me origjinë ilire.</li></ul>	<p><b>Fjalë kyç:</b></p> <ul style="list-style-type: none"><li>• Perandor romak</li><li>• Bizant</li><li>• Ilir</li></ul>
<p><b>Burimet:</b></p> <ul style="list-style-type: none"><li>• Teksti mësimor</li><li>• e-libri</li><li>• Harta e Ballkanit</li><li>• Materiale me pamje nga jeta dhe të mjeteve të punës e armëve të fiseve ilire</li><li>• Enciklopedi</li><li>• Materiale nga interneti</li></ul>	<p><b>Lidhja me fushat e tjera dhe me tema ndërkurrikulare:</b></p> <ul style="list-style-type: none"><li>• Art pamor</li></ul>

### **Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve:**

PNP: Stuhi mendimesh - Lexim i orientuar - Prezantimi i punimit

#### **Parashikimi:** Stuhi mendimesh

Në etapën e parë të orës mësuesi/ja shfaq një material me video-projektor të përgatitur për perandorët romakë me origjinë ilire. Nxiten nxënësit të thonë se a njohin ata ndonjë perandor romak me origjinë ilire dhe nëse po, çfarë dinë për të.





**Ndërtimi i njohurive:** Lexim i orientuar

Nxënësit orientohen nga mësuesi/ja për të lexuar tekstin.

Mësuesi/ja i ka udhëzuar paraprakisht nxënësit për informacionet dhe të dhëna që duhet të mbledhin për perandorët romakë me origjinë ilire, duke evidentuar rolin dhe kontributin e tyre në drejtimin dhe zhvillimin e Perandorisë Romake. Ndërkohë, pasi të kenë lexuar tekstin, nxënësit fillojnë të punojnë së bashku për të përgatitur punimet e tyre sipas udhëzimeve dhe ndarjeve në grupe pune që janë caktuar paraprakisht nga mësuesi/ja me detyrat përkatëse, si më poshtë:

- Grupi 1: Anastasi (në Perandorinë Romake të Lindjes)
- Grupi 2: Diokleciani (në Perandorinë Romake të Perëndimit)
- Grupi 3: Kostandini i Madh (në Perandorinë Romake të Perëndimit)
- Grupi 4: Justiniani (në Perandorinë Romake të Lindjes)

Në këtë etapë mësimore, nxënësit bashkëpunojnë dhe bashkërendojnë materialet që kanë grumbulluar dhe i përgatisin ato në formën e një ekspozite të vogël, një fletëpalosjeje, albumi, punimi në Power Point për perandorët romakë me origjinë ilire, jetën e tyre, sundimin dhe drejtimin e perandorisë më të madhe të kohës dhe kontributin e tyre në jetën politike e ushtarake të perandorisë.

**Përforcimi:** Prezantimi i punimit

Në etapën e fundit, një përfaqësues i secilit grup prezanton punimin e grupit të tij/saj dhe në fund të orës diskutohet për punimet që paraqitën grupet dhe jepen edhe vlerësimet. Nxënësit bëjnë vlerësimet e tyre për punën e secilit grup.

**Vlerësimi:**

Vlerësimi bëhet duke pasur parasysh:

- Informacionin më të plotë e më të saktë.
- Prezantimin më të mirë.
- Bashkëpunimin më të mirë në grup.
- Pjesëmarrjen dhe aktivizimin e nxënësve në orën e mësimit.
- Punën individuale.

**Detyrë:**

- Përgatisni një album apo fletëpalosje me fotot e katër perandorët romakë me origjinë ilire dhe jepni informacione për ta, duke përfshirë kontributin e tyre në jetën politike e ushtarake të perandorive romake të Lindjes dhe Perëndimit.
- *Për orën pasardhëse:* Nxënësit ndahen në grupe, duke u orientuar për orën pasardhëse, që është një orë projekt me temë "Romanizimi dhe ilirët". Nxënësit orientohen të kërkojnë informacione dhe të dhëna për gjurmët e qytetërimit romak në vendin tonë (rruga "Egnatia", Butrint etj.).

Fusha:	Lënda: Histori	Shkalla: III	Klasa: 6
<b>Tematika 2:</b> <ul style="list-style-type: none"> <li>Qytetërimet në brigjet e deteve të Mesdheut (shekulli VII pr. K. -shekullin V ps. K.)</li> </ul>	<b>Tema mësimore:</b> <ul style="list-style-type: none"> <li><b>Romanizimi dhe ilirët</b> (<i>situatë e sugjeruar</i>)</li> </ul>	<b>Situata e të nxënit:</b> <ul style="list-style-type: none"> <li>Mësuesi/ja diskuton me nxënësit rreth njohurive që ata kanë për Perandorinë Romake, pushtimet e saj dhe sundimin.</li> </ul>	

### Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyç:

#### **Kompetenca e komunikimit dhe e të shprehurit**

##### **Nxënësi:**

- zhvillon kompetencën e komunikimit për të ndërtuar kompetencat historike, për të shqyrtuar, analizuar, për të parashtruar pyetje, për të argumentuar, për të diskutuar dhe për të komunikuar informacionin historik, konceptet dhe idetë.

#### **Kompetenca e të menduarit**

##### **Nxënësi:**

- zhvillon kompetencën e të menduarit për realizimin e kërkimit historik;
- zhvillon mendimin kritik për të përzgjedhur burimet, për të interpretuar të shkuarën nëpërmjet informacionit, për të dhënë argumente bazuar në burime dhe për të saktësuar saktësinë e burimeve.

#### **Kompetenca e të nxënit**

##### **Nxënësi:**

- zbaton në mënyrë të pavarur udhëzimet për një temë, veprimtari, aktivitet ose detyrë që i kërkohet;
- ndërlidh temën e re ose një çështje të dhënë me njohuritë dhe përvojat paraprake, duke i paraqitur në forma të ndryshme të të shprehurit sipas një radhitjeje logjike;
- vlerëson pikëpamjet e ndryshme, si dhe menaxhon emocionet, ndjenjat, kohën, shfrytëzimin e burimeve dhe mjeteve gjatë kryerjes së një detyre në histori;
- identifikon përparësitë dhe mangësitë e tij në lidhje me zotërimin e dijeve dhe kompetencave historike në funksion të përparimit dhe përmirësimit të suksesit të tyre.

#### **Kompetenca për jetën, sipërmarrjen dhe mjedisin**

##### **Nxënësi:**

- harton hapat që duhet të ndjekë për realizimin e një kërkimi historik për një ngjarje të dhënë;
- zhvillon një kërkim individual ose në grup për kryerjen e një veprimtarie në histori;
- diskuton individualisht ose në grup për rëndësinë që ka e shkuara në kuptimin e së tashmes dhe perspektivat e së ardhmes.

#### **Kompetenca personale**

##### **Nxënësi:**

- zhvillon kompetencën personale për të kuptuar veten dhe të tjerët, ndryshimet dhe ngjashmëritë, për të menaxhuar marrëdhëniet ndërmjet njëri-tjetrit, për të vlerësuar pikëpamjet e të tjerëve, qofshin këto dhe të ndryshme nga të tija;
- kupton nëpërmjet kërkimit historik përvojën e njeriut, marrëdhëniet shkak-pasojë, trashëgiminë kulturore, rëndësinë historike, ndryshimet dhe vazhdimësinë që ka pësuar shoqëria përgjatë kohërave;
- përdor aftësitë e komunikimit, punës në grup etj., për të prezantuar dhe argumentuar idetë e tij.

**Kompetenca qytetare**

**Nxënësi:**

- kupton nëpërmjet kërkimit historik përvojën e njeriut, marrëdhëniet shkak-pasojë, trashëgiminë kulturore, rëndësinë historike, ndryshimet dhe vazhdimësinë që ka pësuar shoqëria përgjatë kohërave;
- shpjegon origjinën dhe zhvillimin e identitetit kombëtar duke vlerësuar trashëgiminë materiale dhe shpirtërore;
- shqyrton një sërë burimesh që paraqesin perspektiva të ndryshme kulturore, në mënyrë që të zhvillojë kuptimin historik.

**Kompetenca digjitale**

**Nxënësi**

- zhvillon kompetencën digjitale për të kërkuar, përzgjedhur, analizuar dhe komunikuar informacion historik;
- përdor një sërë burimesh digjitale të informacionit dhe analizon në mënyrë kritike këto burime historike;
- komunikon, prezanton dhe parashtron njohuritë, aftësitë dhe qëndrimet;
- bashkëpunon, diskuton dhe debaton me të tjerët për të ndërtuar konceptet dhe kompetencat historike.


<p><b>Rezultatet e të nxënit të kompetencave sipas temës:</b></p> <p><b>Nxënësi:</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• përcakton në hartë territoret ku u zhvillua romanizimi;</li> <li>• shpjegon faktorët e zhvillimit të këtij fenomeni dhe shkaqet e kufizimit të tij.</li> </ul>	<p><b>Fjalë kyç:</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Romanizim</li> <li>• Rruga "Egnatia"</li> <li>• Butrint</li> <li>• Apoloni</li> <li>• Bylis</li> </ul>
<p><b>Burimet:</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Teksti mësimor</li> <li>• e-libri</li> <li>• Harta e Ballkanit</li> <li>• Materiale me pamje nga jeta dhe e mjeteve të punës e armëve të fiseve ilire</li> <li>• Enciklopedi</li> <li>• Materiale nga interneti</li> </ul>	<p><b>Lidhja me fushat e tjera dhe me tema ndërkurrikulare:</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Gjeografi</li> <li>• Art pamor</li> </ul>

**Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve:**

PNP: Bashkëbisedim - Lexim i orientuar - Prezantimi i punimit

**Parashikimi:** Bashkëbisedim

Në etapën e parë të orës mësimore, mësuesi/ja bashkëbisedon me nxënësit për Perandorinë Romake, luftërat e saj, pushtimin e Ilirisë, shkaqet e pushtimit dhe ndikimin që pati ajo në Perandorinë Ilire. Mësuesi/ja shënon në dërrasë të zezë mendimet e nxënësve.



**Ndërtimi i njohurive:** Lexim i orientuar

Ai/ajo ka udhëzuar paraprakisht nxënësit për informacionet dhe të dhëna që duhet të mbledhin për gjurmët e qytetërimit romak në Shqipëri, luftërat e zhvilluara në vendin tonë në periudhën romake, si dhe për objektet e zbuluara që i përkasin kësaj periudhe. Pasi të kenë lexuar tekstin “Lexim i orientuar”, nxënësit fillojnë të punojnë së bashku për të përgatitur punimet e tyre sipas udhëzimeve dhe ndarjeve në grupe pune që janë caktuar paraprakisht nga mësuesi/ja me detyrat përkatëse si më poshtë:

Grupi 1: Ndikimet romake në Shqipëri

Grupi 2: Ndikimi romak në organizimin e qyteteve ilire

Grupi 3: Ndikimi romak në art dhe kulturë



Gjurmë të ndikimit romak tek ilirët

Në etapën e dytë nxënësit bashkëpunojnë dhe bashkërendojnë materialet që kanë grumbulluar dhe i përgatisin ato në formën e një ekspozite të vogël, e një fletëpalosjeje, albumi, punimi në Power Point për ndikimet romake në vendin tonë, në organizimin e qyteteve ilire, si dhe në art e kulturë. Nxënësit mund të sjellin edhe pamje filmike e fotografike të vendeve historike që i përkasin periudhës romake në vendin tonë. Këto materiale pamore mund të jenë realizuar nga vetë ata.

**Përforcimi:** Prezantimi i punimit

Në etapën e fundit, një përfaqësues i secilit grup prezanton punimin e grupit të tij/saj dhe në fund të orës diskutohet për punimet që paraqitën grupet dhe jepen edhe vlerësimet.

Nxënësit bëjnë vlerësimet e tyre për punën e secilit grup.

**Vlerësimi:**

Vlerësimi bëhet duke pasur parasysh:

- Informacionin më të plotë e më të saktë.
- Prezantimin më të mirë.
- Bashkëpunimin më të mirë në grup.
- Pjesëmarrjen dhe aktivizimin e nxënësve në orën e mësimit.
- Punën individuale.

**Detyrë:**

Përgatisni një kënd me pamje të vendeve ku shihen ende gjurmë të qytetërimit romak, përfshirë këtu vende, si amfiteatri i Durrësit, objekte të Muzeut Arkeologjik në Durrës, rruga “Egnatia”, Butrinti, Apolonia etj.

**TESTIM**

Emri / Mbiemri \_\_\_\_\_

1. Rrethoni përgjigjen e saktë. (1 pikë)  
Një shekull ka: a) 50 vjet      b) 10 vjet      c) 100 vjet      ç) 1000 vjet

2. Gjeni përgjigjen e saktë. (1 pikë)  
Në cilët shekuj bëjnë pjesë këto vite: a) 365, b) 592, c) 657, d) 970, e) 1910.  
a) \_\_\_\_;      b) \_\_\_\_;      c) \_\_\_\_;      ç) \_\_\_\_;      e) \_\_\_\_;

3. Nga cilat fise u themelua qyteti i Romës? (1 pikë)  
a) Etruskët-latinët      b) Latinët-sabinët      c) Sabinët-italët

4. Cilat ishin arritjet ose shpikjet në qytetërimin e këtyre popujve? (3 pikë)

Qytetërimi	Arritjet/Shpikjet
Egjiptian	
Fenikas	
Babilonas	

5. Renditni popujt e lashtë të Ballkanit. (4 pikë)  
a) \_\_\_\_\_  
b) \_\_\_\_\_  
c) \_\_\_\_\_  
ç) \_\_\_\_\_

6. Shënoni kohën në vendet bosh. (5 pikë)  
a. Në \_\_\_\_\_ u shkruan ligjet që mbronin të drejtat e plebenjve.  
b. Roma u themelua në vitin \_\_\_\_\_.  
c. Lojërat e para olimpike në Greqinë e lashtë u organizuan në vitin \_\_\_\_\_.  
d. Perandoria Romake e Perëndimit mori fund së ekzistuari në vitin \_\_\_\_\_.  
e. Shteti i parë i bashkuar në Egjipt u krijua në vitin \_\_\_\_\_.

7. Çfarë i bashkon? (3 pikë)  
a. Sauli, Davidi, Solomoni: \_\_\_\_\_  
b. Spartanë, Periekë, Iliotë: \_\_\_\_\_  
c. Kuneiform, hieroglifë: \_\_\_\_\_

8. Renditni pasojat e dyndjeve barbare në Perandorinë Romake të Perëndimit. (3 pikë)  
a) \_\_\_\_\_  
b) \_\_\_\_\_  
c) \_\_\_\_\_  
ç) \_\_\_\_\_

9. Shënoni me "V" (e vërtetë) ose "G" (e gabuar) për fjalitë e mëposhtme. (2 pikë)

- a. Qytetërimi hebre i dha për herë të parë njerëzimit besimin monoteist. \_\_\_
- b. Alfabeti e ka zanafillën te qytetërimi indian. \_\_\_
- c. Lojërat e para olimpike u zhvilluan në Spartë. \_\_\_
- d. Në vitin 44 pr. K., Jul Cezari u shpall diktator për jetë. \_\_\_

10. Cilat ishin disa nga ligjet kryesore të Hamurabit? (3 pikë)

- a) \_\_\_\_\_
- b) \_\_\_\_\_
- c) \_\_\_\_\_

11. Si e kuptoni shprehjen "shtresa të mbyllura"? (4 pikë)

\_\_\_\_\_

\_\_\_\_\_

\_\_\_\_\_

12. Krahasoni zhvillimin politik të Athinës dhe Romës duke vënë në dukje rolin e demosit në Athinë dhe plebenjve në Romë. (5 pikë)

\_\_\_\_\_

\_\_\_\_\_

\_\_\_\_\_

\_\_\_\_\_

Pikët	0-7	8-13	14-19	20-24	25-30	31-33	34-35
Nota	4	5	6	7	8	9	10

Nxënësi/ja \_\_\_\_\_ mori \_\_\_\_\_ pikë dhe vlerësohet me notën \_\_\_\_\_.

### Tematika 3. Qytetërimet mesjetare në shekujt V - X

**Përshkrimi i tematikës:** Përmes kësaj tematike, nxënësit demonstrojnë njohuri, aftësi/shkathtësi, qëndrime dhe vlera mbi krijimin e Perandorisë Bizantine si vazhdim i qytetërimeve greko-romake, për ardhjen e sllavëve në Ballkan e Bizant, për tiparet e qytetërimit bizantin, si: organizimi shtetëror, ekonomik, kulturor dhe fetar, si dhe për tiparet e qytetërimit arab, përfshirë dhe organizimin shoqëror, ekonomik dhe kulturor. Gjithashtu, ata mësojnë rreth kushteve historike të lindjes së besimit islam, përhapjes dhe veçorive të tij. Kjo tematikë sugjerohet të zhvillohet në 5 orë mësimore. Për tematikën e dhënë më poshtë janë parashikuar edhe veprimtari/projekte, të cilat jepen në rubrikën "Situata të sugjeruara". Këto orë veprimtarish/projektsh mësuesi dhe autori i tekstit i integron brenda orëve të tematikës. Tematika së bashku me veprimtaritë/projektet realizojnë kompetencat lëndore dhe kompetencat kyç për të nxënit gjatë gjithë jetës.

1

Fusha:	Lënda: Histori	Shkalla: III	Klasa: 6
<b>Tematika 3:</b> <ul style="list-style-type: none"> <li>Qytetërimet mesjetare në shek. V - X</li> </ul>	<b>Tema mësimore:</b> <ul style="list-style-type: none"> <li><b>Qytetërimi bizantin</b></li> </ul>	<b>Situata e të nxënit:</b> <ul style="list-style-type: none"> <li>Mësuesja diskuton me nxënësit rreth ndarjes së Perandorisë Romake dhe krijimin e Perandorisë Bizantine, si dhe njohuritë e tyre për Kostandinopojën (Stambolli i sotëm)</li> </ul>	

#### Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyç:

##### **Kompetenca e të nxënit**

###### **Nxënësi:**

- zhvillon kompetencën e të nxënit për të shfrytëzuar të dhënat, për të demonstruar të kuptuarit e koncepteve historike dhe shoqërore, duke i prezantuar nëpërmjet formave të ndryshme të të shprehurit;
- ndërlidh temën e re ose një çështje të dhënë me njohuritë dhe përvojat paraprake, duke i paraqitur në forma të ndryshme të të shprehurit sipas një radhitjeje logjike.

##### **Kompetenca e komunikimit dhe e të shprehurit**

###### **Nxënësi:**

- përdor funksionet gjuhësore të teksteve historike, duke përfshirë fjalorin historik, fjali të ndërtuara saktë për të përshkruar ngjarje, për të shpjeguar marrëdhëniet shkak-pasojë, përdorimin e gjerë të emrave, ndajfoljeve dhe mbiemrave për të përshkruar vendet, njerëzit dhe ngjarjet.

##### **Kompetenca e të menduarit**

###### **Nxënësi:**

- zhvillon mendimin krijues për të ndërtuar interpretime të reja, të cilat shpjegojnë aspekte të së shkuarës, që janë të diskutueshme;
- zhvillon mendimin kritik për të përzgjedhur burimet, për të interpretuar të shkuarën nëpërmjet informacionit, për të dhënë argumente bazuar në burime dhe për të vërtetuar saktësinë e burimeve.

##### **Kompetenca për jetën, sipërmarrjen dhe mjedisin**

###### **Nxënësi:**

- diskuton individualisht ose në grup për rëndësinë që ka e shkuara në kuptimin e së tashmes dhe perspektivat e së ardhmes.

### **Kompetenca personale**

#### **Nxënësi:**

- kupton nëpërmjet kërkimit historik përvojën e njeriut, marrëdhëniet shkak-pasojë, trashëgiminë kulturore, rëndësinë historike, ndryshimet dhe vazhdimësinë që ka pësuar shoqëria përgjatë kohërave.


<b>Rezultatet e të nxënit të kompetencave sipas temës:</b> <b>Nxënësi:</b> <ul style="list-style-type: none"><li>• përcakton në hartë vendndodhjen e Perandorisë Bizantine;</li><li>• dallon shkaqet e krijimit të Perandorisë Bizantine;</li><li>• përcakton faktorët historikë që ndikuan në jetëgjatësinë e saj;</li><li>• përshkruan tiparet e qytetërimit bizantin;</li><li>• përcakton në hartë lëvizjet e sllavëve në Ballkan e Bizant;</li><li>• tregon pasojat e dyndjeve të sllave në Ballkan.</li></ul>	<b>Fjalë kyç:</b> <ul style="list-style-type: none"><li>• Toponim</li><li>• Bujkrobëri</li><li>• Patriark</li></ul>
<b>Burimet:</b> <ul style="list-style-type: none"><li>• Teksti mësimor</li><li>• e - libri</li><li>• Harta e Europës dhe Ballkanit</li><li>• Enciklopedi</li><li>• Materiale nga interneti</li></ul>	<b>Lidhja me fushat e tjera dhe me tema ndërkurrikulare:</b> <ul style="list-style-type: none"><li>• Gjeografi</li><li>• Qytetari</li></ul>

### **Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve:**

PNP: Stuhi mendimesh - Di-dua të di-mësova - Marrëdhënie pyetje-përgjigje

#### **Parashikimi:** Stuhi mendimesh

Mësuesi/ja i njeh nxënësit me temën e re dhe u kërkon atyre të thonë çfarë dinë për Perandorinë Romake, ndarjen e saj, shkaqet e rënies së Perandorisë së Perëndimit. Nxënësit sjellin ndër mend çfarë dinë për qytetërimin romak, duke përmendur terma, vende, ngjarje, emra, si: perandor, gladiator, plebenj, patricë, skllëvër, monarki, republikë, zgjerim terriore, kontinente, shtrirje territoriale, arkitekturë, Cezari, Oktaviani, pushtime, luftëra, kod ligjor, të Drejta Romake, ndarja e perandorisë, Kostandini, shkaqet e ndarjes së Perandorisë Romake në Perandoria e Lindjes dhe ajo e Perëndimit. Ata evidentojnë dyndjet e fiseve gjermanike në territoret perëndimore të perandorisë dhe shpërbërjen e Perandorisë së Perëndimit pikërisht nga këto fise.



Shtirja e Perandorisë Romake



**Ndërtimi i njohurive:** Di-dua të di-mësova

Mësuesi/ja u kërkon nxënësve të lexojnë pjesën e parë të mësimit, duke nënvizuar e komentuar për nëntemën e parë, "Qytetërimi bizantin dhe tiparet e tij". Ajo ndërton tabelën "Di - Dua të di - Mësova" dhe e plotëson së bashku me nxënësit.

Di	Dua të di	Mësova
Në vitin 395 ps. K., Perandoria Romake u nda në Perandorinë Lindjes (Perandoria Bizantine) dhe në Perandorinë e Perëndimit. Perandoria e Lindjes jetoi edhe për 1 000 vjet të tjera pas ndarjes së Perandorisë Romake.	Karakteristikat e qytetërimit bizantin, si u zhvillua ai, nga u ndikua, ku ndryshonte nga qytetërimi romak e ai grek.	<ul style="list-style-type: none"> <li>• U mbështet në trashëgiminë greko-romake.</li> <li>• U ndërtua sipas modelit romak.</li> <li>• U mbështet në ligjet romake.</li> <li>• Përdori gjuhën greke si gjuhë zyrtare.</li> <li>• Pas ndarjes së krishterimit në dy rite, katolike dhe ortodokse, ndoqi ritin ortodoks.</li> </ul>
Faktorët e rënies së Perandorisë Romake të Perëndimit; vështirësia e administrimit të territorit tepër të madh të pushtuar; luftërat e brendshme për pushtet, dyndjet barbare.	Faktorët që siguruan jetëgjatësinë e Perandorisë së Lindjes.	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Ushtri e madhe dhe e stërvitur mirë.</li> <li>• Zotëronte burime financiare.</li> <li>• Ndoqi politikë kompromisi me fiset që u dyndën në Ballkan.</li> <li>• Punoi për forcimin e fuqive detare dhe tokësore.</li> <li>• Popujt që u dyndën në Ballkan nuk ishin të organizuar.</li> </ul>
Popujt e Ballkanit (ilirë, grekë, maqedonas, serbë - sllavë)	Shkaqet dhe pasojat e dyndjeve sllave në Europë; a patën ata të njëjtat qëllime dhe motive si fiset gjermanike?	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Fiset sllave u dyndën në shek. VI-VII.</li> <li>• Fiset sllave ndahen në: <ul style="list-style-type: none"> <li>- sllavë të perëndimit (çekët, moravët, polakët)</li> <li>- sllavë të Lindjes (rusët)</li> <li>- sllavë të Jugut (serbët, bullgarët, kroatët)</li> </ul> </li> <li>• <i>Te sllavët e Lindjes</i>, shteti më i rëndësishëm ishte Rusia, me qendër qytetin e Kievit; ndodhi procesi i bujkrobërimit; pas dobësimit në shek. XII u krijuan principata.</li> <li>• <i>Sllavët e Jugut</i> u dyndën në Perandorinë Bizantine në shek. VI. Ata asimiluan popullsinë vendase duke krijuar dhe shtete (shteti bullgar – shek. VII, shteti serb – shek. IX); pushtuan shumë territore shqiptare, gjë që shpjegojnë edhe toponimet sllave të disa vendeve në Shqipëri.</li> </ul>

**Përforsimi:** Marrëdhënie pyetje-përgjigje

Në këtë fazë të orës mësimore, mësuesi/ja përdor teknikën e marrëdhënieve pyetje-përgjigjeve, me qëllim që të verifikojë marrjen e njohurive të reja. Ai/ajo ngre pyetje:

- *Cilët ishin disa nga faktorët historikë që ndikuan në jetëgjatësinë e Perandorisë Bizantine?*
- *Ku u mbështet Perandoria Bizantine?*
- *Cili ishte grupimi i sllavëve dhe si ndahen ata?*
- *Si mund të shpjegohen toponimet sllave në vendin tonë?*

**Vlerësimi:**

Vlerësimi bëhet duke pasur parasysh pjesëmarrjen e nxënësve në orën e mësimit në të gjitha etapat e saj dhe duke i vënë në dukje rezultatet.

**Detyrë:**

- Gjeni në internet disa nga toponimet sllave në Shqipëri, të shoqëruara me fotografi të vendit (nëse është e mundur).

Fusha:	Lënda: Histori	Shkalla: III	Klasa: 6
<b>Tematika 3:</b> <ul style="list-style-type: none"> <li>Qytetërimet mesjetare në shek. V - X</li> </ul>	<b>Tema mësimore:</b> <ul style="list-style-type: none"> <li><b>Organizimi shtetëror ekonomik, kulturor dhe fetar në Bizant</b></li> </ul>	<b>Situata e të nxënit:</b> <ul style="list-style-type: none"> <li>Mësuesja diskuton me nxënësit rreth organizimit shoqëror dhe politik në Perandorinë Bizantine.</li> </ul>	

### Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyç:

#### **Kompetenca e të nxënit**

##### **Nxënësi:**

- zhvillon kompetencën e të nxënit për të shfrytëzuar të dhënat, për të demonstruar të kuptuarit e koncepteve historike dhe shoqërore, duke i prezantuar nëpërmjet formave të ndryshme të të shprehurit;
- ndërlidh temën e re ose një çështje të dhënë me njohuritë dhe përvojat paraprake, duke i paraqitur në forma të ndryshme të të shprehurit sipas një radhitjeje logjike;
- parashtron pyetje kërkimore dhe përgjigjet, duke u bazuar në argumente dhe burime shkencore.

#### **Kompetenca e komunikimit dhe e të shprehurit**

##### **Nxënësi:**

- zhvillon kompetencën e komunikimit, për të ndërtuar kompetencat historike për të shqyrtuar, analizuar, për të parashtruar pyetje, për të argumentuar, për të diskutuar dhe për të komunikuar informacionin historik, konceptet dhe idetë.

#### **Kompetenca e të menduarit**

##### **Nxënësi:**

- zhvillon mendimin krijues për të ndërtuar interpretime të reja, të cilat shpjegojnë aspekte të së shkuarës, që janë të diskutueshme;
- analizon të dhënat numerike për të kuptuar të shkuarën, për shembull për të kuptuar shkakun dhe pasojën, vazhdimësinë dhe ndryshimin;
- zhvillon mendimin kritik për të përzgjedhur burimet, për të interpretuar të shkuarën nëpërmjet informacionit, për të dhënë argumente bazuar në burime dhe për të vërtetuar saktësinë e burimeve.

#### **Kompetenca personale**

##### **Nxënësi:**

- zhvillon kompetencën personale për të kuptuar veten dhe të tjerët, ndryshimet dhe ngjashmëritë, për të menaxhuar marrëdhëniet ndërmjet njëri-tjetrit, vlerësuar pikëpamjet e të tjerëve, qofshin këto dhe të ndryshme nga të tija;
- kupton nëpërmjet kërkimit historik përvojën e njeriut, marrëdhëniet shkak-pasojë, trashëgiminë kulturore, rëndësinë historike, ndryshimet dhe vazhdimësinë që ka pësuar shoqëria përgjatë kohërave;
- përdor aftësitë e komunikimit, punës në grup etj., për të shfaqur dhe argumentuar idetë e tij.

#### **Kompetenca qytetare**

##### **Nxënësi:**

- zhvillon kompetencën qytetare për të shqyrtuar në mënyrë kritike sjelljet, motivet dhe veprimet e njerëzve në të shkuarën, që mund të jenë rezultat i ndryshimit të qëndrimeve shoqërore dhe standardeve të ndryshme;
- shqyrton burimet historike për të kuptuar ngjarjet dhe zhvillimet që kanë ndikuar në shoqëri dhe grupe të ndryshme kulturore në kohëra të ndryshme, si dhe shpjegon natyrën, shkaqet dhe pasojat e konflikteve dhe ndërvarësinë kulturore;
- kupton se si qytetërimet dhe shoqëritë janë formuar nga grupe njerëzish me kultura të ndryshme; identifikon dallimet dhe ngjashmëritë ndërmjet kulturave të ndryshme dhe kultivon respekt ndaj kulturave të ndryshme nga e tija.

<p><b>Rezultatet e të nxëniet të kompetencave sipas temës:</b></p> <p><b>Nxënësi:</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• përshkruan tiparet e organizimit shtetëror, shoqëror dhe ekonomik në qytetërimin bizantin;</li> <li>• vlerëson arritjet e këtij qytetërimi në art, kulturë dhe arsim;</li> <li>• shpjegon karakterin dhe rolin e Kodit të Justinianit në zhvillimet ekonomike, shoqërore e politike në qytetërimin bizantin dhe atë evropian.</li> </ul>	<p><b>Fjalë kyç:</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Mozaik</li> <li>• Katolik</li> <li>• Ortodoks</li> <li>• Justiniani</li> <li>• Bizant</li> <li>• Kostandinopojë</li> </ul>
<p><b>Burimet:</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Teksti mësues</li> <li>• e - libri</li> <li>• Harta e Euroazisë</li> <li>• Materiale nga interneti me pamje nga Kisha e Shën Sofisë dhe e kishave të tjera të kohës së Bizantit</li> <li>• Enciklopedi</li> </ul>	<p><b>Lidhja me fushat e tjera dhe me tema ndërkurrikulare:</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Gjeografi</li> <li>• Art pamor</li> </ul>

<p><b>Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve:</b>  <b>PNP:</b> Klaster - Insert - Kontrolli i njohurive</p> <p><b>Parashikimi:</b> Klaster</p> <p>Mësuesi/ja shkruan në dërrasë të zeza togfjalëshin "Qytetërim romak" dhe "Qytetërim grek" dhe i nxit nxënësit të sjellin ndër mend të gjitha njohuritë që kanë për këto dy qytetërimet. Mësuesi/ja i shkruan mendimet e tyre në tabelë, duke evidentuar ato që lidhen me organizimin shoqëror, politik dhe kulturor.</p> <div style="display: flex; justify-content: space-around;"> <div data-bbox="300 1289 694 1655"> <p><b><u>Qytetërimi romak</u></b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Patric</li> <li>• Plebej</li> <li>• Viti 449 ps. K. iu dha e drejta plebenjve në senat</li> <li>• Nga monarki u kthye në republikë (senati dhe asambleja)</li> <li>• Nga republikë në perandori</li> <li>• Vazhdimësi e kulturës greke <ul style="list-style-type: none"> <li>• Besim politeist</li> </ul> </li> </ul> </div> <div data-bbox="861 1289 1268 1767"> <p><b><u>Qytetërimi grek</u></b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Shoqëria athinase ndahej në 4 shtresa: aristokracia, demosi, metikët, sklevërit; nga monarki në republikë (me organe drejtuese: mbledhja popullore, këshilli i drejtësisë, 9 arhondët)</li> <li>• Shoqëria spartane, formë qeverisëse - oligarki; (mbledhja popullore, këshilli i pleqve, mbikëqyrësit, dy mbretërit)</li> <li>• Besimi politeist, kulturë të zhvilluar, art, letërsi</li> </ul> </div> </div> <p><b>Ndërtimi i njohurive:</b> Insert</p> <p>Mësuesi/ja ndërton tabelën si më poshtë dhe u kërkon nxënësve ta plotësojnë në fletoren e tyre të klasës.</p>
---

√	+	-	?
<b>Nxënësit e dinë informacionin që po lexojnë</b>	<b>Informacioni i ri për nxënësit</b>	<b>Nxënësit e dinin ndryshe informacionin e ri</b>	<b>Informacioni shtesë</b>
Shoqëria bizantine është e ndarë në shtresa, ashtu si në qytetërimet e tjera.	Perandori dhe familja e tij në krye të shtresave; nëpunësit e lartë civilë dhe ushtarakë, udhëheqësit e kishës; zotëruesit e tokave. Pjesën më të madhe të popullsisë e përbënin banorët e fshatit (bujq e blegtorë) dhe banorët e qytetit (artizanë, tregtarë etj.).		
Ekonomia ishte në dorë të shtresave të larta.	Bizanti ishte urë lidhëse mes tri kontinenteve. U zhvillua tregtia e mallrave dhe e produkteve të sjella nga Lindja; kishte flotën e vet tregtare dhe monedhën e vet, që pranohej në çdo vend.		
Organizimi shtetëror ishte sipas modelit të Perandorisë Romake të Perëndimit. U mbështet në ligjet romake.	Bizanti ishte një monarki absolute. Perandori kishte pushtet absolut të të gjitha organet shtetërore dhe fetare. Perandori Justiniani zgjeroi territoret. U përpoq të ringjallte Perandorinë e dikurshme Romake. Ai nxori ligje, që njihen si Kodi i Justinianit, Justiniani shpalli paqen e përrjetshme dhe harmoninë mes popujve.	Bizanti u bë shteti më i madh i botës, duke ia kaluar edhe Romës së vjetër.	
Morën nga trashëgimia kulturore greko-romake.	U ndërtuan kisha e ndërtesa madhështore dhe u zbukuruan me mozaikë e portrete fetare. Arti bizantin pasqyron shenjtërimin e jetës, duke u larguar nga pasqyrimi i natyrës. Edhe arsimit ishte fetar, por u zhvillua dhe arsimit laik me shkolla fillore, të mesme dhe universitete.		
Praktikohesh feja e krishterë dhe ortodokse. Përdorej gjuha greke si gjuhë zyrtare. Patriarku ishte "Papa" i Kishës Ortodokse.	Në shërbesat fetare përdorej greqishtja në vend të latinishtes, gjë që solli krijimin e dy qendrave të fesë së krishterë - në Perëndim të udhëhequr nga Papa dhe në Lindje nga Patriarku. Kjo çoi në grindje mes dy qendrave, derisa të dyja kishat u ndanë plotësisht.		Katedralja e Shën Sofisë u kthye në xhami pas pushtimit të Kostandinopojës nga osmanët.



Kisha e Shën Sofisë përbën 1 nga 7 mrekullitë arkitekturore mesjetare

**Përforcimi:** Kontrolli i njohurive

Mësuesi/ja në këtë fazë të orës mësimore kalon te rubrika “Gjurmojmë-Mendojmë-Arsyetojmë-Nxjerrim përfundime”, ku bën pyetjet që janë hartuar në këtë rubrikë, me qëllim që të masë nivelin e marrjes së njohurive të reja të temës. Disa nga pyetjet që mund të bëhen janë:

- *Për çfarë u shqua Justiniani nga perandorët e tjerë dhe çfarë roli patën kodet e tij në jetën politike, ekonomike e shoqërore të Perandorisë Bizantine?*
- *Përse themi se Perandoria Bizantine ishte monarki absolute?*
- *Çfarë e karakterizon kulturën dhe arsimin në Perandorinë Bizantine?*
- *Ku u mbështet organizimi politik dhe kulturor i Perandorisë Bizantine?*

**Vlerësimi:**

Vlerësimi bëhet duke pasur parasysh pjesëmarrjen e nxënësve në orën e mësimit në të gjitha etapat e saj e duke i vënë në dukje rezultatet.

**Detyrë:**

Kërkoni në internet të dhëna shtesë për kodin e Justinianit, historikun e tij, vlerat dhe ndikimet në sistemet e mëvonshme ligjore.

Kodi i Justinianit



Fusha:	Lënda: Histori	Shkalla: III	Klasa: 6
<b>Tematika 3:</b> <ul style="list-style-type: none"> <li>Qytetërimet mesjetare në shek. V - X</li> </ul>	<b>Tema mësimore:</b> <ul style="list-style-type: none"> <li>Qytetërimi arab</li> </ul>	<b>Situata e të nxënit:</b> <ul style="list-style-type: none"> <li>Mësuesi/ja trajton me nxënësit tiparet e qytetërimit arab dhe besimin fetar islam për të bërë lidhje me temën e re.</li> </ul>	

### Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyç:

#### **Kompetenca e të nxënit**

##### **Nxënësi:**

- zhvillon kompetencën e të nxënit për të shfrytëzuar të dhënat, për të demonstruar të kuptuarit e koncepteve historike dhe shoqërore, duke i prezantuar nëpërmjet formave të ndryshme të të shprehurit;
- ndërlidh temën e re ose një çështje të dhënë me njohuritë dhe përvojat paraprake, duke i paraqitur në forma të ndryshme të të shprehurit sipas një radhitjeje logjike;
- parashtron pyetje kërkimore dhe përgjigjet duke u bazuar në argumente dhe burime.

#### **Kompetenca e komunikimit dhe e të shprehurit**

##### **Nxënësi:**

- zhvillon kompetencën e komunikimit për të ndërtuar kompetencat historike për të shqyrtuar, analizuar, për të parashtruar pyetje, për të argumentuar, për të diskutuar dhe për të komunikuar informacionin historik, konceptet dhe idetë.

#### **Kompetenca e të menduarit**

##### **Nxënësi:**

- analizon të dhënat numerike për të kuptuar të shkuarën, për shembull, për të kuptuar shkakun dhe pasojën, vazhdimësinë dhe ndryshimin;
- zhvillon mendimin kritik për të përzgjedhur burimet, për të interpretuar të shkuarën nëpërmjet informacionit, për të dhënë argumente bazuar në burime dhe për të vërtetuar saktësinë e burimeve.

#### **Kompetenca personale**

##### **Nxënësi:**

- kupton nëpërmjet kërkimit historik përvojën e njeriut, marrëdhëniet shkak-pasojë, trashëgiminë kulturore, rëndësinë historike, ndryshimet dhe vazhdimësinë që ka pësuar shoqëria përgjatë kohërave.

#### **Kompetenca qytetare**

##### **Nxënësi:**

- kupton se si qytetërimet dhe shoqëritë janë formuar nga grupe njerëzish me kultura të ndryshme, identifikon dallimet dhe ngjashmëritë ndërmjet kulturave të ndryshme dhe kultivon respekt ndaj kulturave të ndryshme nga e tij;
- zhvillon mirëkuptimin ndërkulturor, duke vlerësuar kulturat, gjuhët dhe besimet e ndryshme;
- kupton perspektivat, besimet dhe qëndrimet e njerëzve në të shkuarën e në të tashmen dhe rëndësinë e njohjes së historisë së tyre dhe të tjerëve;
- shqyrton një sërë burimesh që paraqesin perspektiva të ndryshme kulturore, në mënyrë që të zhvillojë kuptimin historik.

### Rezultatet e të nxënit të kompetencave sipas temës:

#### **Nxënësi:**

- tregon në hartë shtrirjen e kalifatit arab;
- përshkruan veçoritë e qytetërimit arab;
- vlerëson arritjet e qytetërimit arab në art, kulturë dhe shkencë;
- përshkruan kushtet historike të lindjes dhe përhapjes së besimit islam;
- njih dhe vlerëson disa nga figurat historike që i përkasin kësaj tematike, si Justiniani, Muhamedi, Omar Khajami, Avicena etj.

#### **Fjalë kyç:**

- Fe islame
- Kalifat
- Gadishull Arabik
- Myslman


<p><b>Burimet:</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Teksti mësuesor; e-libri</li> <li>• Harta e Euro-Azisë</li> <li>• Materiale nga objekte kulti të besimit islam</li> <li>• Enciklopedi</li> </ul>	<p><b>Lidhja me fushat e tjera dhe me tema ndërkurrikulare:</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Gjeografi</li> <li>• Qytetari</li> </ul>
--	---

**Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve:**

**PNP:** Stuhi mendimesh - Lexim në dyshe - Marrëdhënie pyetje-përgjigje


**Parashikimi:** Stuhi mendimesh

Mësuesi/ja shkruan në dërrasë të zezë grupin emëror "Fe islame" dhe pyet nxënësit se çfarë dinë për të. Ai/ajo nxit përfshirjen e nxënësve, duke shtuar se Profeti Muhamed është figura qendrore e kësaj feje. Ai/ajo shkruan në tabelë disa nga përgjigjet e nxënësve, veçanërisht ato që lidhen me temën e mësimit.




**Ndërtimi i njohurive:** Lexim në dyshe

Mësuesi/ja cakton tri çifte nxënësish për të realizuar teknikën "Lexim në dyshe". Ajo i orienton nxënësit të lexojnë tekstin e ndarë në pjesë, ku nxënësit në fund të çdo leximit duhet t'i thonë njëri-tjetrit atë që kanë lexuar, duke nënvizuar pika kyç dhe i shkruan ato në dërrasë të zezë. Mësuesi/ja shkruan çështjet kryesore të dyshes së parë.




Më pas, mësuesi/ja kalon në çiftin e dytë dhe evidenton çështjet kryesore të tekstit të këtij çifti nxënësish.





Pas mbarimit të çiftit të dytë të nxënësve, mësuesi/ja i kërkon çiftit të tretë të interpretojnë me anë të pyetjeve për pjesën që kanë lexuar dhe evidenton së bashku me ta pikat kryesore.



**Përforcimi:** Marrëdhënie pyetje-përgjigje:

Mësuesi/ja përdor rubrikën “Gjurmojmë-Mendojmë-Arsyetojmë-Nxjerrim përfundime”, duke bërë pyetjet që janë hartuar në këtë rubrikë, me qëllim që të masë nivelin e marrjes së njohurive të reja të temës. Disa nga pyetjet që mund të bëhen janë:

- *Kur lindi Muhamedi dhe çfarë përfaqëson ai?*
- *Kur lulëzoi islamizmi dhe si quhen besimtarët e tij?*
- *Çfarë ishin kalifët?*
- *Cilët ishin kufijtë e kalifatit arab?*
- *Cilat janë disa nga sukseset në art e kulturë të qytetërimit arab?*

**Vlerësimi:**

Vlerësimi bëhet duke pasur parasysh pjesëmarrjen e nxënësve në orën e mësimit në të gjitha etapat e saj e duke i vënë në dukje rezultatet.

**Detyrë:**

Kërkoni të dhëna shtesë në internet a burime të tjera për kontributin e qytetërimit arab në atë botëror.

*Për orën pasardhëse:* Nxënësit ndahen në grupe për t’u orientuar për orën pasardhëse, që është një orë projekt me temë “Pozita e vendit tonë gjatë periudhës së lulëzimit të qytetërimit bizantin”. Nxënësit orientohen të kërkojnë informacione dhe të dhëna për jetën politike, ekonomike dhe kulturore të Shqipërisë gjatë periudhës së qytetërimit bizantin.

**Sqarime për zgjidhjen e ushtrimeve të rubrikës:  
Gjurmojmë-Mendojmë-Arsyetojmë-Nxjerrim përfundime**

**Ushtrimi 2.**

Vendet boshe mbushen me këto të dhëna: Allah; Muhameti; 7 herë; ramazan; shpërndajnë ndihma dhe të holla për të varfrit; Mekë.



Fusha:	Lënda: Histori	Shkalla: III	Klasa: 6
<b>Tematika 3:</b> <ul style="list-style-type: none"> <li>Qytetërimet mesjetare në shek. V - X</li> </ul>	<b>Tema mësimore:</b> <ul style="list-style-type: none"> <li><b>Pozita e vendit tonë gjatë periudhës së lulëzimit të qytetërimit bizantin</b> (<i>situatë e sugjeruar</i>)</li> </ul>	<b>Situata e të nxënit:</b> <ul style="list-style-type: none"> <li>Mësuesi/ja diskuton me nxënësit rreth njohurive që ata kanë për Perandorinë Bizantine dhe qytetërimin bizantin në rajonin e Ballkanit.</li> </ul>	

**Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyç:**

**Kompetenca e komunikimit dhe e të shprehurit**

**Nxënësi:**

- zhvillon kompetencën e komunikimit për të ndërtuar kompetencat historike për të shqyrtuar, për të analizuar, për të parashtruar pyetje, për të argumentuar, për të diskutuar dhe për të komunikuar informacionin historik, konceptet dhe idetë.

**Kompetenca e të menduarit**

**Nxënësi:**

- zhvillon kompetencën e të menduarit për realizimin e kërkimit historik;
- zhvillon mendimin kritik për të përzgjedhur burimet, për të interpretuar të shkuarën nëpërmjet informacionit, për të dhënë argumente bazuar në burime dhe për të saktësuar saktësinë e burimeve.

**Kompetenca e të nxënit**

**Nxënësi:**

- zbaton në mënyrë të pavarur udhëzimet për një temë, veprim, aktivitet ose detyrë që i kërkohet;
- ndërlidh temën e re ose një çështje të dhënë me njohuritë dhe përvojat paraprake, duke i paraqitur në forma të ndryshme të të shprehurit sipas një radhitjeje logjike;
- vlerëson pikëpamjet e ndryshme, si dhe menaxhon emocionet, ndjenjat, kohën, shfrytëzimin e burimeve dhe mjeteve gjatë kryerjes së një detyre në histori;
- identifikon përparësitë dhe mangësitë e tij në lidhje me zotërimin e dijeve dhe kompetencave historike në funksion të përparimit dhe përmirësimit të suksesit të tyre.

**Kompetenca për jetën, sipërmarrjen dhe mjedisin**

**Nxënësi:**

- harton hapat që duhet të ndjekë për realizimin e një kërkimi historik për një ngjarje të dhënë;
- zhvillon një kërkim individual ose në grup për kryerjen e një veprimtarie në histori;
- diskuton individualisht ose në grup për rëndësinë që ka e shkuara në kuptimin e së tashmes dhe perspektivat e së ardhmes.

**Kompetenca personale**

**Nxënësi:**

- zhvillon kompetencën personale për të kuptuar veten dhe të tjerët, ndryshimet dhe ngjashmëritë, për të menaxhuar marrëdhëniet ndërmjet njëri-tjetrit, për të vlerësuar pikëpamjet e të tjerëve, qofshin ato edhe të ndryshme nga të tija;
- kupton nëpërmjet kërkimit historik përvojën e njeriut, marrëdhëniet shkak-pasojë, trashëgiminë kulturore, rëndësinë historike, ndryshimet dhe vazhdimësinë që ka pësuar shoqëria përgjatë kohërave;
- përdor aftësitë e komunikimit, punës në grup etj., për të prezantuar dhe argumentuar idetë e tij.

**Kompetenca qytetare**

**Nxënësi:**

- përdor aftësitë e komunikimit, punës në grup etj., për të prezantuar dhe argumentuar idetë e tij.
- kupton nëpërmjet kërkimit historik përvojën e njeriut, marrëdhëniet shkak-pasojë, trashëgiminë kulturore, rëndësinë historike, ndryshimet dhe vazhdimësinë që ka pësuar shoqëria përgjatë kohërave;

- shpjegon origjinën dhe zhvillimin e identitetit kombëtar duke vlerësuar trashëgiminë materiale dhe shpirtërore;
- shqyrton një sërë burimesh që paraqesin perspektiva të ndryshme kulturore, në mënyrë që të zhvillojë kuptimin historik.

### **Kompetenca digjitale**

#### **Nxënësi**

- zhvillon kompetencën digjitale për të kërkuar, përzgjedhur, analizuar dhe komunikuar informacion historik;
- përdor një sërë burimesh digjitale të informacionit dhe analizon në mënyrë kritike këto burime historike;
- komunikon, shfaq dhe parashtron njohuritë, aftësitë dhe qëndrimet e tij;
- bashkëpunon, diskuton dhe debaton me të tjerët për të ndërtuar konceptet dhe kompetencat historike.

<p><b>Rezultatet e të nxënit të kompetencave sipas temës:</b></p> <p><b>Nxënësi:</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• tregon elemente të kulturës bizantine të gjetura në territoret arbërore;</li> <li>• mbledh të dhëna për Principatën e Arbrit, si pararendëse e principatave të shek. XV;</li> <li>• ndikimi i qytetërimit bizantin në këtë principatë.</li> </ul>	<p><b>Fjalë kyç:</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Bizant</li> <li>• Principatë e Arbrit</li> <li>• Balshaj</li> <li>• Skuraj</li> </ul>
<p><b>Burimet:</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Teksti mësimor</li> <li>• e-libri</li> <li>• Harta e Shqipërisë</li> <li>• Materiale me pamje nga principatat shqiptare të periudhës bizantine, simbole dhe shtrirja e principatave</li> <li>• Enciklopedi</li> </ul>	<p><b>Lidhja me fushat e tjera dhe me tema ndërkurrikulare:</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Gjeografi</li> </ul>

### **Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve:**

**PNP:** Bashkëbisedim - Lexim i orientuar - Prezantimi i punimit

#### **Parashikimi:** Bashkëbisedim

Në fillim, mësuesi/ja shfaq një material që ka përgatitur paraprakisht për Principatën e Arbrit dhe principata të tjera shqiptare. Më pas, ai/ajo bashkëbisedon me nxënësit për Perandorinë Bizantine, lulëzimin, shtrirjen e saj, që janë njohuri që nxënësit i kanë marrë më parë dhe ndikimin e qytetërimit bizantin në vendin tonë dhe në rajonin e Ballkanit.

Mësuesi/ja ka udhëzuar paraprakisht nxënësit për informacionet dhe të dhëna që duhet të mbledhin për gjurmët e qytetërimit bizantin në Shqipëri, lulëzimin e tij, fuqizimin e principatave arbërore, objektet e zbuluar që i përkasin kësaj periudhe etj.



Kisha e Shën-Mërisë në Zvernec është ndërtuar në shek. XII dhe mbart vlera të kulturës bizantine.



Afresk bizantin, ku është gdhendur flamuri me shqiponjën me dy krerë.

**Ndërtimi i njohurive:** Lexim i orientuar, punë me hartën

Pasi të kenë lexuar tekstin "Lexim i orientuar", nxënësit fillojnë të punojnë së bashku për të përgatitur punimet e tyre sipas udhëzimeve dhe ndarjeve në grupe pune që janë caktuar paraprakisht nga mësuesi/ja me detyrat përkatëse, si më poshtë:

- Grupi 1: Principata e Arbrit: shtrirja, periudhën e lulëzimit, ndikimi bizantin në të dhe elementet që shprehin vetëqeverisjen e principatave etj.
- Grupi 2: Principatat feudale shqiptare të shek. XIII-XIV (Balshajt etj.), shtrirja, simbolet që shprehin vetëqeverisjen e tyre etj.
- Grupi 3: Hartimi i skemës "Sistemi feudal në Bizant"; krijimi i një posterit dhe paraqitja e tij para klasës.

**Përforcimi:** Prezantimi i punimit

Në këtë etapë të orës mësimore, nxënësit bashkëpunojnë dhe bashkërendojnë materialet që kanë grumbulluar dhe i përgatisin ato në formën e një ekspozite të vogël, me fletëpalosje, albume, punime në Power Point për qytetërimin bizantin në vendin tonë, për principatat arbërore, shtrirjen, simbolet, lulëzimin, vetëqeverisjen e tyre etj.

Një përfaqësues i secilit grup prezanton punimin e grupit të tij/saj dhe në fund të orës diskutohet për punimet që paraqitën grupet dhe jepen edhe vlerësimet. Nxënësit bëjnë vlerësimet e tyre për punën e secilit grup.

**Vlerësimi:**

Vlerësimi bëhet duke pasur parasysh:

- Informacionin më të plotë e më të saktë.
- Prezantimin më të mirë.
- Bashkëpunimin më të mirë në grup.
- Pjesëmarrjen dhe aktivizimin e nxënësve në orën e mësimit.
- Punën individuale.

**Detyrë:**

- Përgatitni një kënd artistik me pamje të elementeve të principatave arbërore, duke evidentuar simbolet, shtrirjen, harta me zotërimet e tyre, figurat kryesore të tyre etj.
- *Për orën pasardhëse:* Nxënësit ndahen në grupe, për t'u orientuar për orën pasardhëse, që është një orë projekt me temë "Pozita e vendit tonë gjatë periudhës së lulëzimit të qytetërimin bizantin". Nxënësit orientohen të kërkojnë informacione dhe të dhëna për jetën politike, ekonomike dhe kulturore të Shqipërisë gjatë periudhës së qytetërimin bizantin.

Fusha:	Lënda: Histori	Shkalla: III	Klasa: 6
<b>Tematika 3:</b> <ul style="list-style-type: none"> <li>Qytetërimet mesjetare në shek. V - X</li> </ul>	<b>Tema mësimore:</b> <ul style="list-style-type: none"> <li><b>Ndikimi i qytetërimit arab në Europë</b> (<i>situatë e sugjeruar</i>)</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>Mësuesi/ja bashkëbisedon me nxënësit për qytetërimin arab dhe shtrirjen e tij në tri kontinente.</li> </ul>	

**Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyç:**

***Kompetenca e komunikimit dhe e të shprehurit***

**Nxënësi:**

- zhvillon kompetencën e komunikimit për të ndërtuar kompetencat historike, për të shqyrtuar, për të analizuar, për të parashtruar pyetje, për të argumentuar, për të diskutuar dhe për të komunikuar informacionin historik, konceptet dhe idetë.

***Kompetenca e të menduarit***

**Nxënësi:**

- zhvillon kompetencën e të menduarit për realizimin e kërkimit historik;
- zhvillon mendimin kritik për të përzgjedhur burimet, për të interpretuar të shkuarën nëpërmjet informacionit, për të dhënë argumente bazuar në burime dhe për të vërtetuar saktësinë e burimeve.

***Kompetenca e të nxënit***

**Nxënësi:**

- zbaton në mënyrë të pavarur udhëzimet për një temë, veprim, aktivitet ose detyrë që i kërkohet;
- ndërlidh temën e re ose një çështje të dhënë me njohuritë dhe përvojat paraprake, duke i paraqitur në forma të ndryshme të të shprehurit sipas një radhitjeje logjike;
- vlerëson pikëpamjet e ndryshme, si dhe menaxhon emocionet, ndjenjat, kohën, shfrytëzimin e burimeve dhe mjeteve gjatë kryerjes së një detyre në histori;
- identifikon përparësitë dhe mangësitë e tij në lidhje me zotërimin e dijeve dhe kompetencave historike në funksion të përparimit dhe përmirësimit të suksesit të tyre.

***Kompetenca për jetën, sipërmarrjen dhe mjedisin***

**Nxënësi:**

- harton hapat që duhet të ndjekë për realizimin e një kërkimi historik për një ngjarje të dhënë;
- zhvillon një kërkim individual ose në grup për kryerjen e një veprimtarie në histori;
- diskuton individualisht ose në grup për rëndësinë që ka e shkuara në kuptimin e së tashmes dhe perspektivat e së ardhmes.

***Kompetenca personale***

**Nxënësi:**

- zhvillon kompetencën personale për të kuptuar veten dhe të tjerët, ndryshimet dhe ngjashmëritë, për të menaxhuar marrëdhëniet ndërmjet njëri-tjetrit, vlerësuar pikëpamjet e të tjerëve qofshin këto dhe të ndryshme nga të tija;
- kupton nëpërmjet kërkimit historik përvojën e njeriut, marrëdhëniet shkak-pasojë, trashëgiminë kulturore, rëndësinë historike, ndryshimet dhe vazhdimësinë që ka pësuar shoqëria përgjatë kohërave;
- përdor aftësitë e komunikimit, punës në grup etj. për të prezantuar dhe argumentuar idetë e tij.

**Kompetenca qytetare**

**Nxënësi:**

- përdor aftësitë e komunikimit, punës në grup etj. për të prezantuar dhe argumentuar idetë e tij.
- kupton nëpërmjet kërkimit historik përvojën e njeriut, marrëdhëniet shkak-pasojë, trashëgiminë kulturore, rëndësinë historike, ndryshimet dhe vazhdimësinë që ka pësuar shoqëria përgjatë kohërave;
- shpjegon origjinën dhe zhvillimin e identitetit kombëtar duke vlerësuar trashëgiminë material edhe shpirtërore;
- shqyrton një sërë burimesh që paraqesin perspektiva të ndryshme kulturore në mënyrë që të zhvillojë kuptimin historik.

**Kompetenca digjitale**

**Nxënësi**

- zhvillon kompetencën digjitale për të kërkuar, përzgjedhur, analizuar dhe komunikuar informacion historik
- përdor një sërë burimesh digjitale të informacionit dhe analizon në mënyrë kritike këto burime historike;
- komunikon, prezanton dhe parashtron njohuritë, aftësitë dhe qëndrimet;
- bashkëpunon, diskuton dhe debaton me të tjerët për të ndërtuar konceptet dhe kompetencat historike.

<p><b>Rezultatet e të nxënit të kompetencave sipas temës:</b></p> <p><b>Nxënësi:</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• evidenton ndikimin e qytetërimit arab në Europë;</li> <li>•</li> </ul>	<p><b>Fjalë kyç:</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Qytetërim arab</li> <li>• Matematikë</li> <li>• Mjekësi</li> <li>• Astronomi</li> <li>• Ndikimi në Europë</li> </ul>
<p><b>Burimet:</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Teksti</li> <li>• Harta e Euro-Azisë</li> <li>• Materiale me pamje ngjarjeve dhe vendeve ku evidentohet ndikimi i qytetërimit arab, foto të Avicenes, Omar Khajamit dhe figurave të tjera të rëndësishme të qytetërimit arab</li> <li>• Enciklopedi</li> </ul>	<p><b>Lidhja me fushat e tjera dhe me tema ndërkurrikulare:</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Gjeografi</li> <li>• Art pamor</li> <li>• Qytetari</li> </ul>

**Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve:**

**PNP:** Bashkëbisedim - Lexim i orientuar - Punë në grupe

**Parashikimi:** Bashkëbisedim

Në fazën e parë, mësuesi/ja shfaq bashkëbisedon me nxënësit për zhvillimin e qytetërimit arab në fusha, si: mjekësia, astronomia, matematika etj. Nxënësit evidentojnë figura të qytetërimit arab, të tilla si Avicena, Omar Khajami, kontributin e tyre etj., si dhe shtrirjen e qytetërimit arab në Afrikë, Azi dhe Europë.

**Ndërtimi i njohurive:** Lexim i orientuar

Në këtë fazë të orës mësimore, mësuesi/ja udhëzon nxënësit të lexojnë paragrafin e temës “Ndikimi i qytetërimit arab në Europë”. Pasi i ka udhëzuar paraprakisht nxënësit për informacionet dhe të dhënat që duhet të mbledhin për ndikimin e qytetërimit arab në fusha, si: mjekësia, astronomia, arkitektura, bujqësia etj. Nxënësit fillojnë të punojnë së bashku për të përgatitur punimet e tyre sipas udhëzimeve dhe ndarjeve në grupe pune, që janë caktuar paraprakisht nga mësuesi/ja me detyrat përkatëse, si më poshtë:

Grupi 1: Ndikimi i qytetërimit dhe kulturës arabe në fushat e jetës (bujqësi, blegtori, tregti) në Europë.

Grupi 2: Ndikimi i qytetërimit arab në shkencën, artin dhe kulturën europiane


Grupi 3: Jeta dhe veprimtaria e Avicenës dhe Omar Khajamit



Ndikimi në bujqësi



Ndikimi në shkencë



Omar Khajami

Në etapën e dytë nxënësit bashkëpunojnë dhe bashkërendojnë materialet që kanë grumbulluar dhe i përgatisin ato në formën e një ekspozite të vogël, me fletëpalosje, albume, punime në Power Point për ndikimin e qytetërimit arab në jetën ekonomike, politike dhe kulturore të Europës.

Në etapën e fundit, një përfaqësues i secilit grup prezanton punimin e grupit të tij/saj dhe në fund të orës diskutohet për punimet që paraqitën grupet dhe jepen edhe vlerësimet.

Nxënësit bëjnë vlerësimet e tyre për punën e secilit grup.

**Vlerësimi:**

Vlerësimi bëhet duke pasur parasysh:

- Informacionin më të plotë e më të saktë
- Prezantimin më të mirë
- Bashkëpunimin më të mirë në grup
- Pjesëmarrjen dhe aktivizimin e nxënësve në orën e mësimet
- Punën individuale

**Detyrë:**

Përgatitni një album me pamje të vendeve apo elementeve me ndikim nga qytetërimi arab.

TESTIM

Emri / Mbiemri \_\_\_\_\_

1. **Plotësoni.** (6 pikë)

- a. Karta e Madhe e Lirive u nënshkrua nga Mbreti \_\_\_\_\_.
- b. Kalifët ishin pasardhës të \_\_\_\_\_.
- c. Pushteti i pakufizuar i mbretit karakterizonte monarkinë \_\_\_\_\_.
- ç. E veçanta e qytetërimit bizantin ishte përdorimi i gjuhës \_\_\_\_\_.
- d. Lloji i qeverisjes ku mbreti ka pushtet të pakufizuar quhet \_\_\_\_\_.
- dh. Në qytetërimin arab i famshëm në fushën e mjekësisë ishte \_\_\_\_\_.

2. **Shënoni V (e vërtetë) apo G (e gabuar) për fjalitë e mëposhtme.** (4 pikë)

- a. Justiniani shpalli paqen e përhjetshme mes popujve. \_\_\_\_\_
- b. "Heretikët" lavdëronin kishën. \_\_\_\_\_
- c. Te sllavët e jugut bënë pjesë rusët. \_\_\_\_\_
- d. Kisha e Shën Sofisë u kthye në xhami. \_\_\_\_\_

3. **Shënoni kohën.** (5 pikë)

- Në vitin \_\_\_\_\_ selxhukët krijuan shtetin e tyre.
- Beteja në Fushë-Kosovë mes ballkanasve dhe osmanëve ndodhi në vitin \_\_\_\_.
- Në vitin \_\_\_\_\_ Muhamedi u largua nga Meka.
- Universiteti i parë u hap në periudhën e mesjetës në vitin \_\_\_\_\_.
- Perandoria Romake u nda në Perandori të Perëndimit e Lindjes në vitin \_\_\_\_.

4. **Fiset sllave i ndajmë në:** (1 pikë)

- a. \_\_\_\_\_
- b. \_\_\_\_\_
- c. \_\_\_\_\_

5. **Shpjegoni termat.** (4 pikë)

- a. Kryqëzatë \_\_\_\_\_
- b. Kalifat \_\_\_\_\_
- c. Bujkrob \_\_\_\_\_
- ç. Feudalizëm \_\_\_\_\_

6. **Cilët ishin faktorët që ndikuan në jetëgjatësinë e Perandorisë Bizantine?** (3 pikë)

- a. \_\_\_\_\_
- b. \_\_\_\_\_
- c. \_\_\_\_\_
- d. \_\_\_\_\_

7. **Bëni një përshkrim të shkurtër të qytetit mesjetar.** (3 pikë)

\_\_\_\_\_

\_\_\_\_\_

\_\_\_\_\_

\_\_\_\_\_

8. Cilat ishin disa pasojat pozitive të kryqëzatave?

(4 pikë)

- a. \_\_\_\_\_
- b. \_\_\_\_\_
- c. \_\_\_\_\_
- d. \_\_\_\_\_

9. Krahasoni “Monarkinë absolute” me “Monarkinë parlamentare/kushtetuese” dhe gjeni të përbashkëtat dhe dallimet mes tyre.

(4 pikë)

Monarkia absolute	Monarkia parlamentare

10. Cilat ishin dy pasojat negative të rënies së Perandorisë Bizantine?

(2 pikë)

- a) \_\_\_\_\_
- \_\_\_\_\_
- b) \_\_\_\_\_
- \_\_\_\_\_

11. Përshkruani organizimin shoqëror në Perandorinë Osmane.

(4 pikë)

\_\_\_\_\_

\_\_\_\_\_

\_\_\_\_\_

\_\_\_\_\_

Nota	4	5	6	7	8	9	10
Pikët	0-11	12-20	21-26	27-32	33-40	41-46	47-50

Nxënësi/ja \_\_\_\_\_ mori \_\_\_\_\_ pikë dhe vlerësohet me notën \_\_\_\_\_.



**TEMATIKA 4. Zhvillimi i qytetërimeve mesjetare në shek. X - XII**

**Përshkrimi i tematikës:** Përmes kësaj tematike, nxënësit demonstrojnë njohuri, aftësi/shkathtësi, qëndrime dhe vlera mbi feudalizmin si një sistem i ri, tiparet themelore të këtij sistemi: aristokracinë, vasalitetin, bujkrobërinë. Tematika trajton lindjen e qyteteve, zhvillimin e tregtisë, ndryshimin në strukturën shoqërore dhe në mënyrën e jetesës, si dhe marrëdhëniet midis dy qytetërimeve: ai perëndimor dhe lindor; kryqëzatat, marrëdhëniet tregtare. Kjo tematikë sugjerohet të zhvillohet në 7 orë mësimore. Për tematikën e dhënë më poshtë janë parashikuar dhe veprimtari/projekte, të cilat jepen në rubrikën "Situata të sugjeruara". Këto orë veprimtarish/projektesh mësuesi dhe autori i tekstit i integron brenda orëve të tematikës. Tematika së bashku me veprimtaritë/projektet realizojnë kompetencat lëndore dhe kompetencat kyç për të nxënësit gjatë gjithë jetës.

1

Fusha:	Lënda: Histori	Shkalla: III	Klasa: 6
<b>Tematika 4:</b> • Zhvillimi i qytetërimeve mesjetare në shek. X - XII	<b>Tema mësimore:</b> • <b>Ndryshimet në qytetërimet mesjetare europiane</b>	<b>Situata e të nxënësit:</b> • Mësuesi/ja bashkëbisedon fillimisht me nxënësit për rënien e Perandorisë Romake në Europë dhe pasojat e saj.	

**Rezultatet e të nxënësit sipas kompetencave kyç:****Kompetenca e të nxënësit****Nxënësi:**

- zhvillon kompetencën e të nxënësit për të shfrytëzuar të dhënat, për të demonstruar të kuptuarit e koncepteve historike dhe shoqërore, duke i prezantuar nëpërmjet formave të ndryshme të të shprehurit;
- ndërlihd temën e re ose një çështje të dhënë me njohuritë dhe përvojat paraprake, duke i paraqitur në forma të ndryshme të të shprehurit sipas një radhitjeje logjike;
- parashtron pyetje kërkimore dhe përgjigjet duke u bazuar në argumente dhe burime.

**Kompetenca e komunikimit dhe e të shprehurit****Nxënësi:**

- zhvillon kompetencën e komunikimit për të ndërtuar kompetencat historike, për të shqyrtuar, për të analizuar, për të parashtruar pyetje, për të argumentuar, për të diskutuar dhe për të komunikuar informacionin historik, konceptet dhe idetë.

**Kompetenca e të menduarit****Nxënësi:**

- analizon të dhënat numerike për të kuptuar të shkuarën, për shembull për të kuptuar shkakun dhe pasojën, vazhdimësinë dhe ndryshimin;
- zhvillon mendimin krijues për të ndërtuar interpretime të reja, të cilat shpjegojnë aspekte të së shkuarës, që janë të diskutueshme;
- zhvillon mendimin kritik për të përzgjedhur burimet, për të interpretuar të shkuarën nëpërmjet informacionit, për të dhënë argumente bazuar në burime dhe për të saktësuar saktësinë e burimeve.

**Kompetenca personale****Nxënësi:**

- kupton nëpërmjet kërkimit historik përvojën e njeriut, marrëdhëniet shkak-pasojë, trashëgiminë kulturore, rëndësinë historike, ndryshimet dhe vazhdimësinë që ka pësuar shoqëria përgjatë kohërave.

### **Kompetenca qytetare**

#### **Nxënësi:**

- kupton se si qytetërimet dhe shoqëritë janë formuar nga grupe njerëzish me kultura të ndryshme, identifikon dallimet dhe ngjashmëritë ndërmjet kulturave të ndryshme dhe kultivon respekt ndaj kulturave të ndryshme nga e tij;
- zhvillon mirëkuptimin ndërkulturor, duke vlerësuar kulturat, gjuhët dhe besimet e ndryshme;
- kupton perspektivat, besimet dhe qëndrimet e njerëzve në të shkuarën e në të tashmen dhe rëndësinë e njohjes së historisë së tyre dhe të tjerëve;
- shqyrton një sërë burimesh që paraqesin perspektiva të ndryshme kulturore në mënyrë që të zhvillojë kuptimin historik.

<p><b>Rezultatet e të nxënit të kompetencave sipas temës:</b></p> <p><b>Nxënësi:</b></p> <ul style="list-style-type: none"><li>• shpjegon tiparet themelore të sistemit feudal;</li><li>• dallon ndryshimet e këtij sistemi në jetën ekonomike dhe shoqërore;</li><li>• përshkruan detyrimet e shtresave shoqërore ndaj njëra-tjetrës.</li></ul>	<p><b>Fjalë kyç:</b></p> <ul style="list-style-type: none"><li>• Feudalizëm</li><li>• Fisnikëri</li><li>• Vasalitet</li><li>• Bujkrobëri</li><li>• Vasal</li><li>• Detyrim</li></ul>
<p><b>Burimet:</b></p> <ul style="list-style-type: none"><li>• Teksti mësimor</li><li>• e-libri</li><li>• Harta e Europës mesjetare</li><li>• Pamje dhe foto të ndryshme që i përkasin Europës mesjetare</li><li>• Enciklopedi</li><li>• Materiale nga interneti</li></ul>	<p><b>Lidhja me fushat e tjera dhe me tema ndërkurrikulare:</b></p> <ul style="list-style-type: none"><li>• Gjeografi</li></ul>

### **Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve:**

**PNP:** Diskutim - Ditari dypjesësh - Marrëdhënie pyetje-përgjigje

**Parashikimi:** Diskutim

Mësuesi/ja i njuh nxënësit me temën e re dhe u kërkon të diskutojnë rreth dyndjeve të fiseve gjermanike në territoret e Perandorisë Romake dhe arsyt e rënies së kësaj perandorie. Nxënësit flasin për dyndjes e hunëve, gotëve, visigotëve etj., dhe disa nga shkaqet e rënies së perandorisë, të tilla si vështirësitë në administrimin e një territori tepër të madh të pushtuar nga Perandoria Romake, luftërat për pushtet politik, shkatërrimet që shpërbënë perandorinë etj.

**Ndërtimi i njohurive:** Ditari dypjesësh

Mësuesi/ja me këtë teknikë të ndërtimit të njohurive sqaron se me rënien e Perandorisë u krijuan shtetet romano-gjermane. Ai/ajo u kërkon nxënësve të lexojnë nëntemën e parë, "Lindja e sistemit feudal dhe tiparet e tij", duke nënvizuar e komentuar. Mësuesi/ja vizaton në dërrasë të zezë tabelën e mëposhtme, të cilën e plotëson pas leximit të nëntemës së parë nga nxënësit.

<b>Çështja</b>	<b>Komenti</b>
Lindja e sistemit feudal dhe tiparet e tij	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Vendosja e sistemit feudal në Europë lidhet me lindjen e shtetit frank.</li> <li>• Pas rënies së Perandorisë Romake u krijuan shtetet romano-gjermane.</li> <li>• Mbretëria franke me Karlin e Madh si sundimtar të kurorëzuar nga Papa në vitin 800 u quajt Perandoria e Shenjtë Romake. Ajo përfshinte territoret e Europës Qendrore dhe Perëndimore.</li> <li>• Karli u dhuroi toka kalorësve të tij, për të siguruar besnikërinë, të ardhurat dhe shërbimet e tyre ushtarake, me qëllim që të mundësonte një zotërim të sigurt të mbretërisë së tij.</li> <li>• Kalorësit copëtuan pronat e tyre, duke ua dhënë kalorësve të tjerë. Kështu lindi një zinxhir pronarësh me tituj të ndryshëm në varësi të madhësisë së pronës dhe titujve (<i>Kalorës, Baron, Kont, Dukë</i>).</li> <li>• Prona e dhënë me kusht u quajt "feud" dhe pronari "feudal".</li> <li>• Në shek. XI-XII lindi feudalizmi me tipare kryesore: vartësia (vasaliteti) dhe detyrimi.</li> </ul>

Më pas, mësuesi/ja kalon në nëntemën e dytë, "Hierarkia feudale", dhe u kërkon nxënësve ta lexojnë atë për 2-3 minuta. Ai/ajo evidenton se, ashtu si në Perandorinë Romake të Perëndimit apo edhe të Lindjes, shoqëria ishte e ndarë në shtresa dhe kishte një hierarki.

<b>Çështja</b>	<b>Komenti</b>
Hierarkia feudale	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Mbreti qëndronte në krye të hierarkisë.</li> <li>• Pas mbretit vinin Duka, Konti, Baroni dhe në fund vinte Kalorësi.</li> <li>• Një varësi e tillë quhej vasalitet. Mbretit i bindej vetëm duka; të tjerët poshtë tij nuk kishin detyrime ndaj mbretit, duke sjellë kështu anarkinë feudale dhe luftëra mes feudalëve të ndryshëm, të cilët përbuznin punën dhe merreshin me stërvitje ushtarake, gjueti dhe bankete</li> <li>• Hierarkia përfshinte edhe kishën katolike, me Papën në krye dhe të tjerë që vinin pas tij në renditje. I njëjtin rregull vasaliteti ishte edhe për rrethet fetare.</li> </ul>

Duke ndjekur shpjegimin e mësuesit/es, nxënësit plotësojnë në fletore atë që mësuesi/ja plotëson në tabelë.

Në nëntemën e tretë, "Jeta shoqërore dhe ekonomike në sistemin feudal", mësuesi/ja evidenton dy çështje: 1. Jeta shoqërore; 2. Jeta ekonomike.

<b>Çështja</b>	<b>Komenti</b>
Jeta shoqërore	<ul style="list-style-type: none"> <li>• U krijuan tri grupe të mëdha shoqërore: feudalët (pronarë të mëdhenj tokash), kleri dhe popullsia.</li> <li>• Popullsia: fshatarë të lirë, bujkrobër dhe banorë të qytetit (zejtarë, tregtarë, shërbyes, punëtorë etj.).</li> <li>• Bujkrobërit përbënin 90% të popullsisë.</li> <li>• Bujkrobi ishte i lidhur përjetë me tokën; punonte tokën e dhënë nga feudali dhe i jepnin detyrime atij në natyrë (mall) dhe punë angari. Me lindjen e parasë, bujkrobi i jepte të ardhura në para feudalit dhe kjo u quajt “rentë në të holla”.</li> </ul>
Jeta ekonomike	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Bujqësia ishte baza e ekonomisë.</li> <li>• Lindja e qyteteve solli degë të reja të ekonomisë, si zejtaria dhe tregtia.</li> <li>• Shkëmbimi mall me mall filloi t’i lërë vendin shkëmbimit me monedha dhe paraja u bë mjeti kryesor në shkëmbimet e prodhimit.</li> <li>• Ky ndryshim u pasqyrua edhe në jetën ekonomike të fshatit.</li> </ul>

**Përforcimi:** Marrëdhënie pyetje-përgjigje

Mësuesi/ja i udhëzon nxënësit të punojnë me rubrikën “Gjurmojmë-Mendojmë-Arsyetojmë-Nxjerrim përfundime” në tekst, për të nxitur një debat të vogël, me qëllim matjen e përhithjes së njohurive të reja të temës.

- *Si e kuptoni termin “bujkrob”?*
- *A mund të përmirësohej jeta e bujkrobit dhe pse?*
- *Krahasoni detyrimin në natyrë (mall me mall) me detyrimin në të holla. Sipas jush, cili e rëndoi më shumë bujkrobin?*
- *Si e kuptoni shprehjen: ‘Vasali i vasalit tim nuk është vasali im’?*

**Vlerësimi:**

Vlerësimi bëhet duke pasur parasysh pjesëmarrjen e nxënësve në orën e mësimit në të gjitha etapat e saj e duke i vënë në dukje rezultatet.

**Detyrë:**

Përkufizoni termin “feudalizëm”. Si lindi sistemi feudal? Krijoni dhe plotësoni skemën “Struktura shoqërore në Europën mesjetare” në seksionin “Gjurmojmë-Mendojmë-Arsyetojmë-Nxjerrim përfundime” (në faqen 51 të librit.)

**Sqarime për zgjidhjen e ushtrimeve të rubrikës:  
Gjurmojmë-Mendojmë-Arsyetojmë-Nxjerrim përfundime**

**Ushtrimi 5.**

Bujkrob – Fshatari në sistemin feudal, që ishte rob i feudalit a i çifligarit e shfrytëzohej prej tij, që nuk kishte asnjë të drejtë mbi tokën, mbi mjetet e punës, mbi prodhimet e asnjë të drejtë qytetare dhe që mund të shitej e të blihej si skllav së bashku me tokën.

- a) Jo! Detyrimet feudale ishin të caktuara. Ato nuk ndryshonin, por mund të rëndoheshin. Nëse ato ndryshoheshin në dëm të feudalit, kjo do të thotë se sistemi feudal ndodhej në krizë.
- b) Detyrimet në para e rëndonin më shumë gjendjen e bujkrobit, pasi feudali shkonte duke e rritur kërkesën në para.

**Ushtrimi 7.**

Kjo shprehte varësinë apo vasalitetin në sistemin feudal; nëse “b” është vasal i “a”-së dhe “c” vasal i “b”-së, “c”-ja nuk është vasal i “a”-së.

Fusha:	Lënda: Histori	Shkalla: III	Klasa: 6
<b>Tematika 4:</b> <ul style="list-style-type: none"> <li>Zhvillimi i qytetërimeve mesjetare në shek. X - XII</li> </ul>	<b>Tema mësimore:</b> <ul style="list-style-type: none"> <li>Zhvillimi i qyteteve në mesjetë</li> </ul>	<b>Situata e të nxënit:</b> <ul style="list-style-type: none"> <li>Mësuesi/ja diskuton me nxënësit për organizimin e qyteteve mesjetare dhe bën dallimin me qytetet sot</li> </ul>	

**Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyç:****Kompetenca e të nxënit****Nxënësi:**

- ndërlidh temën e re ose një çështje të dhënë me njohuritë dhe përvojat paraprake, duke i paraqitur në forma të ndryshme të të shprehurit sipas një radhitjeje logjike;
- parashtron pyetje kërkimore dhe përgjigjet duke u bazuar në argumente dhe burime;
- zhvillon kompetencën e të nxënit për të shfrytëzuar të dhënat për të demonstruar të kuptuarit e koncepteve historike dhe shoqërore, duke i prezantuar nëpërmjet formave të ndryshme të të shprehuri.

**Kompetenca e komunikimit dhe e të shprehurit****Nxënësi:**

- zhvillon kompetencën e komunikimit për të ndërtuar kompetencat historike për të shqyrtuar, për të analizuar, për të parashtruar pyetje, për të argumentuar, për të diskutuar dhe për të komunikuar informacionin historik, konceptet dhe idetë.

**Kompetenca e të menduarit****Nxënësi:**

- analizon të dhënat numerike për të kuptuar të shkuarën, për shembull për të kuptuar shkaktuesin dhe pasojën, vazhdimësinë dhe ndryshimin;
- zhvillon mendimin krijues për të ndërtuar interpretime të reja, të cilat shpjegojnë aspekte të së shkuarës, që janë të diskutueshme;
- zhvillon mendimin kritik për të përzgjedhur burimet, për të interpretuar të shkuarën nëpërmjet informacionit, për të dhënë argumente bazuar në burime dhe për të saktësuar saktësinë e burimeve.

**Kompetenca personale****Nxënësi:**

- kupton nëpërmjet kërkimit historik përvojën e njeriut, marrëdhëniet shkak-pasojë, trashëgiminë kulturore, rëndësinë historike, ndryshimet dhe vazhdimësinë që ka pësuar shoqëria përgjatë kohërave.

**Kompetenca qytetare****Nxënësi:**

- kupton se si qytetërimet dhe shoqëritë janë formuar nga grupe njerëzish me kultura të ndryshme, identifikon dallimet dhe ngjashmëritë ndërmjet kulturave të ndryshme dhe kultivon respekt ndaj kulturave të ndryshme nga e tij;
- shqyrton një sërë burimesh që paraqesin perspektiva të ndryshme kulturore në mënyrë që të zhvillojë kuptimin historik.

**Rezultatet e të nxënit të kompetencave sipas temës:****Nxënësi:**

- tregon faktorët që çuan në lindjen e qyteteve mesjetare;
- përshkruan një qytet mesjetar;
- vlërëson rolin e tregtisë në zhvillimin e qytetit mesjetar;
- përshkruan lindjen dhe zhvillimin e qyteteve;
- tregon arsyet e luftës së qyteteve kundër feudalëve;
- arsyeton rreth elementeve të vetadministrimit të qyteteve në mesjetë.

**Fjalë kyç:**

- Republikë e pavarur
- Katedrale
- Qytet
- Vetëqeverisje
- Flotë tregtare
- Kështjellë

**Burimet:**

- Teksti mësimor
- e-libri
- Harta e Europës mesjetare
- Imazhe e foto të ndryshme që i përkasin qyteteve të Europës mesjetare
- Enciklopedi
- Materiale nga interneti

**Lidhja me fushat e tjera dhe me tema ndërkurrikulare:**

- Gjeografi

**Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve:**

**PNP:** Klaster - Lexim i drejtuar - Minutat e debatit

**Parashikimi:** Klaster

Mësuesi/ja jep dy koncepte “Fshat” dhe “Qytet” dhe u kërkon nxënësve të sjellin në mendje si ishin qytetet në qytetërimin romak, grek dhe bizantin. Ai/ajo u kujton nxënësve se lindja e qyteteve solli zhvillimin e degëve të reja të ekonomisë, si zejtaria, tregtia, paraja, të cilat janë disa nga elementet kryesore të qytetërimit të asaj kohe.



Athina mesjetare



Roma mesjetare

**Ndërtimi i njohurive:** Lexim i drejtuar

Mësuesi/ja orienton nxënësit të lexojnë nëntemat e tekstit, duke parashikuar në fillim për atë që do të lexojnë dhe në fund bëjnë përputhjen e njohurive që parashikojnë me ato që do të marrin.

**Nëntema I: “Lindja dhe zhvillimi i qyteteve”**

<i>Nxënësit parashikojnë</i>	<i>Nxënësit mësojnë</i>
<ul style="list-style-type: none"> <li>• Zhvillimi i qyteteve lidhet me veprimtari të ndryshme të njerëzve, që merren, përveç bujqësisë, edhe me zejtarë, tregtarë etj.</li> <li>• Përdorimi i parasë është tregues i zhvillimit të qyteteve.</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Ndarja e zejtarisë nga bujqësia gjallëroi jetën e qyteteve.</li> <li>• Qytetet u krijuan pranë kështjellave, manastireve, lumenjve, kryqëzime rrugësh dhe u kthyen në qendra zejtarie e tregtie.</li> <li>• Qytete të tilla lindën në Italinë e Veriut (Gjenova, Venecia, Piza etj.); në jug të Francës në shek. XI etj. Këto qytete zhvilluan tregti me fshatrat dhe me qytetërimi të tjera, si ai bizantin dhe arab.</li> <li>• Gjenova dhe Venecia ndërtuan flotat e tyre tregtare.</li> </ul>

Më pas, mësuesi/ja kalon në nëntemën e dytë, “Pamja e qyteteve mesjetare”, ku u kërkon nxënësve të parashikojnë pamjen e këtyre qyteteve dhe pasi e lexojnë atë për 2-3 minuta evidentojnë edhe atë që mësojnë.

<b>Nxënësit parashikojnë</b>	<b>Nxënësit mësojnë</b>
<ul style="list-style-type: none"> <li>• Qytetet mesjetare kishin kështjella, ku jetonin njerëzit e pasur, me rrugë të ngushta.</li> <li>• Qytetet ishin qendra ku zhvillohej zejtaria e tregtia.</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Qytetet mesjetare ishin qytete-kështjella, të rrethuara me mure dhe kanale.</li> <li>• Rreth mureve të qytetit ndërtoheshin vendbanime të reja dhe pas tyre ngriheshin ndërtesa të reja.</li> <li>• Qyteti rritej në formën e rrathëve.</li> <li>• Kishin arkitekturë të thjeshtë, me rrugë të ngushta.</li> <li>• Dalloheshin vetëm katedralet, kishat dhe shtëpitë e feudalëve dhe tregtarëve.</li> <li>• Çdo degë e zejtarisë kishte një rrugë të sajën;</li> <li>• Krijoheshin një ose disa tregje, si ai i mishit, drithit etj.</li> <li>• Mungesa e higjienës shkaktonte epidemi dhe sëmundje ngjitëse.</li> </ul>

Pas nëntemës së dytë, mësuesi/ja u kërkon nxënësve të japin parashikimet e tyre për nëntemën e tretë, "Lufta e qyteteve me feudalët".

<b>Nxënësit parashikojnë</b>	<b>Nxënësit mësojnë</b>
<ul style="list-style-type: none"> <li>• Luftërat mes qyteteve dhe feudalëve lindën për shkak të territoreve që zotëronin feudalët.</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Qytetet lindën në pronat e feudalëve dhe ishin nën sundimin e tyre. Populli i paguante feudalit shumë detyrime.</li> <li>• Rritja e detyrimeve nga feudalët sollën luftërat mes qyteteve dhe feudalëve për t'u çliruar prej tyre.</li> <li>• Në Itali, Francë e Holandë qytetet siguruan fitore të mëdha. Disa nga qytetet dolën si republika të pavarura, si Venediku, Verona, Piza, Milanoja etj.</li> <li>• Qytetet kishin stemën, flamurin dhe statutin e tyre.</li> <li>• Në shek. XIV-XV pushteti mbretëror filloi të forcohej duke bërë që vetëqeverisja e qyteteve të kufizohej.</li> <li>• Në ato vende ku nuk kishte pushtet mbretëror (Gjermani) qytetet fituan më shumë pavarësi.</li> </ul>

**Përforcimi:** Punë me tekstin / Minutat e debatit

Mësuesi/ja i udhëzon nxënësit të punojnë me pyetjet e rubrikës "Gjurmojmë-Mendojmë-Arsyetojmë-Nxjerrim përfundime" në tekst, për të provuar nivelin e njohurive të reja të nxënësve.

- *Ku dhe kur lindën qytetet e reja në Europë?*
- *Pse qytetet filluan luftën kundër feudalëve?*
- *Pse me forcimin e pushtetit mbretëror kufizohej vetëqeverisja e qyteteve?*

Pas pyetjeve, ai/ajo kalon në minutat e debatit. Shtron para nxënësve një pyetje, e konkretisht atë të ushtrimit 6 të tekstit, për të cilën diskutojnë dhe japin mendimin e tyre të gjithë.

- Si e kuptoni shprehjen: "Ajri i qytetit të bën të lirë"?

Në fund të diktimit, të gjithë vlerësojnë mendimin më të bukur dhe argumentues.

**Vlerësimi:**

Vlerësimi bëhet duke pasur parasysh pjesëmarrjen e nxënësve në orën e mësimit në të gjitha etapat e saj e duke i vënë në dukje rezultatet.

**Detyrë:**

Bëni një përshkrim të hollësishëm të figurës së paraqitur në rubrikën "Gjurmojmë-Mendojmë-Arsyetojmë-Nxjerrim përfundime", ushtrimi 7. Evidentoni tregun, shtëpitë, sheshin kryesor etj.

**Sqarime për zgjidhjen e ushtrimeve të rubrikës:  
Gjurmohmë-Mendojmë-Arsyetojnë-Nxjerrim përfundime**

**Ushtrimi 4.**

Mospagimi i detyrimit të qytetit ndaj feudalit në pronën e të cilit ishte ndërtuar qyteti. Krijimi i organeve drejtuese nga vetë qytetarët, me të cilët administrohej qyteti. Hartimi i Statutit që shërbente si “kushtetutë” e qytetit, i cili rregullonte të gjithë marrëdhëniet mes qytetarëve dhe të huajve.

**Ushtrimi 5.**

Mbretërit vendosen sundimin e tyre absolute dhe nuk kishin më nevojë për qytete, të cilat u përfshinë nën sundimin mbretëror . Ato i detyroheshin mbretërisë dhe u nënshtroheshin ligjeve të saj.

**Ushtrimi 6.**

Kjo do të thotë se banori i qytetit vlerësohej i lirë në kushtet e sistemit feudal.

**Ushtrimi 7.**

Shesh tregu. Në plan të parë janë sarafët, që bënin këmbimin e parave. Në të djathtë, një zonjë e pasur duke blerë, e shoqëruar me dy shërbyese. Mënyra e qarkullimit në qytete mesjetare ishte me këmbë, kuaj dhe karroca. Shohim dhe ushtarë që e shprehin praninë e shtetit në qytet; porta si pjesë ndërtimore e qytetit që shërbenin për hyrje e dalje nga tregu; stema që tregonin llojin e zanatit apo mallit që zhvillonte apo tregtonte dyqani etj.



Fusha:	Lënda: Histori	Shkalla: III	Klasa: 6
<b>Tematika 4:</b> <ul style="list-style-type: none"> <li>Zhvillimi i qytetërimeve mesjetare në shek. X - XII</li> </ul>	<b>Tema mësimore:</b> <ul style="list-style-type: none"> <li>Lindja e rajoneve dhe bankave</li> </ul>	<b>Situata e të nxënit:</b> <ul style="list-style-type: none"> <li>Nxënësit diskutojnë për lindjen dhe zhvillimin e qyteteve duke u ndalur tek roli i tyre si qendra zejtarie dhe tregtie.</li> </ul>	

**Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyç:****Kompetenca e të nxënit****Nxënësi:**

- ndërlidh temën e re ose një çështje të dhënë me njohuritë dhe përvojat paraprake, duke i paraqitur në forma të ndryshme të të shprehurit sipas një radhitjeje logjike;
- parashtron pyetje kërkimore dhe përgjigjet duke u bazuar në argumente dhe burime të sakta;
- zhvillon kompetencën e të nxënit për të shfrytëzuar të dhënat, për të demonstruar të kuptuarit e koncepteve historike dhe shoqërore, duke i shfaqur me forma të ndryshme të të shprehurit.

**Kompetenca e komunikimit dhe e të shprehurit****Nxënësi:**

- zhvillon kompetencën e komunikimit për të ndërtuar kompetencat historike për të shqyrtuar, për të analizuar, për të parashtruar pyetje, për të argumentuar, për të diskutuar dhe për të komunikuar informacionin historik, konceptet dhe idetë.

**Kompetenca e të menduarit****Nxënësi:**

- zhvillon kompetencën e të menduarit për realizimin e kërkimit historik;
- analizon të dhënat numerike për të kuptuar të shkuarën, për shembull, për të kuptuar shkaktues dhe pasojën, vazhdimësinë dhe ndryshimin;
- zhvillon mendimin krijues për të ndërtuar interpretime të reja, të cilat shpjegojnë aspekte të së shkuarës, që janë të diskutueshme;
- zhvillon mendimin kritik për të përzgjedhur burimet, për të interpretuar të shkuarën nëpërmjet informacionit, për të dhënë argumente bazuar në burime dhe për të saktësuar saktësinë e burimeve.

**Kompetenca personale****Nxënësi:**

- kupton nëpërmjet kërkimit historik përvojën e njeriut, marrëdhëniet shkak-pasojë, trashëgiminë kulturore, rëndësinë historike, ndryshimet dhe vazhdimësinë që ka pësuar shoqëria përgjatë kohërave.

**Kompetenca qytetare****Nxënësi:**

- kupton se si qytetërimet dhe shoqëritë janë formuar nga grupe njerëzish me kultura të ndryshme, identifikon dallimet dhe ngjashmëritë ndërmjet kulturave të ndryshme dhe kultivon respekt ndaj kulturave të ndryshme nga e tij;
- shqyrtton një sërë burimesh që paraqesin perspektiva të ndryshme kulturore, në mënyrë që të zhvillojë kuptimin historik.

**Kompetenca qytetare****Nxënësi**

- bashkëpunon, diskuton dhe debaton me të tjerët për të ndërtuar konceptet dhe kompetencat historike.


<p><b>Rezultatet e të nxënit të kompetencave sipas temës:</b>  <b>Nxënësi:</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• vlerëson rolin e tregtisë në zhvillimin e qytetit mesjetar;</li> <li>• përcakton strukturën shoqërore të Europës mesjetare;</li> <li>• krahason mënyrën e jetesës së shtresave të ndryshme shoqërore në Europën mesjetare;</li> <li>• evidenton tiparet e artit, kulturës, arsimit dhe besimit fetar në qytetet mesjetare.</li> </ul>	<p><b>Fjalë kyç:</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Rajon</li> <li>• Institucion</li> <li>• Panair</li> <li>• Bankier</li> <li>• Saraf</li> <li>• Heretik</li> </ul>
<p><b>Burimet:</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Teksti mësimor</li> <li>• e-libri</li> <li>• Harta e Europës mesjetare</li> <li>• Pamje e foto të ndryshme të qyteteve të Europës mesjetare dhe monedhave e parave të kësaj periudhe</li> <li>• Enciklopedi</li> </ul>	<p><b>Lidhja me fushat e tjera dhe me tema ndërkurrikulare:</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Gjeografi</li> <li>• Matematikë</li> </ul>

**Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve:**

**PNP:** Stuhi mendimesh - Të nxënit në bashkëpunim - Marrëdhënie pyetje-përgjigje dhe minuta e debatit

**Parashikimi:** Stuhi mendimesh

Mësuesi/ja e nis orën mësimore, duke i nxitur nxënësit të flasin për qytetet mesjetare, disa karakteristika të tyre, rolin e tyre si qendra zejtare e tregtare, për arkitekturën e tyre, tregjet, për rolin e parasë në shkëmbimin e mallrave, tregtinë që qytetet bënin me vendet e tjera më të largëta.



**Ndërtimi i njohurive:** Të nxënit në bashkëpunim Mësuesi/ja orienton nxënësit të lexojnë tekstin për disa minuta. Gjatë kohës që nxënësit lexojnë tekstin, ai/ajo shkruan në dërrasë të zezë: *“Tregtia, faktori kryesor i lindjes së rajoneve”*. Më pas, mësuesi/ja së bashku me nxënësit evidentojnë se në Europën Perëndimore tregtia njohu zhvillim të mëtejshëm, duke përfshirë rajonin e Mesdheut, Detit të Veriut dhe Detit Baltik. Rajonet lidheshin nëpërmjet rrugëve lumore dhe Alpeve. Me këto vende tregtoheshin mallra, si: druri, drithi, peshku, gëzofi, prodhime zejtarie, shajaku, metalet etj. Kjo tregon se tregtia nuk mbetej vetëm brenda qyteteve kryesore, por ishte kthyer tashmë në tregti ndërkombëtare.



Monedha të qyteteve të ndryshme mesjetare

Pas kësaj, mësuesi/ja shkruan në dërrasë të zezë: *“Paraja, monedha”*. Ai/ajo bën pyetjen:  
 - *Si shkëmbeheshin mallrat gjatë kësaj periudhe? Si qarkullonte paraja, po të kemi parasysh se ende nuk ishte ndërtuar tregu i parasë (blerja/shitja e monedhave të ndryshme)?*

Më pas, mësuesi/ja shtjellon se monedha ishte tregues i zhvillimit të qytetërimit dhe bazë e lindjes së institucioneve, që rregullonin veprimet me paranë. Sarafët ishin të parët që merreshin me monedhat që nxirrnin në qarkullim mbretër të ndryshëm. Ata përcaktonin cilësinë dhe vlerën e monedhave dhe i shkëmbejnë ato. Ata vendoseshin në tregje e panairë dhe me kalimin e kohës u kthyen në bankierë. Qyteti i Firences ishte qyteti i parë bankar, pasi në këtë qytet mblidheshin të ardhurat e Papatit dhe të shumë vendeve të tjera të Europës. Edhe hebrenjtë (ashtu si italianët) u bënë bankierë. Madje, ata u jepnin hua (borxhe me interes) mbretërve.

Në nëntemën "Arti, kultura, arsimit e feja", mësuesi/ja rikujton së bashku me nxënësit, se në Perandorinë Romake të Lindjes dhe në Perandorinë Bizantine arti, kultura dhe shkenca morën një hov të madh. Ai/ ajo u drejton pyetjen:

- *Çfarë i karakterizonte artin, kulturën dhe arsimin në qytetet mesjetare?*

Nxënësit, pasi kanë rilexuar tekstin, përgjigjen se arti, kultura dhe arsimit ishin nën ndikimin e plotë të kishës dhe të gjithë artistët krijonin objekte fetare. Këtu mësuesi/ja shton se Bibla ishte i vetmi libër që duhej lexuar dhe se librat jofetarë shpallehin të rrezikshëm dhe digjeshin në rast se zbuloheshin. Ata që lexonin libra të tjerë dhe kërkonin të mësonin Biblën shpallehin heretikë dhe digjeshin e dënoheshin në mënyrë të hapur. Mësuesi/ja shton se lindja e letërsisë popullore, poezitë e tregimet që lidheshin me jetën e njerëzve, ngjarje historike, heronj, shënoi fillimin e letërsisë kombëtare e laike.

Mësuesi/ja pyet:

- *Si ishte arkitektura në qytetet mesjetare?*



Ndërtesa mesjetare në formë kështjellash

Nxënësit përgjigjen se arkitektura në qytetet mesjetare ishte pothuaj njësoj për këto qytete, me mure rrethuese, kështjella, rrugë të ngushta, ndërtesa të ngritura pranë njëra-tjetrës e me qendra tregtare e zejtarie, ku katedralja ishte ndërtesa kryesore e qyteteve.

Mësuesi/ja shtron më pas, pyetjen që lidhet me arsimin dhe fenë.

- *Si arsimoheshin priftërinjtë dhe njerëzit e zakonshëm në mesjetë?*

Nxënësit përgjigjen se priftërinjtë arsimoheshin në shkollat fetare të hapura pranë kishave dhe manastireve dhe se zhvillimi i jetës qytetare evidentoi nevojën e lindjes së shkollave laike. U hapën shkolla fillore, të mesme dhe universitete.

**Përforcimi:** Marrëdhënie pyetje-përgjigje/Minutat e debatit

Mësuesi/ja shtron disa pyetje për të provuar nivelin e njohurive të reja të nxënësve.

- *Cilat ishin rajonet kryesore të tregtisë?*
- *Si lindën bankat dhe çfarë roli luanin ato?*
- *Cili ishte roli i fesë?*

Pas pyetjeve, ai/ajo kalon në minutat e debatit

- Pse bankat lindën më parë në qytetet italiane e kryesisht në Firenze?
- Pse artistë, piktorë, skulptorë e muzikantë u vunë në shërbim të kishës?

**Vlerësimi:**

Vlerësimi bëhet duke pasur parasysh pjesëmarrjen e nxënësve në orën e mësimit në të gjitha etapat e saj e duke i vënë në dukje rezultatet.

**Detyrë:**

Kërkoni në internet për historikun e universiteteve të para në Europë. Zgjidhni njërin prej tyre dhe bëni një përshkrim të shkurtër të krijimit të tij.

**Sqarime për zgjidhjen e ushtrimeve të rubrikës:  
Gjurmojmë-Mendojmë-Arsyetojnë-Nxjerrim përfundime**

**Ushtrimi 6.**

Feja përpiqej të ruante pozitën hegjemone në të gjitha fushat e jetës dhe vepronte me ashpërsi ndaj çdo shfaqjeje me karakter laik (jofetar).

**Ushtrimi 7.**

Sarafi punonte haptas në treg si një shitës ambulant me një tryezë ku bënte këmbimin e parave. Me krijimin e bankave, u krijua një institucion i veçantë financiar, me një ndërtesë të posaçme, brenda së cilës kryheshin shumë veprime financiare e këmbim parash. Në bankë punonin disa nëpunës (financierë) dhe veprohej me rregulla të caktuara.

**Ushtrimi 8.**

Këto shtete ishin në ballë të qendrës më të fuqishme të tregtisë botërore të asaj kohe, shek. X - IV, Detit Mesdhe. Ato ishin në kryqëzimin e rrugëve detare e tokësore ndërkontinentale.

Fusha:	Lënda: Histori	Shkalla: III	Klasa: 6
<b>Tematika 4:</b> <ul style="list-style-type: none"> <li>Zhvillimi i qytetërimeve mesjetare në shek. X - XII</li> </ul>	<b>Tema mësimore:</b> <ul style="list-style-type: none"> <li>Marrëdhëniet midis qytetërimit perëndimor dhe atij lindor</li> </ul>	<b>Situata e të nxënit:</b> <ul style="list-style-type: none"> <li>Mësuesi/ja diskuton me nxënësit rreth qytetërimit lindor e perëndimor duke bërë krahasim mes tyre.</li> </ul>	

**Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyç:****Kompetenca e të nxënit****Nxënësi:**

- zhvillon kompetencën e të nxënit për të shfrytëzuar të dhënat, për të demonstruar të kuptuarit e koncepteve historike dhe shoqërore, duke i shfaqur me mënyra të ndryshme të të shprehurit;
- ndërlidh temën e re ose një çështje të dhënë me njohuritë dhe përvojat paraprake, duke i paraqitur në forma të ndryshme të të shprehurit sipas një radhitjeje logjike;
- parashtron pyetje kërkimore dhe përgjigjet duke u bazuar në argumente dhe burime të sakta shkencore.

**Kompetenca e të menduarit****Nxënësi:**

- zhvillon kompetencën e të menduarit për realizimin e kërkimit historik;
- analizon të dhënat numerike për të kuptuar të shkuarën, për shembull për të kuptuar shkakun dhe pasojën, vazhdimësinë dhe ndryshimin;
- zhvillon mendimin krijues për të ndërtuar interpretime të reja, të cilat shpjegojnë aspekte të së shkuarës, që janë të diskutueshme;
- zhvillon mendimin kritik për të përzgjedhur burimet, për të interpretuar të shkuarën nëpërmjet informacionit, për të dhënë argumente bazuar në burime dhe për të saktësuar saktësinë e burimeve.

**Kompetenca e komunikimit dhe e të shprehurit****Nxënësi:**

- zhvillon kompetencën e komunikimit për të ndërtuar kompetencat historike, për të shqyrtuar, analizuar, për të parashtruar pyetje, për të argumentuar, për të diskutuar dhe për të komunikuar informacionin historik, konceptet dhe idetë.

**Kompetenca qytetare****Nxënësi:**

- kupton se si qytetërimet dhe shoqëritë janë formuar nga grupe njerëzish me kultura të ndryshme;
- identifikon dallimet dhe ngjashmëritë ndërmjet kulturave të ndryshme dhe kultivon respekt ndaj kulturave të ndryshme nga e tij;
- shqyrton një sërë burimesh që paraqesin perspektiva të ndryshme kulturore në mënyrë që të zhvillojë kuptimin historik.

**Kompetenca personale****Nxënësi:**

- kupton nëpërmjet kërkimit historik përvojën e njeriut, marrëdhëniet shkak-pasojë, trashëgiminë kulturore, rëndësinë historike, ndryshimet dhe vazhdimësinë që ka pësuar shoqëria përgjatë kohërave.

**Kompetenca qytetare****Nxënësi**

- bashkëpunon, diskuton dhe debaton me të tjerët për të ndërtuar konceptet dhe kompetencat historike.

<p><b>Rezultatet e të nxënit të kompetencave sipas temës:</b>  <b>Nxënësi:</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• përshkruan marrëdhëniet midis qytetërimit arab dhe atij europian;</li> <li>• përkufizon termin “kryqëzatë”;</li> <li>• shpjegon shkaqet e fillimit të kryqëzatave;</li> <li>• evidenton pasojat e kryqëzatave në marrëdhëniet mes dy qytetërimeve;</li> <li>• njeh dhe vlerëson disa nga figurat historike që i përkasin kësaj tematike, si Papa Urbani II, Salaudini, Dhimitri i Arbrit etj.</li> </ul>	<p><b>Fjalë kyç:</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Kryqëzatë</li> <li>• Kryqtarë</li> <li>• Lindje e Mesme</li> <li>• Palestinë</li> <li>• Papa Urbani</li> </ul>
<p><b>Burimet:</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Teksti mësimor</li> <li>• e-libri</li> <li>• Harta e Europës mesjetare</li> <li>• Materiale me pamje nga figura të shquara të kësaj periudhe, të kryqëzatave, kryqtarëve, shembuj të qytetërimit arab dhe perëndimor</li> <li>• Enciklopedi</li> </ul>	<p><b>Lidhja me fushat e tjera dhe me tema ndërkurrikulare:</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Gjeografi</li> </ul>

**Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve:**

**PNP:** Klaster - Ditari dypjesësh - Marrëdhënie pyetje-përgjigje

**Parashikimi:** Klaster

Mësuesi/ja u kërkon nxënësve të sjellin ndër mend të gjitha njohuritë që kanë për qytetërimin perëndimor dhe atë arab dhe shkruan në tabelë përgjigjet e tyre duke nxjerrë edhe të përbashkëtat e këtyre qytetërimeve.

**Ndërtimi i njohurive:** Ditari dypjesësh

Në këtë fazë të orës mësimore, mësuesi/ja përdor teknikën e *ditarit dypjesësh*. Ndërton në dërrasë të zezë tabelën (me çështjet dhe komentet) dhe u kërkon nxënësve të bëjnë të njëjtën gjë në fletoret e tyre, pasi të lexojnë tekstin të ndarë në nëntema.

<b>Çështja</b>	<b>Komenti</b>
<p>Dy qytetërimet dhe shkaku i kryqëzatave</p>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Gadishulli Iberik (Spanja e Portugalia) ishte vendi ku përplaseshin dy qytetërimet: ai arab me atë perëndimor.</li> <li>• Qytetërimi perëndimor po përpiquej të rimerrte veten pas shkatërrimit nga dyndjet barbare dhe u shkëput përfundimisht nga qytetërimi antik greko-romak. Kisha mbizotëronte çdo aspekt të jetës.</li> <li>• Qytetërimi lindor nuk kishte dëmtuar nga dyndja e popujve dhe nuk ishte shkëputur nga bota antike. Ai njohu lulëzim në shek. VIII-XIV. Librat e poetët antikë ishin përkthyer në arabisht dhe studioheshin prej tyre.</li> <li>• Dy qytetërimet ndryshonin nga mënyra e jetesës, veshja, ushqimi etj.</li> <li>• Në vitin 1077, turqit sulmuan Jerusalemin, ku ndodhej varri i Krishtit. Europa, e alarmuar nga rreziku i përhapjes së islamizmit, u organizua për t'i bërë qëndresë, nën udhëheqjen e Papa Urbani II. U ndërmorën disa fushata ushtarake drejt Lindjes, që u njohën me emrin <i>kryqëzata</i> dhe luftëtarët e tyre morën emrin <i>kryqtarë</i></li> </ul>



Pas përfundimit të nëntemës së parë, mësuesi/ja pyet nxënësit nëse kanë pyetje dhe u përgjigjet apo sqaron për ndonjë paqartësi që mund të kenë dhe vazhdon me nëntemën e dytë, që lidhet logjikisht me të parën.

Çështja	Komenti
Zhvillimi i kryqëzatave	<ul style="list-style-type: none"> <li>Kryqëzata e parë filloi në vitin 1096, me anët të cilës feudalët dhe tregtarët synonin të pushtonin qytete e territore në bregun lindor të Detit Mesdhe.</li> <li>Janë zhvilluar tetë kryqëzata, ku e fundit mori emrin "Kryqëzata e fëmijëve".</li> <li>Në Jerusalem kryqtarët krijuan një shtet të krishterë, por ai ishte i dobët dhe u pushtua nga myslimanët në vitin 1244. Europeanët nuk ia dolën ta rimerrnin Jerusalemin që prej atij viti.</li> <li>Dy figurat që u shquan në këto kryqëzata ishte Rikard Zemërлуani, Mbreti i Anglisë, për kryqtarët dhe Salaudini, Mbreti i Egjiptit, për myslimanët.</li> </ul>  <p>Pikturë: Kryqëzata e fëmijëve</p>

Mësuesi/ja shton më tej, se luftërat kanë gjithmonë pasoja. Edhe kryqëzatat lanë pasoja të mëdha në jetën shoqërore të asaj periudhe. Ai/ajo ndërton tabelën e teknikës së *ditarit dypjesësh* për të përfunduar nëntemën e tretë të mësimit.

Çështja	Komenti
Pasojat e kryqëzatave	<ul style="list-style-type: none"> <li>Të krishterët mësuan kulturën arabe dhe bizantine (arkitekturë, dije, shkencë).</li> <li>Ata sollën nga lindja kultura bujqësore, si: pambukun, orizin, limonin;</li> <li>Njohën për herë të parë qelqin, lojën e shahut, parfumin, sapunin, erëzat e gatimit etj.</li> <li>Tregtia shërbeu për zgjerimin e marrëdhënieve mes Perëndimit dhe Lindjes.</li> <li>Kultura e Lindjes nxiti ringjalljen e kulturës në Europë.</li> </ul>

**Përforcimi:** Marrëdhënie pyetje-përgjigje

Mësuesi/ja u drejton disa pyetje nxënësve, për të provuar nivelin e njohurive të reja të tyre.

- Ku ndryshonte qytetërimi arab nga ai perëndimor?
- Cilat ishin shkaqet e kryqëzatave?
- Pse themi se "kryqëzatat, megjithëse dështuan, patën pasoja pozitive për të gjithë Europën"?
- Cilat ishin dy nga figurat më kryesore të kryqëzatave?

**Vlerësimi:**

Vlerësimi bëhet duke pasur parasysh pjesëmarrjen e nxënësve në orën e mësimit në të gjitha etapat e saj e duke i vënë në dukje rezultatet.

**Detyrë:**

- Kërkoni në internet materiale për Rikard Zemërлуanin (Mbreti i Anglisë) dhe Salaudinin (Mbreti i Egjiptit). Bëni një përmbledhje të shkurtër, ku të vlerësoni kontributin dhe luftërat e tyre në kryqëzatat e krishtera.
- *Për orën pasardhëse:* Nxënësit ndahen në grupe për t'u orientuar për orën pasardhëse, që është një orë projekt me temë "Karakteristikat kryesore të qyteteve mesjetare në territoret arbërore". Nxënësit orientohen të kërkojnë informacione dhe të dhëna për disa nga karakteristikat të qyteteve arbërore më Shqipërinë mesjetare.

Fusha:	Lënda: Histori	Shkalla: III	Klasa: 6
<b>Tematika 4:</b> <ul style="list-style-type: none"> <li>Zhvillimi i qytetërimeve mesjetare në shek. X - XII</li> </ul>	<b>Tema mësimore:</b> <ul style="list-style-type: none"> <li><b>Karakteristikat kryesore të qyteteve mesjetare në territoret arbërore (situatë e sugjeruar)</b></li> </ul>	<b>Situata e të nxënit:</b> <ul style="list-style-type: none"> <li>Mësuesi/ja diskuton me nxënësit rreth njohurive për karakteristikat kryesore të qyteteve mesjetare.</li> </ul>	

#### **Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyç:**

##### ***Kompetenca e komunikimit dhe e të shprehurit***

###### **Nxënësi:**

- zhvillon kompetencën e komunikimit për të ndërtuar kompetencat historike, për të shqyrtuar, analizuar, për të parashtruar pyetje, për të argumentuar, për të diskutuar dhe për të komunikuar informacionin historik, konceptet dhe idetë.

##### ***Kompetenca e të menduarit***

###### **Nxënësi:**

- zhvillon kompetencën e të menduarit për realizimin e kërkimit historik;
- zhvillon mendimin kritik për të përzgjedhur burimet, për të interpretuar të shkuarën nëpërmjet informacionit, për të dhënë argumente bazuar në burime dhe për të saktësuar saktësinë e burimeve shkencore.

##### ***Kompetenca e të nxënit***

###### **Nxënësi:**

- zbaton në mënyrë të pavarur udhëzimet për një temë, veprim, aktivitet ose detyrë që i kërkohet;
- ndërlidh temën e re ose një çështje të dhënë me njohuritë dhe përvojat paraprake, duke i paraqitur në forma të ndryshme të të shprehurit sipas një radhitjeje logjike;
- vlerëson pikëpamjet e ndryshme, si dhe menaxhon emocionet, ndjenjat, kohën, shfrytëzimin e burimeve dhe mjeteve gjatë kryerjes së një detyre në histori;
- identifikon përparësitë dhe mangësitë e tij në lidhje me zotërimin e dijeve dhe kompetencave historike në funksion të përparimit dhe përmirësimit të suksesit të tyre.

##### ***Kompetenca për jetën, sipërmarrjen dhe mjedisin***

###### **Nxënësi:**

- harton hapat që duhet të ndjekë për realizimin e një kërkimi historik për një ngjarje të dhënë;
- zhvillon një kërkim individual ose në grup për kryerjen e një veprimtarie në histori;
- diskuton individualisht ose në grup për rëndësinë që ka e shkuara në kuptimin e të tashmes dhe perspektivat e të ardhmes.

##### ***Kompetenca personale***

###### **Nxënësi:**

- zhvillon kompetencën personale për të kuptuar veten dhe të tjerët, ndryshimet dhe ngjashmëritë, për të menaxhuar marrëdhëniet ndërmjet tyre, për të vlerësuar pikëpamjet e të tjerëve, qofshin këto dhe të ndryshme nga të tijat;
- kupton nëpërmjet kërkimit historik përvojën e njeriut, marrëdhëniet shkak-pasojë, trashëgiminë kulturore, rëndësinë historike, ndryshimet dhe vazhdimësinë që ka pësuar shoqëria përgjatë kohërave;
- përdor aftësitë e komunikimit, punës në grup etj., për të prezantuar dhe argumentuar idetë e tij.

##### ***Kompetenca qytetare***

###### **Nxënësi:**

- kupton nëpërmjet kërkimit historik përvojën e njeriut, marrëdhëniet shkak-pasojë, trashëgiminë kulturore, rëndësinë historike, ndryshimet dhe vazhdimësinë që ka pësuar shoqëria përgjatë kohërave;
- shpjegon origjinën dhe zhvillimin e identitetit kombëtar duke vlerësuar trashëgiminë material edhe shpirtërore;
- shqyrton një sërë burimesh që paraqesin perspektiva të ndryshme kulturore, në mënyrë që të zhvillojë kuptimin historik.



**Kompetenca digjitale**

**Nxënësi**

- zhvillon kompetencën digjitale për të kërkuar, përzgjedhur, analizuar dhe komunikuar informacion historik;
- përdor një sërë burimesh digjitale të informacionit dhe analizon në mënyrë kritike këto burime historike;
- komunikon, shfaq dhe parashtron njohuritë, aftësitë dhe qëndrimet;
- bashkëpunon, diskuton dhe debaton me të tjerët për të ndërtuar konceptet dhe kompetencat historike.

**Rezultatet e të nxëniet të kompetencave sipas temës:**

**Nxënësi:**

- rendit disa të dhëna për kulturën arbërore, si: gjuhën, simbolet shtetërore, monedhat, ndërtimet, veshjet, veglat e punës, armët etj.;
- përmend dhe përshkruan disa nga aspektet e zhvillimit të arsimit, letërsisë, artit dhe të fesë në mesjetë.

**Fjalë kyç:**

- Arbëri
- Qytet mesjetar
- Veshje
- Ndërtim
- Qytet kodrinor
- Qytet-kala

**Burimet:**

- Teksti mësimor
- e-libri
- Harta e Shqipërisë
- Materiale me pamje nga qytetet kryesore mesjetare të Shqipërisë
- Enciklopedi

**Lidhja me fushat e tjera dhe me tema ndërkurrikulare:**

- Gjeografi

**Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve:**

**PNP:** Bashkëbisedim - Lexim i orientuar - Prezantim i punimit

**Parashikimi.** Bashkëbisedim

Në fillim, mësuesja i nxit nxënësit të bashkëbisedojnë me njëri-tjetrin se çfarë dinë për qytetet arbërore, çfarë strukture kishin, si drejtoheshin, çfarë mënyre jetese etj.

mësuesi/ja shfaq një material që ka përgatitur paraprakisht për qytetet arbërore në antikitet dhe mesjetë, në të cilin evidentohen aspektet kryesore të jetës dhe zhvillimit të tyre.



Tivari



Shkodra

**Ndërtimi njohurive:** Lexim i orientuar

Mësuesi/ja ka udhëzuar paraprakisht nxënësit për informacionet dhe të dhëna që duhet të mbledhin për karakteristikat e qyteteve mesjetare arbërore. Pasi të kenë lexuar tekstin "Lexim i orientuar", nxënësit fillojnë të punojnë së bashku për të përgatitur punimet e tyre sipas udhëzimeve dhe ndarjeve në grupe pune që janë caktuar paraprakisht nga mësuesi/ja me detyrat përkatëse. Grupet ndahen sipas qyteteve në bazë të pozicionit gjeografik. Mësuesi/ja mund të përdorë ndarje të tjera, si qytete antike dhe mesjetare (Durrësi, Shkodra), qytete mesjetare (Vlora, Korça) apo qytete mesjetare fushore (Elbasani, Korça), qytete mesjetare kodrinore malore (Berati, Gjirokastra), e qytete mesjetare bregdetare (Durrësi, Vlora, Ulqini).

Grupi 1: Qytetet mesjetare veriore (Shkodër, Ulqin, Lezhë)  
Grupi 2: Qytetet mesjetare të mesme (Durrës, Elbasan, Korçë)  
Grupi 3: Qytetet mesjetare jugore (Berat, Vlorë, Gjirokastër)

Në këtë etapë nxënësit bashkëpunojnë dhe bashkërendojnë materialet që kanë grumbulluar dhe i përgatisin ato në formën e një ekspozite të vogël, me fletëpalosje, albume, punime në Power Point për qytetet mesjetare arbërore, simbolet, zhvillimin, qeverisjen, artin, kulturën, arsimin, jetesën, veshjet, ndërtimet etj.

**Përforcimi:** Prezantim i punimit

Në etapën e fundit, një përfaqësues i secilit grup prezanton punimin e grupit të tij/saj dhe në fund të orës diskutohet për punimet që paraqitën grupet dhe jepen edhe vlerësimet për punimet e grupeve. Nxënësit bëjnë vlerësimet e tyre për punën e secilit grup.

**Vlerësimi:**

Vlerësimi bëhet duke pasur parasysh:

- Informacionin më të plotë e më të saktë.
- Prezantimin më të mirë.
- Bashkëpunimin më të mirë në grup.
- Pjesëmarrjen dhe aktivizimin e nxënësve në orën e mësimin.
- Punën individuale.

**Detyrë:**

- Përgatisni një kënd ose album me pamje të qyteteve mesjetare arbërore, duke evidentuar simbolet, zhvillimin, qeverisjen, artin, kulturën, arsimin, jetesën, veshjet, ndërtimet etj.
- *Për orën pasardhëse:* Nxënësit njoftohen se orën e ardhshme ata do të vizitojnë kalanë më të afër me shkollën e tyre. Nxënësit orientohen të kërkojnë informacione dhe të dhëna kalatë shqiptare të ndërtuara në periudhën e mesjetës, ndërtimin dhe historikun e tyre, si dhe luftërat e betejat që janë zhvilluar në to.

Fusha:	Lënda: Histori	Shkalla: III	Klasa: 6
<b>Tematika 4:</b> <ul style="list-style-type: none"> <li>Zhvillimi i qytetërimeve mesjetare në shek. X - XII</li> </ul>	<b>Tema mësimore:</b> <ul style="list-style-type: none"> <li><b>Kalatë mesjetare shqiptare (situatë e sugjeruar, 2 orë)</b></li> </ul>	<b>Situata e të nxënit:</b> <ul style="list-style-type: none"> <li>Mësuesi/ja dhe nxënësit diskutojnë për qytetet shqiptare me kala të ndërtuara në periudhën e mesjetës.</li> </ul>	

**Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyç:****Kompetenca e komunikimit dhe e të shprehurit****Nxënësi:**

- zhvillon kompetencën e komunikimit për të ndërtuar kompetencat historike, për të shqyrtuar, analizuar, për të parashtruar pyetje, për të argumentuar, për të diskutuar dhe për të komunikuar informacionin historik, konceptet dhe idetë.

**Kompetenca e të menduarit****Nxënësi:**

- zhvillon kompetencën e të menduarit për realizimin e kërkimit historik;
- zhvillon mendimin kritik për të përzgjedhur burimet, për të interpretuar të shkuarën nëpërmjet informacionit, për të dhënë argumente bazuar në burime dhe për të saktësuar saktësinë e burimeve.

**Kompetenca e të nxënit****Nxënësi:**

- zbaton në mënyrë të pavarur udhëzimet për një temë, veprim, aktivitet ose detyrë që i kërkohet;
- ndërlidh temën e re ose një çështje të dhënë me njohuritë dhe përvojat paraprake, duke i paraqitur në forma të ndryshme të të shprehurit sipas një radhitjeje logjike;
- vlerëson pikëpamjet e ndryshme, si dhe menaxhon emocionet, ndjenjat, kohën, shfrytëzimin e burimeve dhe mjeteve gjatë kryerjes së një detyre në histori;
- identifikon përparësitë dhe mangësitë e tij në lidhje me zotërimin e dijeve dhe kompetencave historike në funksion të përparimit dhe përmirësimit të suksesit të tyre.

**Kompetenca për jetën, sipërmarrjen dhe mjedisin****Nxënësi:**

- harton hapat që duhet të ndjekë për realizimin e një kërkimi historik për një ngjarje të dhënë;
- zhvillon një kërkim individual ose në grup për kryerjen e një veprimtarie në histori;
- diskuton individualisht ose në grup për rëndësinë që ka e shkuara në kuptimin e të tashmes dhe perspektivat e të ardhmes.

**Kompetenca personale****Nxënësi:**

- zhvillon kompetencën personale për të kuptuar veten dhe të tjerët, ndryshimet dhe ngjashmëritë, për të menaxhuar marrëdhëniet ndërmjet njëri-tjetrit, për të vlerësuar pikëpamjet e të tjerëve, qofshin këto dhe të ndryshme nga të tija;
- kupton nëpërmjet kërkimit historik përvojën e njeriut, marrëdhëniet shkak-pasojë, trashëgiminë kulturore, rëndësinë historike, ndryshimet dhe vazhdimësinë që ka pësuar shoqëria përgjatë kohërave;
- përdor aftësitë e komunikimit, punës në grup etj., për të prezantuar dhe argumentuar idetë e tij.

### **Kompetenca qytetare**

#### **Nxënësi:**

- përdor aftësitë e komunikimit, punës në grup etj., për të prezantuar dhe argumentuar idetë e tij.
- kupton nëpërmjet kërkimit historik përvojën e njeriut, marrëdhëniet shkak-pasojë, trashëgiminë kulturore, rëndësinë historike, ndryshimet dhe vazhdimësinë që ka pësuar shoqëria përgjatë kohërave;
- shpjegon origjinën dhe zhvillimin e identitetit kombëtar duke vlerësuar trashëgiminë material edhe shpirtërore;
- shqyrton një sërë burimesh që paraqesin perspektiva të ndryshme kulturore, në mënyrë që të zhvillojë kuptimin historik.

### **Kompetenca digjitale**

#### **Nxënësi**

- zhvillon kompetencën digjitale për të kërkuar, përzgjedhur, analizuar dhe komunikuar informacion historik;
- përdor një sërë burimesh digjitale të informacionit dhe analizon në mënyrë kritike këto burime historike;
- komunikon, prezanton dhe parashtron njohuritë, aftësitë dhe qëndrimet;
- bashkëpunon, diskuton dhe debaton me të tjerët për të ndërtuar konceptet dhe kompetencat historike.

<b>Rezultatet e të nxënësve të kompetencave sipas temës:</b> <b>Nxënësi:</b> <ul style="list-style-type: none"><li>• paraqet fakte historike lidhur me kalatë shqiptare;</li><li>• portretizon kalatë më të shquara shqiptare;</li><li>• analizon rëndësinë e kalave në përballjet e pushtimeve të ndryshme në qytetet shqiptare;</li><li>• krijon një fletëpalosje për një kala shqiptare.</li></ul>	<b>Fjalë kyç:</b> <ul style="list-style-type: none"><li>• Kala mesjetare</li><li>• Qytet-kala</li><li>• Mur rrethues</li><li>• Pushtim</li></ul>
<b>Burimet:</b> <ul style="list-style-type: none"><li>• Teksti mësimor</li><li>• e-libri</li><li>• Harta e Shqipërisë</li><li>• Materiale fotografike dhe/ose filmike nga kalatë shqiptare, materiale dhe botime të ndryshme për kalatë shqiptare</li><li>• Enciklopedi</li></ul>	<b>Lidhja me fushat e tjera dhe me tema ndërkurrikulare:</b> <ul style="list-style-type: none"><li>• Gjeografi</li><li>• Art pamor</li></ul>

### **Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve:**

**PNP:** Bashkëbisedim - Lexim i orientuar - Prezantim i punimit

Në këtë projekt 2-orësh, mësuesi/ja ka dhënë udhëzimet përkatëse paraprakisht. Ai/ajo bashkëbisedon me nxënësit për qytetet mesjetare shqiptare, karakteristikat e tyre, ndërtesat, zhvillimin ekonomik e kulturor të tyre. Nxënësit evidentojnë disa nga këto qytete dhe përgatiten për të folur për kalatë e tyre.

#### **Ora I: Vizitë në kalanë më të afërt.**

Mësuesi/ja ka udhëzuar paraprakisht nxënësit, se këtë orë ata do të vizitojnë kalanë më të afërt me shkollën e tyre. Gjatë vizitës, ato njihen nga afër me kalanë, veçoritë e saj, llojin (fushore, kodrinore,

malore), elementet mbrojtëse të kalasë (muret rrethuese, kanalet përreth etj.), mjediset e brendshme, dhomat, banjat etj. Disa nga kalatë që sugjerohen janë:

1. *Kalatë e Shqipërisë së Veriut*: kalaja e Rozafës në Shkodër, kalaja e Lezhës, kalaja e Grezhdanit dhe Seltushit në Dibër etj.

2: *Kalatë e Shqipërisë së Mesme*: kalaja e Petrelës dhe Prezës në Tiranë, kalaja e Krujës, kalaja e Durrësit, kalaja e Elbasanit, kalaja e Skënderbeut në Kepin e Rodonit etj.

3: *Kalatë e Shqipërisë së Jugut*: kalaja e Beratit, kalaja e Kaninës dhe e Porto Palermos në Vlorë, kalaja e Himarës, kalaja e Tepelenës, kalaja e Gjirokastrës, kalaja e Lëkurësit në Sarandë, kalaja e Vivarit në Butrint etj.

Gjatë kohës që vizitojnë kalanë, nxënësit bashkëbisedojnë me mësuesin/en dhe njëri-tjetrin për të gjitha tiparet dhe veçoritë e kalasë. Mund të pyesin për gjëra që iu ngjallin kureshtje, që duan të mësojnë më shumë dhe japin përshtypjet e tyre për gjërat që iu bënë më shumë përshtypje.

Të gjitha informacionet që ata marrin për kalanë që vizojnë, i shënojnë në fletoren e tyre, si p.sh.: kur është ndërtuar kjo kala, kush ka banuar në të, cilat janë elementet tipike të ndërtimit të saj, cili ka qenë funksioni i saj etj.

***Ora II: Përgatitja e një posteri, ekspozite apo fletëpalosje për kalatë shqiptare***

Në këtë orë të dytë, pasi janë ndarë në grupe, nxënësit në bashkëpunim me ata të grupeve të tjera, zgjedhin tematikën e posterit, fletëpalosjes a ekspozitës që do të zhvillojnë, si p.sh.: ndërtimi dhe historiku e tyre, për luftërat e betejat që janë zhvilluar në to etj.

Pasi përcaktojnë pikat kryesore se ku do të mbështeten për kërkimin e të dhënave për kalanë që kanë përzgjedhur, ata ndajnë punën mes anëtarëve të grupit.

Më pas bashkërendojnë materialet që kanë grumbulluar dhe me to përgatisin posterin, fletëpalosjen a ekspozitën për kalatë mesjetare shqiptare,

Në etapën e fundit, një përfaqësues i secilit grup prezanton punimin e grupit të tij/saj dhe në fund të orës diskutohet për punimet që paraqitën grupet dhe jepen edhe vlerësimet.

Nxënësit bëjnë vlerësimet e tyre për punën e secilit grup.

**Detyrë:**

Përgatisni një album me pamje të kalave mesjetare shqiptare. Zgjidhni në klasë albumin me fotot dhe pamjet me të bukura nga kalatë shqiptare.

Fusha:	Lënda: Histori	Shkalla: III	Klasa: 6
<b>Tematika 4:</b>	<b>Tema mësimore:</b>	<b>Situata e të nxënit:</b>	
<ul style="list-style-type: none"> <li>Zhvillimi i qytetërimeve mesjetare në shek. X-XII</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li><b>Përsëritje</b></li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>Nxënësit dhe mësuesi/ja diskutojnë dhe risjellin në vëmendje çështjet dhe konceptet kryesore të të gjithë tematikës 4.</li> </ul>	

### **Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyç:**

#### ***Kompetenca e komunikimit dhe e të shprehurit***

##### **Nxënësi:**

- zhvillon kompetencën e komunikimit për të ndërtuar kompetencat historike, për të shqyrtuar, analizuar, për të parashtruar pyetje, për të argumentuar, për të diskutuar dhe për të komunikuar informacionin historik, konceptet dhe idetë;
- përdor funksionet gjuhësore të teksteve historike, duke përfshirë fjalorin historik, fjali të ndërtuara saktë për përshkrimin e ngjarjeve, fjali komplekse për shpjegimin e marrëdhënieve shkak-pasojë, përdorimin e gjerë të emrave, ndajfoljeve dhe mbiemrave për të përshkruar vendet, njerëzit dhe ngjarjet.

#### ***Kompetenca e të menduarit***

##### **Nxënësi:**

- zhvillon mendimin krijues për të ndërtuar interpretime të reja, të cilat shpjegojnë aspekte të së shkuarës, që janë të diskutueshme.

#### ***Kompetenca e të nxënit***

##### **Nxënësi:**

- zhvillon kompetencën e të nxënit për të shfrytëzuar të dhënat, për të demonstruar të kuptuarit e koncepteve historike dhe shoqërore, duke i prezantuar nëpërmjet formave të ndryshme të të shprehurit;
- vlerëson pikëpamjet e ndryshme, si dhe menaxhon emocionet, ndjenjat, kohën, shfrytëzimin e burimeve dhe mjeteve gjatë kryerjes së një detyre në histori;
- parashtron pyetje kërkimore dhe përgjigjet duke u bazuar në argumente dhe burime;
- identifikon përparësitë dhe mangësitë e tij në lidhje me zotërimin e dijeve dhe kompetencave historike në funksion të përparimit dhe përmirësimit të suksesit të tyre.

#### ***Kompetenca për jetën, sipërmarrjen dhe mjedisin***

##### **Nxënësi:**

- diskuton individualisht ose në grup për rëndësinë që ka e shkuara në kuptimin e të tashmes dhe perspektivat e të ardhmes;
- bashkëvepron në mënyrë aktive me moshatarët dhe të tjerët (pavarësisht statusit të tyre social, etnik etj.), për realizimin e një veprimtarie të përbashkët.

#### ***Kompetenca personale***

##### **Nxënësi:**

- zhvillon kompetencën personale për të kuptuar veten dhe të tjerët, ndryshimet dhe ngjashmëritë, për të menaxhuar marrëdhëniet ndërmjet njëri-tjetrit, për të vlerësuar pikëpamjet e të tjerëve, qofshin këto dhe të ndryshme nga të tija;
- kupton nëpërmjet kërkimit historik përvojën e njeriut, marrëdhëniet shkak-pasojë, trashëgiminë kulturore, rëndësinë historike, ndryshimet dhe vazhdimësinë që ka pësuar shoqëria përgjatë kohërave;
- përdor aftësitë e komunikimit, punës në grup etj., për të prezantuar dhe argumentuar idetë e tij.

#### ***Kompetenca qytetare***

##### **Nxënësi:**

- zhvillon kompetencën qytetare për të shqyrtuar në mënyrë kritike sjelljet, motivet dhe veprimet

e njerëzve në të shkuarën, që mund të jenë rezultat i ndryshimit të qëndrimeve shoqërore dhe standardeve të ndryshme;

- shqyrton burimet historike për të kuptuar ngjarjet dhe zhvillimet që kanë ndikuar në shoqëri dhe grupe të ndryshme kulturore në kohëra të ndryshme, si dhe shpjegon natyrën, shkaqet dhe pasojat e konflikteve dhe ndërvarësinë kulturore;
- kupton se si qytetërimet dhe shoqëritë janë formuar nga grupe njerëzish me kultura të ndryshme, identifikon dallimet dhe ngjashmëritë ndërmjet kulturave të ndryshme dhe kultivon respekt ndaj kulturave të ndryshme nga e tij.
- përdor aftësitë e komunikimit, punës në grup etj.. për të shfaqur dhe argumentuar idetë e tij.
- kupton nëpërmjet kërkimit historik përvojën e njeriut, marrëdhëniet shkak-pasojë, trashëgiminë kulturore, rëndësinë historike, ndryshimet dhe vazhdimësinë që ka pësuar shoqëria përgjatë kohërave;
- shqyrton një sërë burimesh që paraqesin perspektiva të ndryshme kulturore në mënyrë që të zhvillojë kuptimin historik.

### **Kompetenca digjitale**

#### **Nxënësi**

- zhvillon kompetencën digjitale për të kërkuar, përzgjedhur, analizuar dhe komunikuar informacion historik;
- përdor një sërë burimesh digjitale të informacionit dhe analizon në mënyrë kritike këto burime historike;
- komunikon, prezanton dhe parashton njohuritë, aftësitë dhe qëndrimet;
- bashkëpunon, diskuton dhe debaton me të tjerët për të ndërtuar konceptet dhe kompetencat historike.

<p><b>Rezultatet e të nxënit të kompetencave sipas temës:</b></p> <p><b>Nxënësi:</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• vlerëson trashëgiminë e qytetërimeve mesjetare;</li> <li>• rikujton njohuritë e fituara për zhvillimin e qyteteve mesjetare në shek. X-XII.</li> </ul>	<p><b>Fjalë kyç:</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Qytetërim mesjetar</li> <li>• Sistem feudal</li> <li>• Feudalizëm</li> <li>• Kryqëzatë</li> </ul>
<p><b>Burimet:</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Teksti mësimor</li> <li>• e-libri</li> <li>• Harta e Evropës mesjetare</li> </ul>	<p><b>Lidhja me fushat e tjera dhe me tema ndërkurrikulare:</b></p>

### **Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve:**


**PNP:** Marrëdhënie pyetje-përgjigje, klaster - Diagrami i Venit, analizë - Minutat e debatit

**Parashikimi:** Marrëdhënie pyetje-përgjigje, klaster

Kjo orë mund të zhvillohet edhe si konkurs, duke e ndarë klasën në grupe.

Mësuesi/ja planifikon përdorimin e një sërë metodash, me qëllim aktivizimin dhe vlerësimin e sa më shumë nxënësve. Disa nga metodat që mund të përdoren janë:

Në fillim shkruan në dërrasë termat:





U kërkon nxënësve të evidentojnë arsyet e lidhjes së Karlit me kishën.

- Si i zgjeroi Karli pronat dhe çfarë kushtesh u vuri pronarëve: kalorësve, baronëve, kontëve, dukëve?

Mësuesi/ja bën skemën e vasalitetit në dërrasë dhe kërkon nga nxënësit të analizojnë hierarkinë feudale. Më pas, ai/ajo shtron pyetjen:

- Cilat ishin tiparet e sistemit feudal?


Ai/ajo shkruan termin “bujkrob” në një rreth në dërrasë dhe kërkon nga nxënësit ta plotësojnë klasterin, duke analizuar bujkrobin, punët detyrimet etj.



Feudali dhe bujkrobërit

**Ndërtimi i njohurive:** Diagrami i Venit, analizë

Pasi ka marrë përgjigjet e nxënësve dhe pasi të jetë plotësuar klasteri, mësuesi/ja shkruan në dërrasë fjalët “skllav” dhe “bujkrob” dhe u kërkon nxënësve të evidentojnë të përbashkëtat dhe dallimet mes këtyre dy termave, duke përdorur diagramin e Venit.



**Analizë:** Feudalizmi

Pas plotësimit të diagramit të Venit, mësuesi/ja drejton pyetjen për të nxitur një diskutim mes nxënësve.

- A zbatoheshin në feudalizëm të drejtat e njeriut?

Ai/ajo u kërkon nxënësve të krahasojnë:

- a. Detyrimin në natyrë
- b. Rentën në të holla

Pas krahasimit të dy detyrimeve, mësuesi/ja drejton pyetjet:


- Kush e shkatërroi qytetërimin e hershëm antik?
- Çfarë solli ndarja e zejtarisë nga bujqësia?
- Kur lindën qytetet e reja në Europë?

Pas marrjes së përgjigjeve nga nxënësit dhe plotësimeve përkatëse në rast se ka, mësuesi/ja u kërkon nxënësve të bëjnë një udhëtim imagjinar në qytetin mesjetar dhe ta përshkruajnë atë me të gjitha elementet e tij. Ai/ajo i fton nxënësit të rikujtojnë edhe filmat që kanë parë me ngjarje të zhvilluara në qytetet mesjetare apo figurat në faqet 50-51 të tekstit të nxënësit.

Pas përshkrimeve të bëra nga nxënësit për qytetet mesjetare, mësuesi/ja shtron pyetjet:

- Ç'të reja i solli lindja dhe rritja e qyteteve zhvillimit ekonomik, shoqëror, administrativ dhe tregtar?
- Kur tregtia hyri në një fazë të re, cilat ishin rajonet tregtare mes Lindjes dhe Perëndimit?

Mësuesi/ja u kërkon nxënësve të analizojnë kalimin nga sarafi në bankier.





**Përforcimi:** Minutat e debatit

Në minutën e debatit, mësuesi/ja u shtron nxënësve pyetjen e mëposhtme dhe u kërkon atyre të shprehin mendimet e tyre:

- *Pse bankat e para lindën kryesisht në Firenze?*

Për të trajtuar edhe temën e kulturës, arsimit dhe artit në mesjetë, mësuesi/ja drejton pyetjen:

- *Ç'rol luajti kisha në zhvillimin e artit, kulturës dhe arsimit në shek. XI-XIV?*

Një nga çështjet më të rëndësishme në periudhën e mesjetës janë edhe kryqëzatat. Kjo temë trajtohet nga mësuesi/ja me teknikën e *pemës së mendjes*, ku mësuesi/ja shkruan në dërrasë termin "kryqëzatat" dhe "pasojat" dhe u drejton këto pyetje nxënësve për të ndërtuar *pemën e mendjes* në lidhje me këtë çështje:

- *Pse kryqëzatat u organizuan nga kisha?*
- *Kush mori pjesë në to?*
- *Cilat ishin pasojat pozitive të kryqëzatave dhe pse dështuan ato?*

Kryqëzata:	Pasojat

**Vlerësimi:**

Në fund të orës së përsëritjes, mësuesi/ja bën analizën e mbarëvajtjes së orës dhe vlerëson nxënësit duke u mbështetur në:

- Informacionin më të plotë e më të saktë.
- Shpejtësinë e përgjigjeve.
- Pjesëmarrjen dhe aktivizimin e nxënësve në këtë orë përsëritjeje ose konkurs.
- Orijentalitetin në përshkrimet dhe përgjigjet e nxënësve.

## Tematika 5. Tiparet e sistemeve politike evropiane shekujt XII – XV

**Përshkrimi i tematikës:** Përmes kësaj tematike, nxënësit demonstrojnë njohuri, aftësi/shkathtësi, qëndrime dhe vlera mbi procesin e lindjes së shtet-kombeve: nga copëtimi feudal te mbretëritë e përqendruara, veçoritë e këtij procesi në Europën perëndimore. Kjo tematikë trajton Mbretërinë e Anglisë, atdheun e parlamentarizmit; kalimin nga monarkia absolute në atë kushtetuese: marrëdhëniet midis mbretërve dhe princërve në Angli; lindjen e parlamentarizmit në Angli dhe ndikimin e tij në zhvillimet e mëvonshme historike. Nëpërmjet kësaj tematike, nxënësit kuptojnë rëndësinë që pati Karta e Madhe e Lirive si fillesë historike e demokracisë parlamentare. Tematika zhvillon modelin klasik të monarkisë absolute në Francë, copëtimin feudal të saj, hapat e forcimit të monarkisë franceze, karakterin e absolutizmit francez. Nëpërmjet kësaj tematike, nxënësit aftësohen edhe për organizimin politik ekonomik dhe shoqëror të Perandorisë Osmane, zhvillimin e arsimit, artit, kulturës, shkencës në mesjetë. Kjo tematikë sugjerohet të zhvillohet në 8 orë mësimore. Për tematikën e dhënë më poshtë janë parashikuar dhe veprimtari/projekte, të cilat jepen në rubrikën “Situata të sugjeruara”. Këto orë veprimtarish/projektesh mësuesi dhe autori i tekstit i integron brenda orëve të tematikës. Tematika së bashku me veprimtaritë/projektet realizojnë kompetencat lëndore dhe kompetencat kyç për të nxënësit gjatë gjithë jetës.

1

Fusha:	Lënda: Histori	Shkalla: III	Klasa: 6
<b>Tematika 5:</b> <ul style="list-style-type: none"> <li>Tiparet e sistemeve politike evropiane shekujt XII - XV</li> </ul>	<b>Tema mësimore:</b> <p>1. Fillesat e shtet-kombeve</p>	<b>Situata e të nxënësit:</b> <ul style="list-style-type: none"> <li>Mësuesi/ja dhe nxënësit diskutojnë për qytetet mesjetare, monarkinë absolute dhe tiparet e tyre.</li> </ul>	

### Rezultatet e të nxënësit sipas kompetencave kyç:

#### **Kompetenca e të nxënësit**

##### **Nxënësi:**

- zhvillon kompetencën e të nxënësit për të shfrytëzuar të dhënat, për të demonstruar të kuptuarit e koncepteve historike dhe shoqërore, duke i shprehur me mënyra të ndryshme të të shprehurit;
- ndërlidh temën e re ose një çështje të dhënë me njohuritë dhe përvojat paraprake, duke i paraqitur në formë të ndryshme të të shprehurit sipas një radhitjeje logjike;
- parashtron pyetje kërkimore dhe përgjigjet duke u bazuar në argumente dhe burime.

#### **Kompetenca e komunikimit dhe e të shprehurit**

##### **Nxënësi:**

- zhvillon kompetencën e komunikimit për të ndërtuar kompetencat historike për të shqyrtuar, analizuar, për të parashtruar pyetje, për të argumentuar, për të diskutuar dhe për të komunikuar informacionin historik, konceptet dhe idetë.

#### **Kompetenca e të menduarit**

##### **Nxënësi:**

- analizon të dhënat numerike për të kuptuar të shkuarën, për shembull për të kuptuar shkakun dhe pasojën, vazhdimësinë dhe ndryshimin;
- zhvillon mendimin krijues për të ndërtuar interpretime të reja, të cilat shpjegojnë aspekte të së shkuarës, që janë të diskutueshme;
- zhvillon mendimin kritik për të përzgjedhur burimet, për të interpretuar të shkuarën nëpërmjet informacionit, për të dhënë argumente bazuar në burime dhe për të vërtetuar saktësinë e burimeve të informacionit.

**Kompetenca personale**

**Nxënësi:**

- kupton nëpërmjet kërkimit historik përvojën e njeriut, marrëdhëniet shkak-pasojë, trashëgiminë kulturore, rëndësinë historike, ndryshimet dhe vazhdimësinë që ka pësuar shoqëria përgjatë kohërave.

**Kompetenca qytetare**

**Nxënësi:**

- kupton se si qytetërimet dhe shoqëritë janë formuar nga grupe njerëzish me kultura të ndryshme;
- identifikon dallimet dhe ngjashmëritë ndërmjet kulturave të ndryshme dhe kultivon respekt ndaj kulturave të ndryshme nga e tij;
- zhvillon mirëkuptimin ndërkulturor, duke vlerësuar kulturat, gjuhët dhe besimet e ndryshme;
- kupton perspektivat, besimet dhe qëndrimet e njerëzve në të shkuarën e në të tashmen dhe rëndësinë e njohjes së historisë së tyre dhe të tjerëve;
- shqyrton një sërë burimesh që paraqesin perspektiva të ndryshme kulturore në mënyrë që të zhvillojë kuptimin historik.


<p><b>Rezultatet e të nxënit të kompetencave sipas temës:</b></p> <p><b>Nxënësi:</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• përkufizon konceptin <i>shtet-komb</i>;</li> <li>• tregon shtet-kombet në hartën e Europës mesjetare;</li> <li>• përshkruan procesin e kalimit nga copëtimi feudal në shtet-kombe;</li> <li>• dallon veçoritë e procesit të krijimit të shtet-kombeve në Europën Perëndimore;</li> <li>• përshkruan karakteristikat e sistemit politik të Europës Perëndimore, duke evidentuar forcimin e pushtetit mbretëror.</li> </ul>	<p><b>Fjalë kyç:</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Shtet-komb</li> <li>• Monarki absolute</li> <li>• Copëtim</li> <li>• Mesjetë</li> </ul>
<p><b>Burimet:</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Teksti mësimor</li> <li>• e-libri</li> <li>• Harta e Evropës mesjetare</li> <li>• Imazhe e foto të ndryshme që i përkasin Evropës mesjetare</li> <li>• Enciklopedi</li> <li>• Materiale nga interneti</li> </ul>	<p><b>Lidhja me fushat e tjera dhe me tema ndërkurrikulare:</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Gjeografi</li> </ul>

**Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve:**

**PNP:** Diskutim - Di-dua të di-mësora - Marrëdhënie pyetje-përgjigje

**Parashikimi:** Diskutim

Mësuesi/ja e njeh nxënësit me temën e re dhe u kërkon të diskutojnë rreth tipareve të qyteteve mesjetare, vetadministrimin e tyre, pushteti i mbretit dhe forcimi i tij, luftërat mes feudalëve për territore. Ai/ajo evidenton disa nga përgjigjet e nxënësve, veçanërisht ato që lidhen me temën e re.



**Ndërtimi i njohurive:** Di-dua të di-mësova

Mësuesi/ja me anë të teknikës së ndërtimit të njohurive, ndërton një tabelë me tri shtylla dhe e plotëson si më poshtë. Ai/ajo shkruan në tabelë titullin e nëntemës së parë: “Nga copëtimi në unitet”.

<i>Dua</i>	<i>Di</i>	<i>Mësova</i>
<ul style="list-style-type: none"> <li>Në shek. V-VIII, Europa ishte e copëtuar dhe e përçarë.</li> <li>Qytetet ishin në luftë me feudalët.</li> <li>Në disa qytete pushteti mbretëror ishte i fortë, kurse në disa të tjera, që triumfuan ndaj feudalëve, u shpallën republikat.</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>Mënyra e bashkimit të territoreve</li> <li>Zhdukja e copëzimit feudal dhe krijimi i një shteti të bashkuar.</li> <li>Vendosja e autoritetit të mbretit në të gjithë territorin.</li> <li>Kushtet për krijimin e shtet-kombeve.</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>Luftërat e kalorësve për territore dhe pushtet shkaktuan anarki dhe pasiguri; disa u dobësuan e disa u fuqizuan dhe u bënë feudalë të mëdhenj.</li> <li>Mungonte qeverisja qendrore.</li> <li>Pushteti i mbretit ishte i dobët.</li> <li>Të pakënaqurit nga anarkia: fshatarët, qytetarët, kleri kërkonin fuqizimin e pushtetit mbretëror.</li> <li>Me ndihmën e tyre, mbreti forcoi ushtrinë dhe bashkoi territoret, duke vendosur kështu autoritetin e tij në të gjithë territorin.</li> <li>Në këtë mënyrë u krijua në shtet unik në shek. XIII-XIV.</li> </ul>

Më pas, mësuesi/ja kalon në nëntemën e dytë e të tretë, “Fillesa e shtet-kombeve” dhe “Përhapja dhe organizmi i mbretërive”. Ai/ajo vazhdon me tabelën, duke lënë të pandryshuar shtyllat “Di” dhe “Dua të di” dhe duke plotësuar shtyllën “Mësova”

<i>Dua</i>	<i>Di</i>	<i>Mësova</i>
<ul style="list-style-type: none"> <li>Copëtimi feudal ekzistonte;</li> <li>qytetet ishin në luftë me feudalët;</li> <li>Në disa qytete pushteti mbretëror ishte i fortë</li> <li>Në disa të tjera, që triumfuan ndaj feudalëve u shpallën republikat</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>Mënyra e bashkimit të territoreve</li> <li>Zhdukja e copëzimit feudal dhe krijimi i një shteti të bashkuar.</li> <li>Vendosja e autoritetit të mbretit në të gjithë territorin.</li> <li>Kushtet për krijimin e shtet-kombeve.</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>Brenda mbretërive të bashkuara kishte unitet të brendshëm.</li> <li>Mbreti ishte zotëruer i pushtetit qendror dhe respektohej nga të gjithë; fisnikët ishin pjesë e oborrit të tij.</li> <li>Mbretëritë në Europë sollën bashkimin e popullsisë që flisnin gjuhë të përbashkët e që kishin të njëjtin besim. Këto ishin elementet e para të lindjes së kombit. Kjo periudhë (shek. XIII-XIV) njihet si fillimi i formimit të shtet-kombeve.</li> <li>Veçoritë e shtet-kombeve:             <ul style="list-style-type: none"> <li>Shteti kishte kufi shtetëror e doganor, stemën e flamurin, kryeqendrën.</li> <li>Shteti kishte legjislacionin, sistemin gjyqësor dhe të taksave, masa e pesha të njëjta, monedhë të njëjtë e të përbashkët.</li> <li>Kishte një gjuhë të përbashkët; latinishtja mbeti gjuhë e kishës dhe e njerëzve të shkolluar.</li> </ul> </li> <li>Monarkitë u krijuan në Europën Perëndimore, si monarkitë franceze, spanjolle, portugeze, norvegjeze. në Europën Qendrore e Lindore ky proces u zhvillua më ngadalë.</li> <li>Këto monarki ishin absolute; mbreti kishte pushtet të pakufizuar.</li> <li>Pushteti i mbretit ushtronte me dy organe: burokraci dhe ushtri.</li> </ul>

**Përforcimi:** Marrëdhënie pyetje-përgjigje / Plotësim skeme

Mësuesi/ja përdor pyetjet e rubrikës "Gjurmojmë-Mendojmë-Arsyetojmë-Nxjerrim përfundime" në tekst, për të matur nivelin e përvetësimit të njohurive të reja.

- Si e kuptoni termin "monarki absolute"?
- Cilat ishin kushtet e krijimit të shtet-kombeve?
- Cilat ishin dy organet me të cilat qeverisnin mbretërit?
- Cilat janë tiparet e shtet-kombit?

Më pas, mësuesi/ja u kërkon nxënësve që me anë të një skeme, të pasqyrojnë forcat që ndihmuan mbretin në bashkimin e territoreve.

**Vlerësimi:**

Vlerësimi bëhet duke pasur parasysh pjesëmarrjen e nxënësve në orën e mësimit në të gjitha etapat e saj e duke i vënë në dukje rezultatet.

**Detyrë: ushtrimi 8 e rubrikës "Zbuloni".**

Përkufizoni fjalën "anarki". Ç'pasoja sjell ajo? Pyesni prindërit tuaj nëse vendi ynë ka kaluar situata anarkie dhe i përshkruani shkurtimisht ato.

**Sqarime për zgjidhjen e ushtrimeve të rubrikës:  
Gjurmojmë-Mendojmë-Arsyetojmë-Nxjerrim përfundime**

**Ushtrimi 3.**

Franca e copëtuar në zotërime feudale përbënte një rrjet të dendur doganor. Çdo feud kishte kërkesat e rregullat e veta, të cilat do t'i respektonte çdo kalimtar i huaj që donte të kalonte në atë territor. Shpeshherë kalimtarët ndesheshin me qëndrime piratereske, veçanërisht kur ata ishin tregtarë. Kështu, udhëtimi i një tregtari nëpër Francë ishte mjaft i kushtueshëm, ndonjëherë shumë kërcënues. Ndërsa udhëtimet detare jo se ishin të lehta, por pengesat e sipërme i bënë edhe më shumë të rrezikshme.

**Ushtrimi 4.**

Copëzimi sillte dobësi e pengesa si në fushën politike, ushtarake e ekonomike, kulturore, ashtu edhe në drejtim të konsolidimit shtetëror dhe kombëtar. Ai mbështetej në interesin e forcën individuale, që shpesh shoqërohej me konflikte të ashpra brenda copëzimit feudal. Te copëzimi mbështetej politika e perandorisë ndërkontinentale romake "Përçaj dhe sundo!". Bashkimi sjell bashkim forcash. Në politikë forcon pozitën shtetërore, në ekonomi rrit kapitalet dhe investimet, në kulturë të çon drejt identitetit kombëtar. Copëzimi konservonte (ruante) prapambetje, ndërsa bashkimi sillte progres (zhvillim) në të gjitha aspektet e jetës.

Fusha:	Lënda: Histori	Shkalla: III	Klasa: 6
<b>Tematika 5:</b> <ul style="list-style-type: none"> <li>Tiparet e sistemeve politike evropiane shekujt XII - XV</li> </ul>	<b>Tema mësimore:</b> <b>2. Mbretëria e Anglisë dhe Monarkia Franceze</b>	<b>Situata e të nxënit:</b> <ul style="list-style-type: none"> <li>Mësuesi/ja dhe nxënësit bashkëbisedojnë për parlamentin dhe monarkinë, rolin dhe funksionin e tyre.</li> </ul>	

### Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyç:

#### **Kompetenca e komunikimit dhe e të shprehurit**

##### **Nxënësi:**

- zhvillon kompetencën e komunikimit për të ndërtuar kompetencat historike, për të shqyrtuar, analizuar, për të parashtruar pyetje, për të argumentuar, për të diskutuar dhe për të komunikuar informacionin historik, konceptet dhe idetë.

#### **Kompetenca e të menduarit**

##### **Nxënësi:**

- zhvillon kompetencën e të menduarit për realizimin e kërkimit historik;
- zhvillon mendimin kritik për të përzgjedhur burimet, për të interpretuar të shkuarën nëpërmjet informacionit, për të dhënë argumente bazuar në burime dhe për të saktësuar saktësinë e burimeve.

#### **Kompetenca e të nxënit**

##### **Nxënësi:**

- zbaton në mënyrë të pavarur udhëzimet për një temë, veprim, aktivitet ose detyrë që i kërkohet;
- ndërlidh temën e re ose një çështje të dhënë me njohuritë dhe përvojat paraprake, duke i paraqitur në forma të ndryshme të të shprehurit sipas një radhitjeje logjike;
- vlerëson pikëpamjet e ndryshme, si dhe menaxhon emocionet, ndjenjat, kohën, shfrytëzimin e burimeve dhe mjeteve gjatë kryerjes së një detyre në histori;
- identifikon përparësitë dhe mangësitë e tij në lidhje me zotërimin e dijeve dhe kompetencave historike në funksion të përparimit dhe përmirësimit të suksesit të tyre.

#### **Kompetenca për jetën, sipërmarrjen dhe mjedisin**

##### **Nxënësi:**

- harton hapat që duhet të ndjekë për realizimin e një kërkimi historik për një ngjarje të dhënë;
- zhvillon një kërkim individual ose në grup për kryerjen e një veprimtarie në histori;
- diskuton individualisht ose në grup për rëndësinë që ka e shkuara në kuptimin e të tashmes dhe perspektivat e të ardhmes.

#### **Kompetenca personale**

##### **Nxënësi:**

- zhvillon kompetencën personale për të kuptuar veten dhe të tjerët, ndryshimet dhe ngjashmëritë, për të menaxhuar marrëdhëniet ndërmjet njëri-tjetrit, për të vlerësuar pikëpamjet e të tjerëve qofshin këto dhe të ndryshme nga të tija;
- kupton nëpërmjet kërkimit historik përvojën e njeriut, marrëdhëniet shkak-pasojë, trashëgiminë kulturore, rëndësinë historike, ndryshimet dhe vazhdimësinë që ka pësuar shoqëria përgjatë kohërave;
- përdor aftësitë e komunikimit, punës në grup etj., për të shfaqur dhe argumentuar idetë e tij.

**Kompetenca qytetare**

**Nxënësi:**

- përdor aftësitë e komunikimit, punës në grup etj., për të shfaqur dhe argumentuar idetë e tij.
- kupton nëpërmjet kërkimit historik përvojën e njeriut, marrëdhëniet shkak-pasojë, trashëgiminë kulturore, rëndësinë historike, ndryshimet dhe vazhdimësinë që ka pësuar shoqëria përgjatë kohërave;
- shpjegon origjinën dhe zhvillimin e identitetit kombëtar duke vlerësuar trashëgiminë material dhe shpirtërore;
- shqyrton një sërë burimesh që paraqesin perspektiva të ndryshme kulturore në mënyrë që të zhvillojë kuptimin historik.

**Kompetenca digjitale**

**Nxënësi**

- zhvillon kompetencën digjitale për të kërkuar, përzgjedhur, analizuar dhe komunikuar informacion historik;
- përdor një sërë burimesh digjitale të informacionit dhe analizon në mënyrë kritike këto burime historike;
- komunikon, prezanton dhe parashtron njohuritë, aftësitë dhe qëndrimet;
- bashkëpunon, diskuton dhe debaton me të tjerët për të ndërtuar konceptet dhe kompetencat historike.

<p><b>Rezultatet e të nxënit të kompetencave sipas temës:</b></p> <p><b>Nxënësi:</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• përshkruan marrëdhëniet midis princërve dhe mbretërve në Angli;</li> <li>• vlerëson ndarjen e pushtetit të mbretit nga parlamenti;</li> <li>• vlerëson rolin e Kartës së Madhe të Lirive në respektimin e të drejtave të njeriut;</li> <li>• dallon ndryshimet ndërmjet monarkisë kushtetuese dhe asaj absolute;</li> <li>• shpjegon marrëdhëniet hierarkike midis feudalëve dhe mbretërve në Francë;</li> <li>• përshkruan etapat e zhvillimit të monarkisë franceze, duke evidentuar karakterin klasik të absolutizmin francez.</li> </ul>	<p><b>Fjalë kyç:</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Karta e Madhe e Lirive</li> <li>• Parlament</li> <li>• Monarki absolute</li> <li>• Monarki e kufizuar</li> <li>• Të drejta të njeriut</li> <li>• Kushtetutë</li> </ul>
<p><b>Burimet:</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Teksti mësimor</li> <li>• e-libri</li> <li>• Harta e Europës mesjetare</li> <li>• Harta e Anglisë dhe Francës</li> <li>• Materiale nga interneti për Kartën e Madhe të Lirisë</li> <li>• Enciklopedi</li> </ul>	<p><b>Lidhja me fushat e tjera dhe me tema ndërkurrikulare:</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Gjeografi</li> </ul>


**Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve:**

**PNP:** Stuhi mendimesh - Ditari dypjesësh - Diagrami i Venit


**Parashikimi:** Stuhi mendimesh

Mësuesi/ja shkruan në dërrasë të zezë termin "monarki". Ai/ajo u kërkon nxënësve të thonë se çfarë dinë për monarkinë. Ajo parashtron disa pyetje për të drejtuar përgjigjet e nxënësve te tema e re. Disa nga pyetjet mund të jenë:

- Çfarë është monarkia?
- Çfarë autoriteti ka mbreti në një monarki absolute?
- Si qeveris mbreti?
- A trashëgohet pushteti në monarki?



Më pas, mësuesi/ja pyet nxënësit për parlamentin. Ai/ajo u kërkon atyre të tregojnë se çfarë dinë për parlamentin. Përgjigjet kryesore mësuesi/ja i shkruan në tabelë.



Ndërtesa e parlamentit të parë anglez



Ndërtesa e parlamentit të parë shqiptar

**Ndërtimi i njohurive:** Ditari dypjesësh

Mësuesi/ja në këtë fazë të orës mësimore ndërton në dërrasë të zezë një tabelë me dy shtylla dhe plotëson si më poshtë. Ai/ajo shkruan në tabelë titullin e nëntemës së parë, “Mbretëria e Anglisë, atdheu i parlamentarizmit”.



<b>Çështja</b>	<b>Komenti</b>
<ul style="list-style-type: none"> <li>• Karta e Madhe e Lirive</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Mbreti Xhon, sundimtar mizor dhe i paarsyeshëm; nuk iu nënshtrua pushtetit të kishës.</li> <li>• Fisnikët anglezë u ngritën kundër tij dhe për pak e rrëzuan nga pushteti.</li> <li>• Mbreti u detyrua të premtonte se nuk do të bënte asgjë kundër vullnetit të tyre. Ai nënshkroi dokumentin, që u quajt <b>Karta e Madhe e Lirive</b>.</li> <li>• Karta kufizonte pushtetin e mbretit dhe mbronte të drejtat e fisnikërisë. Ajo kishte rëndësi, sepse përcaktonte që:             <ul style="list-style-type: none"> <li>- Ligji qëndron mbi mbretin</li> <li>- Mbreti detyrohet të respektojë ligjin</li> <li>- Çdo qytetari të lirë i garantohet gjykim i barabartë përpara ligjit</li> </ul> </li> </ul>
<ul style="list-style-type: none"> <li>• Lindja e parlamentarizmit</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Lindja e parlamentarizmit</li> <li>- Nën sundimin e Eduardit I, feudalët dhe qytetarët e pasur zgjodhën përfaqësuesit e tyre në një këshill.</li> <li>- Këshilli u quajt parlament. Ai mbledhej rregullisht; ushtronte detyra financiare dhe administrative.</li> <li>- Monarkia absolute angleze u zëvendësua me monarki parlamentare. U përfshinë Irlanda, Uells dhe Skocia.</li> </ul>

Më pas, mësuesi/ja kalon në nëntemën e dytë, "Monarkia franceze, model i absolutizmit". Ai/ajo vazhdon me tabelën, duke e plotësuar atë si më poshtë:


<b>Çështja</b>	<b>Komenti</b>
<ul style="list-style-type: none"> <li>• Monarkia franceze, monarki absolute</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Në shek. XI Franca ishte vend i copëtuar dhe bashkimi i vendit ishte i vështirë.</li> <li>• Mbreti në krye të pushtetit.</li> <li>• Kurora mbretërore zotërohej nga Kapetinët. Pushteti ishte i trashëgueshëm. Kapetinët sunduan për 340 vjet;</li> <li>• Pushteti i mbretit (Luigji VI) u forcua edhe me ndihmën e kishës katolike. U konsolidua nëpërmjet martesave, trashëgimisë, diplomacisë dhe luftërave me feudalët rivalë.</li> <li>• Mbretërit francezë u mbështetën edhe te borgjezia e qyteteve. Ata krijuan ushtrinë e rregullt, ndërtuan administratë besnike dhe mbështeteshin nga shtresat e mesme të popullsisë.</li> <li>• Autoriteti suprem i mbretit u kundërshtua edhe nga Papa i Romës.</li> <li>• Mbreti Filipi IV e forcoi edhe më shumë pushtetin duke e bërë atë absolut.</li> </ul>

Në nëntemën e tretë, "Anglia dhe Franca gjatë Luftës 100-vjeçare", mësuesi/ja evidenton shkaqet dhe pasojat e luftës mes dy shteteve europiane.

<b>Çështja</b>	<b>Komenti</b>
<ul style="list-style-type: none"> <li>• Lufta 100-vjeçare</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Monarkia franceze mbeti pa trashëgimtar mashkull në vitin 1328. Mbreti i Francës u zgjodh nga njerëzit e afërt të familjes mbretërore.</li> <li>• Mbreti i Anglisë, Eduardi I, trashëgimtari më i afërt në vijë femërore, kërkoi fronin mbretëror francez.</li> <li>• Kjo çoi në luftë të hapur mes dy vendeve, luftë që zgjati 100 vjet.</li> <li>• Në fillim të luftës, anglezët patën epërsi. Ata pushtuan shumë nga krahinat veriore të Francës.</li> <li>• Pas disfatave të viteve '30 të shek. XV Anglia u detyrua të pranonte humbjen dhe të tërhiqej nga zotërimet në Francë.</li> <li>• Zhan d'Ark pati ndikim të madh në fitoren e Francës, që u bashkua në një shtet të vetëm.</li> <li>• Bashkimi i vendit ndihmoi në zhvillimin e shpejtë ekonomik e kulturor.</li> </ul>

### Përforcimi: Diagrami i Venit

Për të matur nivelin e përvetësimit të njohurive të reja, mësuesi/ja përdor teknikën e Diagramit të Venit, ku evidentohen të përbashkëtat dhe dallimet mes monarkisë angleze dhe asaj franceze.



Më pas, mësuesi/ja drejton disa pyetje për luftën 100-vjeçare mes Anglisë dhe Francës, si më poshtë:

- *Cilat ishin arsyet e luftës 100-vjeçare mes Anglisë dhe Francës?*
- *Si doli Franca pas kësaj lufte? Cilat ishin pasojat e luftës në Francë?*

#### Vlerësimi:

Vlerësimi bëhet duke pasur parasysh pjesëmarrjen e nxënësve në orën e mësimit në të gjitha etapat e saj e duke i vënë në dukje rezultatet.

#### Detyrë:

- Ndërtoni një tabelë në fletore, ku të krahasoni monarkinë absolute me monarkinë kushtetuese. Nxirrni në pah ngjashmëritë dhe ndryshimet mes tyre. Arsyetoni pse Anglia njihet si djepi i parlamentarizmit.
- *Për orën pasardhëse:* Nxënësit ndahen në grupe duke u orientuar për orën pasardhëse, që është një orë projekt me temë “Mësojmë duke kërkuar dhe duke zbuluar”. Nxënësit orientohen të kërkojnë informacione dhe të dhëna shtesë për monarkinë absolute dhe kushtetuese në Francë dhe Angli duke i shoqëruar ato me pamje.

#### Sqarime për zgjidhjen e ushtrimeve të rubrikës:

##### Gjurmojmë-Mendojmë-Arsyetojmë-Nxjerrim përfundime

##### Ushtrimi 5.

Absolutizmi prekte edhe pushtetin e pavarur të kishës, i cili kudo, në çdo vend, ishte i pavarur nga pushteti laik. Kisha varej direkt nga papati. Përpjekja e monarkëve për ta shtrirë pushtetin e tyre është në sferën kishtarë solli acarimin e marrëdhënieve mes mbretit e papës.

##### Ushtrimi 6.

Në rrugën për vendosjen e absolutizmin në Francë kanë luajtur rol pozita e kishës dhe grindjet feudale.

##### Ushtrimi 8.

Karikatura paraqitet dokumenti “Karta e Madhe e Lirive”. Tri figurat që janë duke e mbajtur fort atë përfaqësojnë: fisnikët, qytetarët e pasur dhe klerikët. Duke u mbështetur në këtë dokument, ata kufizonin pushtetin mbretëror. Mbështjella e mbretit me dokumentin shpreh vlerën e këtij dokumenti, i cili e mban të kufizuar pushtetin e tij. Karta solli lindjen e një monarkie të re: Monarkinë Kushtetuese.

Fusha:	Lënda: Histori	Shkalla: III	Klasa: 6
<b>Tematika 5:</b> <ul style="list-style-type: none"> <li>Tiparet e sistemeve politike evropiane shekujt XII - XV</li> </ul>	<b>Tema mësimore:</b> <b>3. Ndryshimet ndërmjet sistemeve politike evropiane: Anglia dhe Franca (situatë e sugjeruar)</b>	<b>Situata e të nxënit:</b> <ul style="list-style-type: none"> <li>Nxënësit dhe mësuesi/ja bashkëbisedojnë për shtet-kombet e veçoritë e tyre dhe krahasojnë monarkinë angleze me atë franceze.</li> </ul>	

<p><b>Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyç:</b></p> <p><b>Kompetenca e të menduarit</b></p> <p><b>Nxënësi:</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>zhvillon kompetencën e komunikimit për të ndërtuar kompetencat historike, për të shqyrtuar, analizuar, për të parashtruar pyetje, për të argumentuar, për të diskutuar dhe për të komunikuar informacionin historik, konceptet dhe idetë.</li> </ul> <p><b>Kompetenca e të menduarit</b></p> <p><b>Nxënësi:</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>zhvillon kompetencën e të menduarit për realizimin e kërkimit historik.</li> </ul> <p><b>Kompetenca për jetën, sipërmarrjen dhe mjedisin</b></p> <p><b>Nxënësi:</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>harton hapat që duhet të ndjekë për realizimin e një kërkimi historik për një ngjarje të dhënë;</li> <li>zhvillon një kërkim individual ose në grup për kryerjen e një veprimtarie në histori;</li> <li>diskuton individualisht ose në grup për rëndësinë që ka e shkuara në kuptimin e të tashmes dhe perspektivat e të ardhmes.</li> </ul> <p><b>Kompetenca qytetare</b></p> <p><b>Nxënësi:</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>përdor aftësitë e komunikimit, punës në grup etj., për të shfaqur dhe argumentuar idetë e tij.</li> <li>kupton nëpërmjet kërkimit historik përvojën e njeriut, marrëdhëniet shkak-pasojë, trashëgiminë kulturore, rëndësinë historike, ndryshimet dhe vazhdimësinë që ka pësuar shoqëria përgjatë kohërave;</li> <li>shpjegon origjinën dhe zhvillimin e identitetit kombëtar duke vlerësuar trashëgiminë material edhe shpirtërore;</li> <li>shqyrton një sërë burimesh që paraqesin perspektiva të ndryshme kulturore në mënyrë që të zhvillojë kuptimin historik.</li> </ul> <p><b>Kompetenca digjitale</b></p> <p><b>Nxënësi:</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>zhvillon kompetencën digjitale për të kërkuar, përzgjedhur, analizuar dhe komunikuar informacion historik;</li> <li>bashkëpunon, diskuton dhe debaton me të tjerët për të ndërtuar konceptet dhe kompetencat historike.</li> </ul>
---

<p><b>Rezultatet e të nxënit të kompetencave sipas temës:</b></p> <p><b>Nxënësi:</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>krahason ndryshimet ndërmjet sistemit politik anglez dhe sistemit politik francez;</li> <li>evidenton veçoritë kryesore të formimit të shtet-kombeve.</li> </ul>	<p><b>Fjalë kyç:</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>Shtet-komb</li> <li>Sistem politik</li> <li>Monarki absolute</li> <li>Dhomë e Lordëve</li> <li>Kartë e Madhe e Lirive</li> <li>Monarki angleze</li> <li>Monarki franceze</li> </ul>
--	---

**Burimet:**

- Teksti mësimor
- e-libri
- Harta e Anglisë dhe Francës
- Materiale nga interneti për Kartën e Madhe të Lirisë
- Enciklopedi

**Lidhja me fushat e tjera dhe me tema ndërkurrikulare:**

- Gjeografi


**Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve:**

**PNP:** Stuhi mendimesh - Lexim i orientuar/ Prezantim i punimit - Diagrami i Venit

**Parashikimi:** Stuhi mendimesh

Në fillim, mësuesi/ja ndërton skemën e mëposhtëm dhe e plotëson atë së bashku me nxënësit. Ajo drejton pyetje, përgjigjet e të cilave do të orientojnë atë dhe nxënësit të evidentojnë veçoritë kryesore të shtet-kombeve. Ja disa nga pyetjet që mund të bëjë mësuesi/ja;

- Çfarë janë shtet-kombet (veçoritë e tyre: kufijtë, ushtria, monedha e njëjtë etj.)?
- Si u formuan ato (bashkim tokash/territoresh)?
- Çfarë roli luante mbreti (kishte pushtet të pakufizuar)?
- Cilat ishin organet drejtuese/qeverisëse (mbreti/burokracia)?
- Çfarë roli kishte kisha te shtet-kombet?
- Cilat ishin shtresat përbërëse të shoqërisë (fshatarët, qytetarët, kleri, feudalët, kalorësit, ushtria, oborri mbretëror)? (Mësuesi/ja mund të shtrojë pyetje të tjera.)

**Ndërtimi i njohurive:** Lexim i orientuar/Prezantim i punimit


Mësuesi/ja ka udhëzuar paraprakisht nxënësit për informacionet dhe të dhëna që duhet të mbledhin për sistemet politike në Angli dhe Francë. Pasi të kenë lexuar tekstin ku përmbledhen marrëdhëniet mes fisnikëve dhe feudalëve me mbretin, nxënësit fillojnë të punojnë së bashku për të përpunuar materialet e tyre të mbledhura sipas udhëzimeve dhe ndarjeve në grupe pune që janë caktuar paraprakisht nga

mësuesi/ja me detyrat përkatëse. Klasa ndahet në dy grupe me detyrat si më poshtë:

Grupi 1: Sistemi politik në Angli  
 Grupi 2: Sistemi politik në Francë

Në këtë fazë, nxënësit bashkëpunojnë mes tyre dhe bashkërendojnë materialet që kanë grumbulluar dhe i përgatisin ato në formën e një prezantimi në Power Point. Një përfaqësues i secilit grup prezanton punimin e grupit të tij/saj.

Në etapën e tretë të orës mësimore, mësuesi/ja u kërkon nxënësve t'i rikthehen mësimit "Mbretëria e Anglisë dhe Monarkia Franceze" dhe të mbajnë shënime rreth procesit të shndërrimit të formës së regjimit në këto dy shtete. Ai/ajo ndërton një Diagram Veni në dërrasë të zezë dhe e plotëson së bashku me nxënësit.



Në fund të orës diskutohet për punimet që paraqitën grupet dhe jepen edhe vlerësimet.

**Vlerësimi:**

Vlerësimi bëhet duke pasur parasysh:

- Informacionin më të plotë e më të saktë
- Prezantimin më të mirë
- Bashkëpunimin më të mirë në grup
- Pjesëmarrjen dhe aktivizimin e nxënësve në orën e mësimit
- Punën individuale

**Detyrë:**

Kërkoni në internet të dhëna për Kartën e Madhe të Lirive në Angli dhe lexoni disa pika kryesore të saj.

Përgatitni një poster me këto pika, duke evidentuar ato më të rëndësishmet. Posterit mund të përgatitet në formën e një karte të madhe.

Fusha:	Lënda: Histori	Shkalla: III	Klasa: 6
<b>Tematika 5:</b> <ul style="list-style-type: none"> <li>Tiparet e sistemeve politike evropiane shekujt XII - XV</li> </ul>	<b>Tema mësimore:</b> <b>4. Perandoria Osmane</b>	<b>Situata e të nxënimit:</b> <ul style="list-style-type: none"> <li>Nxënësit risjellin për diskutim çështje të rënies së Perandorisë Bizantine dhe të qytetërimit arab.</li> </ul>	

### Rezultatet e të nxënimit sipas kompetencave kyç:

#### **Kompetenca e të nxënimit**

##### **Nxënësi:**

- zhvillon kompetencën e të nxënimit për të shfrytëzuar të dhënat, për të demonstruar të kuptuarit e koncepteve historike dhe shoqërore, duke i prezantuar nëpërmjet formave të ndryshme të të shprehurit;
- ndërlidh temën e re ose një çështje të dhënë me njohuritë dhe përvojat paraprake, duke i paraqitur në forma të ndryshme të të shprehurit sipas një radhitjeje logjike;
- parashtron pyetje kërkimore dhe përgjigjet duke u bazuar në argumente dhe burime.

#### **Kompetenca e komunikimit dhe e të shprehurit**

##### **Nxënësi:**

- zhvillon kompetencën e komunikimit për të ndërtuar kompetencat historike, për të shqyrtuar, analizuar, për të parashtruar pyetje, për të argumentuar, për të diskutuar dhe për të komunikuar informacionin historik, konceptet dhe idetë.

#### **Kompetenca e të menduarit**

##### **Nxënësi:**

- analizon të dhënat për të kuptuar të shkuarën, për shembull, për të kuptuar shkakun dhe pasojën, vazhdimësinë dhe ndryshimin;
- zhvillon mendimin krijues për të ndërtuar interpretime të reja të cilat shpjegojnë aspekte të së shkuarës, që janë të diskutueshme;
- zhvillon mendimin kritik për të përzgjedhur burimet, për të interpretuar të shkuarën nëpërmjet informacionit, për të dhënë argumente bazuar në burime dhe për të saktësuar saktësinë e burimeve.

#### **Kompetenca personale**

##### **Nxënësi:**

- kupton nëpërmjet kërkimit historik përvojën e njeriut, marrëdhëniet shkak-pasojë, trashëgiminë kulturore, rëndësinë historike, ndryshimet dhe vazhdimësinë që ka pësuar shoqëria përgjatë kohërave.

#### **Kompetenca qytetare**

##### **Nxënësi:**

- zhvillon kompetencën qytetare për të shqyrtuar në mënyrë kritike sjelljet, motivet dhe veprimet e njerëzve në të shkuarën që mund të jenë rezultat i ndryshimit të qëndrimeve shoqërore dhe standardeve të ndryshme;
- shqyrton burimet historike për të kuptuar çështjet shoqërore dhe se si parime të ndryshme kanë ndikuar në çështjet njerëzore;
- kupton perspektivat, besimet dhe qëndrimet e njerëzve në të shkuarën e në të tashmen dhe rëndësinë e njohjes së historisë së tyre dhe të tjerëve;

- shpjegon origjinën dhe zhvillimin e identitetit kombëtar, duke vlerësuar trashëgiminë material edhe shpirtërore;
- shqyrton një sërë burimesh që paraqesin perspektiva të ndryshme kulturore në mënyrë që të zhvillojë kuptimin historik.

**Kompetenca qytetare**

**Nxënësi:**

- bashkëpunon, diskuton dhe debaton me të tjerët për të ndërtuar konceptet dhe kompetencat historike.


<p><b>Rezultatet e të nxënit të kompetencave sipas temës:</b></p> <p><b>Nxënësi:</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Tregon lidhjen midis selxhukëve dhe osmanëve;</li> <li>• vë në dukje kushtet historike të formimit të Perandorisë Osmane;</li> <li>• përshkruan rrugën e krijimit të shtetit osman;</li> <li>• tregon karakterin dhe organizimin politik dhe shoqëror të Perandorisë Osmane.</li> </ul>	<p><b>Fjalë kyç:</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Turq selxhukë</li> <li>• Osman</li> <li>• Sulltan</li> <li>• Spahi</li> <li>• Kaza</li> <li>• Vilajet</li> <li>• Pasha</li> <li>• Sanxhak</li> </ul>
<p><b>Burimet:</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Teksti mësimor</li> <li>• e-libri</li> <li>• Harta e Europës mesjetare</li> <li>• Harta e Azisë dhe Afrikës</li> <li>• Materiale nga interneti për Perandorinë Osmane</li> <li>• Enciklopedi</li> </ul>	<p><b>Lidhja me fushat e tjera dhe me tema ndërkurrikulare:</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Gjeografi</li> </ul>

**Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve:**

**PNP:** Parashikim me terma paraprakë - Pema e mendjes - Punë me tekstin

**Parashikim:** Parashikim me terma paraprakë


Mësuesi/ja i njej nxënësit me temën e re dhe shkruan në disa kuadrate të ndërtuara në dërrasë të zezë termat: perandori osmane, sulltan, Ballkan, Azia e Vogël, fe islame, turq selxhukë.



Mësuesi/ja pyet nxënësit se çfarë lidhje kanë këto terma me mësimin e ditës. Pasi merr përgjigjet prej tyre, ai/ajo evidenton ato që lidhen drejtpërdrejtë me temën e re dhe i shkruan në tabelë.

**Ndërtimi i njohurive:** Pema e mendjes

Mësuesi/ja udhëzon nxënësit të lexojnë mësimin dhe të nënvizojnë pjesët kryesore, ndërkohë shkruan në dërrasë të zezë togfjalëshin "Perandoria Osmane", të vendosur në qendër të një rrethi të vizatuar.



### **Përforcimi:** Punë me tekstin

Në këtë pjesë të orës së mësimin, mësuesi/ja përdor teknikën “Punë me tekstin” për të matur nivelin e përvetësimit të njohurive të reja. Në rubrikën “Gjurmojmë-Mendojmë-Arsyetojmë-Nxjerrim përfundime” në tekst, mësuesi/ja përdor pikat e hartuara në të dhe shtron pyetjet:

- Cilat ishin kushtet e krijimit të Perandorisë Osmane?
- Tregoni lidhjen mes selxhukëve dhe osmanëve.
- Si u pritën pushtuesit osmanë në Ballkan? Cilat ishin betejat kryesore dhe si përfunduan ato?
- Çfarë pasojash pati rënia e Kostandinopojës për Europën?
- Çfarë organizimi shoqëror, politik dhe administrativ kishte Perandoria Osmane?

### **Vlerësimi:**

Vlerësimi bëhet duke pasur parasysh pjesëmarrjen e nxënësve në orën e mësimin në të gjitha etapat e saj e duke i vënë në dukje rezultatet.

### **Detyrë:**

- Kërkoni në internet informacione për krijimin dhe fuqizimin e Perandorisë Osmane dhe pushtimin e Ballkanit. Evidentoni qëndresën e Shqipërisë nën udhëheqjen e Skënderbeut.
- *Për orën pasardhëse:* Nxënësit ndahen në grupe duke u orientuar për tri orë pasardhëse, që janë orë projekt me temë “Unë jam shqiptar, pasardhës i arbërve”. Ata orientohen të kërkojnë informacione dhe të dhëna për prejardhjen e shqiptarëve, për Principatën e Arbrit, për luftën kundër pushtuesve osmanë nën drejtimin e Heroit Kombëtar, Gjergj Kastriot Skënderbeu, dhe rëndësinë e qëndresës shqiptare ndaj pushtimit osman.



Fusha:	Lënda: Histori	Shkalla: III	Klasa: 6
<b>Tematika 5:</b> <ul style="list-style-type: none"> <li>Tiparet e sistemeve politike evropiane shekujt XII - XV</li> </ul>	<b>Tema mësimore:</b> <b>5-6-7. Unë jam shqiptar, pasardhës i arbërve (situatë e sugjeruar, 3 orë)</b>	<b>Situata e të nxënit:</b> <ul style="list-style-type: none"> <li>Nxënësit dhe mësuesi/ja diskutojnë për pushtimin e Ballkanit nga osmanët dhe qëndresën shqiptare</li> </ul>	

**Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyç:****Kompetenca e komunikimit dhe e të shprehurit****Nxënësi:**

- zhvillon kompetencën e komunikimit për të ndërtuar kompetencat historike, për të shqyrtuar, analizuar, për të parashtruar pyetje, për të argumentuar, për të diskutuar dhe për të komunikuar informacionin historik, konceptet dhe idetë.

**Kompetenca e të menduarit****Nxënësi:**

- zhvillon kompetencën e të menduarit për realizimin e kërkimit historik;
- zhvillon mendimin kritik për të përzgjedhur burimet, për të interpretuar të shkuarën nëpërmjet informacionit, për të dhënë argumente bazuar në burime dhe për të saktësuar saktësinë e burimeve.

**Kompetenca e të nxënit****Nxënësi:**

- zbaton në mënyrë të pavarur udhëzimet për një temë, veprim, aktivitet ose detyrë që i kërkohet;
- ndërlidh temën e re ose një çështje të dhënë me njohuritë dhe përvojat paraprake, duke i paraqitur në forma të ndryshme të të shprehurit sipas një radhitjeje logjike;
- vlerëson pikëpamjet e ndryshme, si dhe menaxhon emocionet, ndjenjat, kohën, shfrytëzimin e burimeve dhe mjeteve gjatë kryerjes së një detyre në histori;
- identifikon përparësitë dhe mangësitë e tij në lidhje me zotërimin e dijeve dhe kompetencave historike në funksion të përparimit dhe përmirësimit të suksesit të tyre.

**Kompetenca për jetën, sipërmarrjen dhe mjedisin****Nxënësi:**

- harton hapat që duhet të ndjekë për realizimin e një kërkimi historik për një ngjarje të dhënë;
- zhvillon një kërkim individual ose në grup për kryerjen e një veprimtarie në histori;
- diskuton individualisht ose në grup për rëndësinë që ka e shkuara në kuptimin e të tashmes dhe perspektivat e të ardhmes.

**Kompetenca personale****Nxënësi:**

- zhvillon kompetencën personale për të kuptuar veten dhe të tjerët, ndryshimet dhe ngjashmëritë, për të menaxhuar marrëdhëniet ndërmjet njëri-tjetrit, për të vlerësuar pikëpamjet e të tjerëve qofshin këto dhe të ndryshme nga të tija;
- kupton nëpërmjet kërkimit historik përvojën e njeriut, marrëdhëniet shkak-pasojë, trashëgiminë kulturore, rëndësinë historike, ndryshimet dhe vazhdimësinë që ka pësuar shoqëria përgjatë kohërave;
- përdor aftësitë e komunikimit, punës në grup etj., për të shfaqur dhe argumentuar idetë e tij.

**Kompetenca qytetare****Nxënësi:**

- kupton nëpërmjet kërkimit historik përvojën e njeriut, marrëdhëniet shkak-pasojë, trashëgiminë kulturore, rëndësinë historike, ndryshimet dhe vazhdimësinë që ka pësuar shoqëria përgjatë kohërave;

- shpjegon origjinën dhe zhvillimin e identitetit kombëtar duke vlerësuar trashëgiminë material edhe shpirtërore;
- shqyrton një sërë burimesh që paraqesin perspektiva të ndryshme kulturore në mënyrë që të zhvillojë kuptimin historik.

### **Kompetenca digjitale**

#### **Nxënësi**

- zhvillon kompetencën digjitale për të kërkuar, përzgjedhur, analizuar dhe komunikuar informacion historik;
- përdor një sërë burimesh digjitale të informacionit dhe analizon në mënyrë kritike këto burime historike;
- komunikon, prezanton dhe parashtron njohuritë, aftësitë dhe qëndrimet;
- bashkëpunon, diskuton dhe debaton me të tjerët për të ndërtuar konceptet dhe kompetencat historike.

<p><b>Rezultatet e të nxënit të kompetencave sipas temës:</b></p> <p><b>Nxënësi:</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• njeh aspekte të jetës në principatën e Arbrit, si: vendndodhja e saj në hartën e Europës, organizimi shtetëror, zhvillimi urban, kultura dhe besimi;</li> <li>• përcakton tiparet të jetës së përditshme në këto principata;</li> <li>• diskuton për jetën dhe origjinën e Gjergj Kastriot Skënderbeut;</li> <li>• vlerëson rolin e tij si hero kombëtar;</li> <li>• vlerëson jehonën e veprës së Skënderbeut në artin dhe kulturën botërore;</li> <li>• vlerëson trashëgiminë e qytetërimeve mesjetare.</li> </ul>	<p><b>Fjalë kyç:</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Pushtim osman</li> <li>• Principatë e Arbrit</li> <li>• Skënderbeu</li> <li>• Qëndresë historike</li> <li>• Kala</li> <li>• Art dhe kulturë botërore</li> </ul>
<p><b>Burimet:</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Teksti mësimor</li> <li>• e-libri</li> <li>• Harta e Ballkanit</li> <li>• Harta e Shqipërisë në epokën e Skënderbeut</li> <li>• Materiale të ndryshme, botime, pamje filmike të Skënderbeut dhe luftërave të tij;</li> <li>• Enciklopedi</li> </ul>	<p><b>Lidhja me fushat e tjera dhe me tema ndërkurrikulare:</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Gjeografi</li> <li>• Arti pamor</li> </ul>
<p><b>Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve:</b></p> <p><b>PNP:</b> Diskutim, bashkëbisedim, punë në grupe, shfaqje filmi, konkurs për poezinë, interpretimin dhe vizatimin/pikturën më të bukur</p> <p><i><u>Ora e sugjeruar 1: Principata e Arbrit</u></i></p> <p>Në këtë orë projekti, mësuesi/ja dhe nxënësit diskutojnë për Principatën e Arbrit. Nxënësit janë orientuar paraprakisht të mbledhin informacione për këtë principatë, lindjen e saj, zhvillimin dhe rënien pas pushtimit nga pushtuesit osmanë. Për të gjallëruar diskutimet, mësuesi/ja mund të shtrojë pyetje dhe nxënësit japin përgjigje të mbështetura nga njohuritë e marra deri tani si dhe nga materialet dhe informacionet e mbledhura nga interneti. Disa pyetje mund të jenë:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Kur u krijua Principata e Arbrit dhe ku shtrihej ajo?</li> <li>- Cili ishte udhëheqësi i Principatës së Arbrit?</li> <li>- Çfarë besimi fetar dhe zhvillim kulturor kishte kjo principatë?</li> <li>- Si ra Principata e Arbrit? Cilat janë disa nga pasojat e rënies së kësaj principate?</li> </ul>	

Më pas, mësuesi/ja udhëzon nxënësit të punojnë së bashku për të përpunuar materialet e tyre të mbledhura sipas udhëzimeve dhe ndarjeve në grupe pune që janë caktuar paraprakisht nga mësuesi/ja me detyrat përkatëse. Klasa ndahet në dy grupe me detyrat si më poshtë:

Grupi 1: Principata e Arbrit, krijimi dhe zhvillimi i saj ekonomik, kulturor dhe politik

Grupi 2: Principata e Arbrit, luftërat dhe qëndresa ndaj pushtimit osman nën udhëheqjen e Skënderbeut

Nxënësit bashkëpunojnë dhe bashkërendojnë materialet që kanë grumbulluar dhe i përgatisin ato në formën e një prezantimi në PoëerPoint. Një përfaqësues i secilit grup prezanton punimin e grupit të tij/saj.

Në fund të orës diskutohet për punimet që paraqitën grupet dhe jepen edhe vlerësimet.

**Ora e sugjeruar 2: Jeta dhe veprimtaria e Heroit tonë Kombëtar, Gjergj Kastriot Skënderbeu**

Në këtë orë, mësuesi/ja orienton nxënësit të përpunojnë materialet pamore, filmike dhe tekste që kanë mbledhur për jetën dhe veprën e Heroit Kombëtar, Gjergj Kastriot Skënderbeu. Për këtë orë, ai/ajo ndan klasën në pesë grupe me detyrat si më poshtë:

Grupi 1: Jeta e Skënderbeut

Grupi 2: Betejat kryesore të Skënderbeut

Grupi 3: Marrëdhëniet e Skënderbeut me shtetet e tjera evropiane

Grupi 4: Rëndësia e qëndresës së shqiptarëve nën udhëheqjen e Skënderbeut ndaj pushtimeve osmane

Duke qenë se kjo temë është mjaft e gjerë, mësuesi/ja orienton nxënësit të përmbledhin materialet e tyre dhe t'i prezantojnë ato me qartësi dhe ndjenjë. Ai/ajo udhëzon nxënësit të bashkëpunojnë me grupet e tjera në mënyrë që të shmangët përsëritja e informacioneve që kanë mbledhur nxënësit.

Pas përpunimit të informacionit dhe materialeve të mbledhura nga nxënësit, fillojnë prezantimet në forma të ndryshme, si poster, pamje filmike, prezantim me video projektor, PoëerPoint, etj. Mësuesi/ja mund të ndërhyjë për të kanalizuar prezantimin duke shmangur përsëritjet e informacionit.

Në përfundim të orës, nxënësit vlerësojnë punën e grupeve. Më pas mësuesi/ja udhëzon nxënësit të krijojnë/mësojnë poezi apo të bëjnë vizatime/postera për Skënderbeun duke i informuar nxënësit se ora pasardhëse do të jetë në formën e një konkursi/shfaqje me recitime, këngë dhe pamje filmike për Skënderbeun. Ai/ajo udhëzon nxënësit të mbledhin informacione për Skënderbeun në art dhe kulturë, vendase dhe të huaj.

**Ora e sugjeruar 3: Skënderbeu në art dhe kulturë**

Në fillim të orës së fundit të këtij projekti, mësuesi/ja mund të shfaqë në video projektor pjesë të shkurtra nga filmi artistik "Skënderbeu" ose pamje të tjera filmike që bëjnë fjalë për jetën dhe veprën e heroit tonë kombëtar.

Më pas, klasa e ndarë në dy grupe përgatisin materialet e grumbulluara që flasin për jetën dhe veprën e Skënderbeut të pasqyruara në art dhe kulturë. Grupet ndahen sipas tematikave të mëposhtme:

Grupi 1: Skënderbeu në art, pikturë, filma, muzikë

Grupi 2: Skënderbeu në letërsinë shqiptare dhe botërore

Me të përfunduar përpunimi i materialeve, nxënësit fillojnë të prezantojnë punimet e tyre. Këtu nxënësit mund të plotësojnë duke dhënë edhe krijimet e tyre në pikturë, skulpturë, vjersha, poezi, etj.

Pas përfundimit të prezantimeve, mësuesi/ja fton nxënësit të recitojnë pjesë nga krijimet shqiptare dhe të huaja, edhe të nxënësve, për Skënderbeun.

Në fund të orës, bëhet vlerësimet përkatëse të punimeve dhe krijimeve më të bukura.

**Vlerësimi:**

Vlerësimi bëhet duke pasur parasysh:

- Informacionin më të plotë e më të saktë
- Prezantimin më të mirë
- Bashkëpunimin më të mirë në grup
- Pjesëmarrjen dhe aktivizimin e nxënësve në orën e mësimit
- Punën individuale

**Detyrë:**

Krijoni një kënd për figurën e heroit kombëtar, Gjergj Kastriot Skënderbeu. Këndi mund të përmbajë pamjet të krijimeve artistike nga betejat kryesore të Skënderbeut, figurës së tij, piktura të Skënderbeut, etj. Për realizimin e këtij këndi është mirë të bashkëpunohet edhe me mësuesen/in e artit pamor.

Fusha:	Lënda: Histori	Shkalla: III	Klasa: 6
<b>Tematika 5:</b> <ul style="list-style-type: none"> <li>Tiparet e sistemeve politike evropiane shekujt XII - XV</li> </ul>	<b>Tema mësimore:</b> <b>8. Kultura dhe besimi në qytetërimet mesjetare</b>	<b>Situata e të nxënit:</b> <ul style="list-style-type: none"> <li>Nxënësit diskutojnë për artin dhe kulturën në mesjetë.</li> </ul>	

**Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyç:**

**Kompetenca e të nxënit**

**Nxënësi:**

- zhvillon kompetencën e të nxënit për të shfrytëzuar të dhënat, për të demonstruar të kuptuarit e koncepteve historike dhe shoqërore, duke i prezantuar nëpërmjet formave të ndryshme të të shprehurit;
- ndërlidh temën e re ose një çështje të dhënë me njohuritë dhe përvojat paraprake, duke i paraqitur në formë të ndryshme të të shprehurit sipas një radhitjeje logjike;
- parashtron pyetje kërkimore dhe përgjigjet duke u bazuar në argumente dhe burime.

**Kompetenca e komunikimit dhe e të shprehurit**

**Nxënësi:**

- zhvillon kompetencën e komunikimit për të ndërtuar kompetencat historike për të shqyrtuar, analizuar, për të parashtruar pyetje, për të argumentuar, për të diskutuar dhe për të komunikuar informacionin historik, konceptet dhe idetë.

**Kompetenca e të menduarit**

**Nxënësi:**

- analizon të dhënat për të kuptuar të shkuarën, për shembull për të kuptuar shkakun dhe pasojën, vazhdimësinë dhe ndryshimin;
- zhvillon mendimin krijues për të ndërtuar interpretime të reja, të cilat shpjegojnë aspekte të së shkuarës, që janë të diskutueshme;
- zhvillon mendimin kritik për të përzgjedhur burimet, për të interpretuar të shkuarën nëpërmjet informacionit, për të dhënë argumente bazuar në burime dhe për të saktësuar saktësinë e burimeve.

**Kompetenca personale**

**Nxënësi:**

- kupton nëpërmjet kërkimit historik përvojën e njeriut, marrëdhëniet shkak-pasojë, trashëgiminë kulturore, rëndësinë historike, ndryshimet dhe vazhdimësinë që ka pësuar shoqëria përgjatë kohërave.

**Kompetenca qytetare**

**Nxënësi:**

- shqyrton burimet historike për të kuptuar çështjet shoqërore dhe se si parime të ndryshme kanë ndikuar në çështjet njerëzore;
- kupton perspektivat, besimet dhe qëndrimet e njerëzve në të shkuarën e në të tashmen dhe rëndësinë e njohjes së historisë së tyre dhe të tjerëve;
- shqyrton një sërë burimesh që paraqesin perspektiva të ndryshme kulturore në mënyrë që të zhvillojë kuptimin historik.

**Kompetenca digjitale**

**Nxënësi:**

- bashkëpunon, diskuton dhe debaton me të tjerët për të ndërtuar konceptet dhe kompetencat historike.

<p><b>Rezultatet e të nxënit të kompetencave sipas temës:</b>  <b>Nxënësi:</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• evidenton tiparet e zhvillimit të artit, kulturës, arsimit në qytetërimet mesjetare;</li> <li>• dallon rolin e fesë në qytetërimet mesjetare;</li> <li>• krahason prirjet e zhvillimit të artit, kulturës dhe arsimit në qytetërimin arab dhe atë perëndimor;</li> <li>• njeh dhe vlerëson disa nga figurat historike që i përkasin kësaj tematike, si: Henriku II, Henriku VII, Mbreti Xhon, Uat Tajler, Eduardi i Anglisë, Huniadi, Mehmeti II, Llazari, Skënderbeu etj.</li> </ul>	<p><b>Fjalë kyç:</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Arsim laik</li> <li>• Universitet</li> <li>• Stil romak</li> <li>• Stil gotik</li> </ul>
<p><b>Burimet:</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Teksti mësimor</li> <li>• e-libri</li> <li>• Harta e Evropës mesjetare</li> <li>• Harta e Azisë dhe Afrikës</li> <li>• Materiale nga interneti për kulturën dhe artin mesjetar (përfshirë këtu pamje nga ndërtesa, skulptura, piktura, etj. që i përkasin periudhës së mesjetës)</li> <li>• Enciklopedi</li> </ul>	<p><b>Lidhja me fushat e tjera dhe me tema ndërkurrikulare:</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Gjeografi</li> <li>• Art pamor</li> </ul>

**Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve:**

**PNP:** Diskutim - Ditari dypjesësh - Marrëdhëniet pyetje-përgjigje/Rrjeti i diskutimit

**Parashikimi:** Diskutim

Mësuesi/ja njeh nxënësit me temën e re dhe u kërkon nxënësve të risjellin në mendje njohuritë që kanë marrë për artin, kulturën dhe arsimin në qytetërimin romak, bizantin, arab dhe osman. Ai/aajo drejton diskutimet e nxënësve për arritjet në art e kulturë të këtyre qytetërimeve, sidomos në pikturë, letërsi, arkitekturë, mjekësi etj., dhe ndikimet e tyre në qytetërimet mesjetare. Mësuesi/ja shkruan disa nga çështjet më kryesore në dërrasë të zezë dhe kalon në etapën e dytë të mësimit.



Në mesjetë mësimi zhvilloj në kisha



Kultura arabe ndikoi shumë në Europë

**Ndërtimi i njohurive:** Ditari dypjesësh

Mësuesi/ja përdor teknikën e *ditarit dypjesësh* për të ndërtuar njohuritë e reja të kësaj teme. Ai/ajo udhëzon nxënësit të lexojnë tekstin dhe ndërton tabelën e mëposhtme, të cilët e plotëson së bashku me nxënësit, ndërkohë që këta të fundit lexojnë nëntemat e mësimit.

<b>Çështja</b>	<b>Komenti</b>
Kultura	<ul style="list-style-type: none"> <li>Tregtia me Lindjen mundësoi përhapjen e kulturës arabe, që ndikoi në shumë sfera të jetës në Evropë, si: blegtori, bujqësi apo edhe në shkencë, si: astronomia, mjekësia, matematika etj.</li> <li>Feja islame nuk mundi të depërtojë. Krishterimi mbizotëronte në të gjitha skajet e jetës.</li> </ul>
Arsimi	<ul style="list-style-type: none"> <li>Nuk u shkëput nga ndikimi i frymës fetare.</li> <li>Shkollat mesjetare ishin ngritur pranë kishave dhe drejtoheshin nga priftërinjtë</li> <li>Shkolla njohu tri nivele: 1. Fillorja, 2. E mesmja, 3. Universiteti</li> <li>Shoqëria kishte një nivel të ulët kulturor e me analfabetizëm mjaft të përhapur.</li> <li>Zhvillimi ekonomik nxiti nevojën për dije, filloi të ndiqej arsimi i mesëm, me dy nivele (1. gramatika latine, retorika dhe dialektika dhe 2. Shkencë [matematika, gjeometria, astronomia] dhe muzika).</li> <li>Në shek. XI lindën shkollat laike të drejtuara nga mësues joklerikë. Nga këto shkolla lindën universitetet, Bolonjë, Padova, Oksford etj.</li> </ul>
Letërsia	<ul style="list-style-type: none"> <li>Veprat me karakter fetar të përhapura</li> <li>Gradualisht lindi letërsia popullore që shmangu përdorimin e latinishtes dhe përdori gjuhën e përditshme</li> <li>U shkruan romane, novela e poema me tematikë që pasqyronin ngjarje të mëdha historike dhe heronj.</li> <li>Zhvillimi i tregtisë dhe kontakti me vende e shoqëri të ndryshme solli krijimin e një letërsie që i kushtohej vendeve të reja, aventurave etj.</li> <li>Filluan të shkruheshin (me dorë) dhe të shtypeshin librat, që fillimisht ishin objekte luksi (të qëndisura me ar dhe argjend).</li> </ul>
Arkitektura	<ul style="list-style-type: none"> <li>U përqendrua kryesisht në ndërtimin e godinave fetare. U ndërtuan edhe objekte jofetare, si: pallate, sheshe, pazare, rrugë, mure rrethuese.</li> <li>Fillimisht përdorej stili romak (me harqe dhe mure të trasha) dhe më pas stili gotik (harku mori formën e një shigjete, godina më elegante, më të larta e me më shumë dritë).</li> </ul>
Arti	<ul style="list-style-type: none"> <li>Piktura dhe skulptura u zbatuan përgjithësisht në objekte fetare. kishat zbukuroheshin me piktura me tematikë fetare dhe jofetare (nga jeta e përditshme e njerëzve dhe punës)</li> <li>Elemente të pikturës e skulpturës përdorëshin edhe nga artizanët, që punonin arin, fildishin, argjendin etj., si objekte zbukurimi.</li> </ul>

**Përforcimi:** Marrëdhënie pyetje-përgjigje/Rrjeti i diskutimit

Në këtë pjesë të orës së mësimit, mësuesi/ja drejton disa pyetje për të matur nivelin e përvetësimit të njohurive të reja. Nga rubrika "Gjurmojmë-Mendojmë-Arsyetojmë-Nxjerrim përfundime" në tekst, mësuesi/ja merr disa pyetje (apo harton edhe të tjera) si:

- *Si lindi arsimi laik në Europën mesjetare dhe pse?*

- Cilat ishin tri nivelet e shkollës në mesjetë?
- Çfarë e nxiti zhvillimin e arsimit deri në nivel universitar?
- Cila ishte tematika e letërsisë në mesjetë?
- Pse piktura dhe skulptura ishin më shumë të lidhura me kishën?

Më pas, mësuesi/ja ndërton tabelën e mëposhtme:

<b>Jo</b>	<b>Pyetja</b>	<b>Po</b>
<i>Argumentet kundër</i>	<i>A vlerësohet si art puna e një artizani?</i>	<i>Argumentet pro</i>

#### **Vlerësimi:**

Vlerësimi bëhet duke pasur parasysh pjesëmarrjen e nxënësve në orën e mësimit në të gjitha etapat e saj e duke i vënë në dukje rezultatet.

#### **Detyrë:**

Krijoni një album me pamje të ndërtesave që i përkasin periudhës së mesjetës, me piktura dhe skulptura të krijuara në këtë periudhë.

#### **Sqarime për zgjidhjen e ushtrimeve të rubrikës: Gjurmojmë-Mendojmë-Arsyetojnë-Nxjerrim përfundime**

#### **Ushtrimi 5.**

Kisha ka luajtur një rol të madh në zhvillimin e artit e arkitekturës. Ajo ishte autoritare dhe këtë pozitë përpiquej ta ushtronte edhe nëpërmjet ambienteve ku besimtarët vinin për t'u lutur, duke e shprehur shenjtërinë e tyre edhe nëpërmjet madhësisë së godinës dhe pasqyrimit të historisë biblike nëpërmjet artit (mozaikëve, afreskeve, pikturave e ikonostaseve madhështore).

#### **Ushtrimi 6.**

Ky është një problem teorik, por për mendimin tonë është art, sepse artizani me punën e tij krijon vlera artistike, sidomos argjendarët, qëndistarët apo endësit etj.





